CSDG

Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

Transparenca e Gjykatave në Shqipëri

TETOR 2025

Transparenca Online e Gjykatave në Shqipëri

Vlerësim i praktikave të aksesit dhe publikimit të informacionit gjyqësor në Shqipëri

TETOR 2025

Parakusht:

Ky raport është përgatitur nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në kuadër të projektit **"Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies në gjykata: Një vlerësim i përputhshmërisë me standardet e transparencës",** i cili zbatohet si pjesë e një sub-granti në kuadër të projektit "Judiciary under Spotlight", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e CSDG-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian apo të projektit "Judiciary under Spotlight".

Tabela e Përmbajtjes

05 Hyrje

07 Komponentët dhe Indikatorët e Vlerësimit

09 Llojet e indikatorëve për vlerësim

10 Metoda e vlerësimit të indikatorëve në 3 nivele

11 Njësia Matëse e Vlerësimit

13 Gjykatat e marra në vlerësim

16 Përkufizime dhe Terma kryesore

18 Standardet ndërkombëtare

20 Kuadri ligjor kombëtar

24 Gjetje të përgjithshme dhe specifike

34 A. Organizimi dhe funksionimi i gjykatës

65 B. Seancat, çështjet dhe vendimet gjyqësore

96 C. Shërbimet e Gjykatës

130 D. Informimi dhe komunikimi me publikun

161 E. Marrëdhëniet me median dhe gazetarët

192 Rekomandime kryesore

Hyrje

Transparenca e gjykatave është një element thelbësor i besimit publik në drejtësi dhe i përgjegjshmërisë së institucioneve gjyqësore. Në epokën digjitale, faqet zyrtare të gjykatave përfaqësojnë dritaren kryesore të komunikimit me publikun, duke shërbyer si mjet informimi, edukimi dhe llogaridhënieje. Mënyra se si gjykatat e përdorin këtë hapësirë virtuale reflekton nivelin e tyre të hapjes, profesionalizmit dhe transparencës ndaj nevojave të qytetarëve.

Një nga shtyllat kryesore të reformës në drejtësi ka qenë forcimi i transparencës dhe llogaridhënies publike të gjykatave, si mjet për të rikthyer besimin e qytetarëve tek drejtësia. Reforma synoi të kapërcejë praktikat e mbyllura dhe mungesën e informacionit përmes krijimit të një sistemi gjyqësor më të hapur, të dixhitalizuar dhe të standardizuar në komunikimin me publikun dhe median. Në këtë drejtim, ndërhyrjet e parashikuara dhe të ndërmarra synuan disa drejtime kryesore të përmirësimit:

- Modernizimin infrastrukturor të gjykatave, për të garantuar kushte të përshtatshme për praninë e publikut dhe përfaqësuesve të medias gjatë seancave gjyqësore;
- Krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për publikimin e vendimeve gjyqësore, në mënyrë të rregullt dhe të unifikuar, si një nga shtyllat e transparencës institucionale;
- Zbatimin e regjistrimeve audio dhe video të seancave gjyqësore, për të rritur përgjegjshmërinë dhe për të siguruar dokumentim të plotë e të besueshëm të procesit;
- Zhvillimin e platformave online interaktive, që lejojnë ndjekjen në kohë reale të ecurisë së çështjeve dhe informimin e qytetarëve për vendimet e marra;
- Rishikimin dhe forcimin e sistemit të vlerësimit të gjyqtarëve, në mënyrë që rezultatet të jenë më të shpejta, objektive dhe të bazuara në tregues të qartë performance;
- Harmonizimin e kuadrit ligjor për aksesin në të dhënat gjyqësore, duke përcaktuar qartësisht rregullat për përdorimin e bankave të të dhënave nga institucionet dhe publiku;
- Unifikimin e rregullave për transparencën e seancave gjyqësore, me qëllim që praktikat të jenë të njëjta në të gjitha nivelet e gjyqësorit;
- Investime në infrastrukturën fizike dhe teknologjike të gjykatave, për të siguruar qasje të barabartë dhe mjedise më të përshtatshme për publikun dhe median;
- Zhvillimin e sistemeve të reja online për publikun, që mundësojnë akses të lehtë dhe të sigurt në vendimet gjyqësore, raportet vjetore dhe dokumentet e tjera publike;
- Përcaktimin e qartë të rregullave për regjis2trimin audio dhe procesverbalet, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për të forcuar transparencën dhe integritetin procedural.

Megjithatë, pavarësisht objektivave ambicioze dhe përmirësimeve të arritura në disa fusha, transparenca gjyqësore në praktikë vijon të përballet me një sërë sfidash strukturore dhe funksionale. Zbatimi i plotë i mekanizmave të transparencës kërkon kapacitete të qëndrueshme njerëzore, menaxhim profesional të komunikimit institucional dhe mbështetje të vazhdueshme logjistike dhe teknologjike. Në shumë raste, gjykatat ende nuk disponojnë burime të mjaftueshme për përditësimin e vazhdueshëm të informacionit online apo për menaxhimin efektiv të platformave digjitale. Po ashtu, mungesa e standardizimit dhe koordinimit ndërmjet niveleve të gjyqësorit ndikon në cilësinë dhe uniformitetin e transparencës së ofruar për publikun. Këto boshllëqe tregojnë se transparenca gjyqësore mbetet një proces në zhvillim, që kërkon investim të vazhdueshëm në njerëz, infrastrukturë dhe kulturë institucionale për t'u kthyer në një praktikë të qëndrueshme dhe efektive.

Nga ana tjetër, në një kontekst gjithnjë e më të dixhitalizuar, transparenca gjyqësore nuk mund të shihet e shkëputur nga zhvillimet teknologjike. Përveç adresimit të boshllëqeve të identifikuara në nivel njerëzor dhe organizativ, gjykatat duhet të integrojnë më plotësisht teknologjinë në shërbimet e tyre, duke e kthyer atë në një instrument funksional për hapjen dhe komunikimin me publikun. Zhvillimi i platformave interaktive, automatizimi i proceseve të publikimit të vendimeve dhe përdorimi i sistemeve të avancuara të menaxhimit të informacionit janë hapa thelbësorë për të garantuar transparencë të qëndrueshme, efikasitet institucional dhe akses të barabartë për qytetarët. Vetëm përmes një qasjeje të unifikuar që ndërthur kapacitetet njerëzore me inovacionin teknologjik, sistemi gjyqësor mund të arrijë standardet e transparencës dhe llogaridhënies që kërkon reforma.

Ky raport synon të vlerësojë nivelin aktual të transparencës online të gjykatave në Shqipëri, duke ndriçuar aspektet që funksionojnë mirë dhe ato që kërkojnë përmirësim, për më tepër që deri më sot mungojnë vlerësime të plota dhe të qëndrueshme mbi këtë dimension pas reformës në drejtësi. Ai është ndërtuar mbi bindjen se transparenca nuk është vetëm një detyrim formal, por një praktikë institucionale që forcon besueshmërinë, ul distancën mes publikut dhe sistemit gjyqësor, dhe rrit standardet e përgjegjshmërisë. Në këtë kuptim, raporti synon të kontribuojë në:

- Rritjen e ndërgjegjësimit institucional mbi rolin që ka komunikimi publik përmes mjeteve digjitale;
- Nxitjen e harmonizimit të praktikave të transparencës ndërmjet gjykatave të niveleve të ndryshme;
- Forcimin e llogaridhënies publike nëpërmjet përmirësimit të qasjes në informacion gjyqësor, dokumente publike dhe të dhëna statistikore;
- Promovimin e kulturës së hapjes dhe përditësimit të vazhdueshëm të informacionit, si parakusht për një sistem drejtësie modern dhe të besueshëm.

Në thelb, raporti është një instrument vlerësimi dhe reflektimi që ndihmon gjykatat si dhe aktorët e tjerë të kuptojnë më mirë se si perceptohen nga publiku dhe sa efektive janë në komunikimin e informacionit që i përket qytetarëve.

Kategoritë dhe Indikatorët e Vlerësimit

Struktura e vlerësimit të transparencës online të gjykatave është ndërtuar mbi pesë kategori kryesore që pasqyrojnë funksionet themelore të një gjykate – nga organizimi i brendshëm dhe proceset gjyqësore, deri te shërbimet ndaj qytetarëve, komunikimi publik dhe marrëdhëniet me median. Kategoritë janë konceptuar për të siguruar një qasje të plotë dhe të balancuar, që mat transparencën institucionale, funksionale dhe komunikative të sistemit gjyqësor.

Kategoria A – Organizimi dhe funksionimi i gjykatës përfshin elementet që lidhen me strukturën, burimet dhe menaxhimin institucional. Ajo mat shkallën e hapjes së gjykatës në raport me organizimin, rregullat e brendshme, përdorimin e fondeve publike dhe mekanizmat e kontrollit financiar e administrativ.

Kategoria B – Seancat, çështjet dhe vendimet gjyqësore vlerëson transparencën në ushtrimin e funksionit gjyqësor përmes publikimit të seancave, vendimeve, shortit dhe statistikave. Përfshirja e mjeteve orientuese (si videot informuese) synon të lehtësojë aksesin dhe kuptueshmërinë për publikun.

Kategoria C – Shërbimet e gjykatës fokusohet në informacionin praktik për qytetarët, përfshirë mënyrën e paraqitjes së kërkesave, tarifat, ndihmën juridike dhe mjetet e ankimimit. Qëllimi është të sigurohet që qytetarët të kenë orientim të qartë dhe mjete efektive për të aksesuar drejtësinë.

Kategoria D – Informimi dhe komunikimi me publikun mat aftësinë e gjykatave për të komunikuar në mënyrë të qëndrueshme dhe transparente me publikun, përmes raporteve, planeve të komunikimit, koordinimit për të drejtën e informimit dhe përdorimit të kanaleve digjitale.

Kategoria E – Marrëdhëniet me median dhe gazetarët vlerëson ekzistencën e rregullave dhe strukturave që garantojnë komunikim profesional me median, respektim të konfidencialitetit dhe publikim të aktiviteteve institucionale në mënyrë të hapur dhe të saktë.

Në tërësi, ky sistem kategorizimi synon unifikimin e standardeve të transparencës ndërmjet gjykatave, duke kombinuar qasjen ligjore me atë praktike. Ai shërben si instrument për të matur hapjen institucionale, për të nxitur përgjegjshmëri dhe për të forcuar besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

KATEGORITË DHE INDIKATORËT E PËRDORUR PËR VLERËSIM

A. Organizimi dhe funksionimi i gjykatës	B. Seancat, çështjet dhe vendimet gjyqësore	C. Shërbimet e Gjykatës	D. Informimi dhe komunikimi me publikun	E. Marrëdhëniet me median dhe gazetarët
Lista emërore e gjyqtarëve dhe jetëshkrimi i tyre	Informacion mbi shortin e Gjykatës (elektronik, manual)	Informacion mbi kompetencat e gjykatës	Njoftimet me shpallje publike	Njoftime dhe deklarata për median
Struktura organizative e gjykatës (Organigrama)	Lista e çështjeve për gjykim	Informacion orientues për qytetarët mbi mënyrën e paraqitjes së një kërkese padie	Raporti vjetor i gjykatës	Rregullore për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median
Rregullore e brendshme e gjykatës	Kalendari i seancave gjyqësore	Informacion për qytetarët mbi të drejtën e ankimit dhe rekursit	Plani Strategjik i Komunikimit për Sistemin Gjyqësor	Udhëzuesi i gjykatës për marrëdhëniet me median dhe publikun
Kodi i Etikës Gjyqësore	Vendimet e gjykatës për çështjet	Fletëpalosje për shërbimet që ofrojnë gjykatat për qytetarët	Plani i Komunikimit për Gjykatat 2022-2024	Deklaratë e konfidencialitetit për aksesin në dosjet gjyqësore nga media dhe publiku
Këshilli i Gjykatës (procesverbale, vendime)	Statistikat gjyqësore	Fletëpalosje informuese për Gjykatat dhe Zyrat e Shërbimit	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Deklaratë e pëlqimit për publikimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore
Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset	Të dhënat e kreditorëve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore	Ndihma juridike falas (kontakt, fletëpalosje, video, etj)	Koordinatori për të drejtën e informimit	Kërkesë për regjistrimin/transmetimin e imazheve filmike të seancës gjyqësore
Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik	Formulari i kërkesës për kopje të regjistrimit audio	Tarifat e shërbimeve gjyqësore	E drejta për t'u informuar (formularë për kërkesë informacioni)	Kontaktet e Gjyqtarit për Median
Regjistri i realizimeve të prokurimit publik	Video informuese rreth kërkimit të informacionit mbi çështjen gjyqësore	Formulari Elektronik i Aplikimit	E drejta për t'u ankuar (formularë për ankesa)	Kontakte të Nëpunësit për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun
Raportet e auditimit (KLGJ, KLSH)	Video informuese rreth përdorimit të informacionit mbi shortin	Formulari i ankesës për nënpunësin civil gjyqësor	Adresa dhe kontaktet institucionale	Njoftime ose publikime mbi veprimtari institucionale të gjykatës
Vende vakante në shërbimin civil gjyqësor	Video informuese rreth përdorimit të kalendarit të seancave	Video informuese për përdorimin e InfoPoint në Gjykatë	Përdorimi i rrjeteve sociale për komunikim institucional	Publikime mediatike që pasqyrojnë veprimtarinë e gjykatës

Llojet e indikatorëve për vlerësim

Indikatorët e transparencës që publikohen nga gjykatat online janë ndarë sipas natyrës së tyre në tre kategori kryesore: **periodikë, statikë dhe binarë**. Ky klasifikim ndihmon për të kuptuar mënyrën se si matet dhe interpretohet niveli i transparencës për secilin indikator, por pa cënuar mundësinë për të pasur një metodologji uniforme të vlerësimit.

1. INDIKATORËT PERIODIKË

Këta janë indikatorë që lidhen me dokumente apo informacione që duhet të publikohen në baza të rregullta kohore (p.sh. çdo vit). Vlerësimi i tyre nuk kufizohet vetëm tek ekzistenca, por matet sidomos vazhdimësia dhe rregullsia e publikimit. Transparenca matet nga numri i viteve të mbuluara dhe azhornimi me dokumentin e fundit.

2. INDIKATORËT STATIKË

Këta janë elementë që nuk kërkojnë rishfaqje periodike, por duhet të jenë të pranishëm dhe të përditësuar sipas nevojës. Ata nuk kanë cikël të përcaktuar publikimi, por gjithsesi vlerësohen sipas cilësisë, qartësisë dhe azhornimit të informacionit. Transparenca matet nëse informacioni është i plotë, i qartë dhe i aksesueshëm, edhe pse nuk përsëritet çdo vit.

3. INDIKATORËT BINARË

Këta indikatorë kanë natyrë krejtësisht po/jo: ose ekzistojnë online, ose mungojnë. Nuk ka kuptim të matet vazhdimësia, sepse publikimi i tyre është një akt unik dhe i mjaftueshëm. Transparenca matet vetëm me ekzistencën dhe qartësinë e publikimit. Në mungesë → nuk përmbushet; në ekzistencë → përmbushet plotësisht.



Metoda e vlerësimit të indikatorëve në 3 nivele

Për të garantuar një qasje uniforme dhe të krahasueshme për të gjithë indikatorët e transparencës online të gjykatave, është ndërtuar një metodologji e bazuar në **tre nivele vlerësimi**.

1. Nuk përmbushet (0 pikë)

Ky nivel aplikohet kur indikatori mungon plotësisht në faqen zyrtare të gjykatës ose nuk është i aksesueshëm për publikun.

- Indikatorët periodikë: mungon çdo publikim që pasqyron informacionin për periudha të ndryshme kohore.
- Indikatorët statikë: informacionet bazë nuk janë të pranishme ose nuk janë bërë publike në asnjë formë.
- Indikatorët binarë: elementi përkatës nuk është i publikuar apo nuk mund të gjendet në mënyrë të qartë.

2. Përmbushet pjesërisht (1 pikë)

Ky nivel tregon se indikatori është i pranishëm, por me mangësi në rregullshmëri, përditësim, qartësi ose akses.

- Indikatorët periodikë: publikimi ekziston, por nuk është i vazhdueshëm, ka ndërprerje ose nuk përditësohet rregullisht.
- Indikatorët statikë: informacioni është i pjesshëm, i vjetëruar ose i vendosur në mënyrë që vështirëson gjetjen nga publiku.
- Indikatorët binarë: elementi ekziston, por është i paplotë, i pasaktë ose i prezantuar pa qartësi vizuale apo përmbajtësore.

3. Përmbushet plotësisht (2 pikë)

Ky nivel reflekton se indikatori është përmbushur në mënyrë të plotë, të qartë dhe të aksesueshme, në përputhje me natyrën e tij.

- Indikatorët periodikë: publikimet janë të rregullta, të azhurnuara dhe pasqyrojnë vazhdimësi kohore.
- Indikatorët statikë: informacioni është i plotë, i qartë dhe i vendosur në mënyrë të dukshme e të lehtë për t'u gjetur.
- Indikatorët binarë: elementi përkatës është i publikuar në mënyrë të plotë, të qartë dhe të qëndrueshme, duke garantuar akses të menjëhershëm për publikun.

Njësia Matëse e Vlerësimit

Vlerësimi i transparencës online të gjykatave është zhvilluar mbi bazën e një metodologjie të standardizuar, e cila synon të masë në mënyrë të krahasueshme nivelin e përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe standardeve të hapjes institucionale. Kjo metodologji bazohet në një sistem të unifikuar pikëzimi që kombinon elementët sasiorë dhe cilësorë, duke mundësuar një analizë të balancuar ndërmjet ekzistencës së informacionit dhe cilësisë së tij.

Korniza e vlerësimit është strukturuar në pesë kategori kryesore, që përfshijnë të gjithë spektrin e transparencës institucionale:

1. Organizimi dhe funksionimi i gjykatës
2. Seancat, çështjet dhe vendimet gjyqësore
3. Shërbimet e gjykatës
4. Informimi dhe komunikimi me publikun
5. Marrëdhëniet me median dhe gazetarët

Secila kategori përbëhet nga **10 indikatorë matës**, të cilët testojnë përmbushjen e kërkesave ligjore dhe praktike për publikimin e informacionit në faqet zyrtare të gjykatave. Indikatorët janë të konceptuar në mënyrë të qartë dhe bazuar në llojin e tyre, është mundësuar një vlerësim i drejtpërdrejtë sipas tre niveleve të përmbushjes: Nuk përmbushet (0 pikë); Përmbushet pjesërisht (1 pikë) dhe Përmbushet plotësisht (2 pikë).

Për çdo kategori, pikët totale përllogariten sipas formulës: **(Y1 × 0) + (Y2 × 1) + (Y3 × 2)** ku Y1, Y2 dhe Y3 përfaqësojnë respektivisht numrin e indikatorëve që nuk përmbushen, përmbushen pjesërisht, ose plotësisht. Totali maksimal për çdo kategori është **20 pikë**, ndërsa për të gjithë instrumentin **100 pikë**.

Përqindja e pikëve të arritura për çdo kategori dhe në total përllogaritet sipas raportit ndërmjet pikëve të fituara dhe pikëve maksimale. Për të mundësuar një interpretim të qartë të performancës, rezultatet kategorizohen sipas sistemit të mëposhtëm të vlerësimit:

- **E Lartë (≥ 80 pikë)** – niveli i lartë i transparencës dhe përmbushjes së standardeve;
- **Mesatar (50–79 pikë)** – transparencë e pjesshme, me nevojë për përmirësim të strukturës dhe përmbajtjes së informacionit;
- **E Ulët (< 50 pikë)** – mungesë e dukshme transparence dhe përmbushje e pamjaftueshme e detyrimeve ligjore.

Kategoritë	Nr. Indikatorëve (X=10)	Nuk Përmbushet (Y1)	Përmbushet Pjesërisht (Y2)	Përmbushet Plotësisht (Y3)	Pikët Totale (Formula)
A. Organizimi dhe funksionimi i gjykatës	X	Y1	Y2	Y3	(Y1 * 0) + (Y2 * 1) + (Y3 * 2)
B. Seancat, çështjet dhe vendimet gjyqësore	X	Y1	Y2	Y3	(Y1 * 0) + (Y2 * 1) + (Y3 * 2)
C. Shërbimet e gjykatës	X	Y1	Y2	Y3	(Y1 * 0) + (Y2 * 1) + (Y3 * 2)
D. Informimi dhe komunikimi me publikun	X	Y1	Y2	Y3	(Y1 * 0) + (Y2 * 1) + (Y3 * 2)
E. Marrëdhëniet me median dhe gazetarët	X	Y1	Y2	Y3	(Y1 * 0) + (Y2 * 1) + (Y3 * 2)
TOTALI	Σ(X)	Σ(Y1)	Σ(Y2)	Σ(Y3)	Σ[(Y1 * 0) + (Y2 * 1) + (Y3 * 3)] / Total Pikë Maksimale * 100

E ulët: < 50 pikë	Mesatare: (50-79 pikë)	E Lartë: ≥ 80 pikë

Gjykatat e marra në vlerësim

Procesi i vlerësimit të transparencës online është zhvilluar duke u mbështetur në strukturën zyrtare të sistemit gjyqësor shqiptar, siç përcaktohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Këshilli ka miratuar një ndarje standardizuese të gjykatave **në tri kategori,** bazuar në rëndësinë institucionale, nivelin e juridiksionit dhe funksionet e ushtruara në kuadër të sistemit gjyqësor. Kjo ndarje synon të sigurojë qartësi në organizimin e gjykatave, të përmirësojë menaxhimin e çështjeve dhe të mundësojë vlerësim të balancuar të performancës institucionale në raport me transparencën publike.

Në kuadër të këtij vlerësimi janë përfshirë të gjitha gjykatat që përbëjnë strukturën e sistemit gjyqësor pas zbatimit të hartës së re gjyqësore, duke përfshirë nivelet e larta, të mesme dhe të ulëta të juridiksionit. Përfshirja e gjykatave të çdo kategorie është bërë me qëllim që analiza të pasqyrojë në mënyrë sa më të plotë realitetin institucional dhe praktikën e publikimit të informacionit në faqet zyrtare të gjykatave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo qasje mundëson krahasueshmëri ndërmjet gjykatave që ushtrojnë të njëjtin funksion, por operojnë në kontekste të ndryshme territoriale, organizative dhe kapacitetesh teknike.

Në grupin e parë përfshihen gjykatat me juridiksion kombëtar dhe funksione udhëheqëse në sistem, si Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe gjykatat e posaçme dhe administrative të Tiranës. Kategoria e dytë përbëhet nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm me shtrirje rajonale, të cilat mbulojnë zonat më të populluara të vendit dhe kanë ngarkesën më të madhe të çështjeve, ndërsa kategoria e tretë përfshin gjykatat me juridiksion më të kufizuar territorial, të cilat operojnë në zona me volum më të ulët çështjesh, por që përbëjnë hallka të rëndësishme për garantimin e aksesit në drejtësi dhe transparencës publike në nivel vendor.

Përfshirja e këtyre tre niveleve institucionale krijon një bazë të plotë për analizën krahasuese të transparencës online, duke lejuar identifikimin e prirjeve, boshllëqeve dhe praktikave të mira në publikimin e informacionit gjyqësor. Vlerësimi është ndërtuar mbi kriteret e unifikuara për të gjitha gjykatat, duke përdorur të njëjtin set indikatorësh dhe të njëjtën metodë matjeje, me qëllim sigurimin e objektivitetit dhe koherencës analitike. Kjo e bën instrumentin e vlerësimit të përshtatshëm jo vetëm për analizë momentale, por edhe për ndjekje në kohë të progresit të transparencës institucionale në sistemin gjyqësor.

STRUKTURA E ORGANIZIMIT TË SISTEMIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI



GJYKATA	SELIA	JURIDIKSIONI
Gjykata e Lartë	Qyteti i Tiranës	Mbarë territori i Republikës së Shqipërisë
Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	Qyteti i Tiranës	Mbarë territori i Republikës së Shqipërisë
Gjykata e Posaçme e Apelit	Qyteti i Tiranës	Mbarë territori i Republikës së Shqipërisë
Gjykata Administrative e Apelit	Qyteti i Tiranës	Mbarë territori i Republikës së Shqipërisë
Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë	Qyteti i Tiranës	Kompetenca tokësore në Bashkitë Tiranë, Kamzë, Vorë dhe Krujë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë	Qyteti i Tiranës	Mbarë territori i Republikës së Shqipërisë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	Qyteti i Tiranës	Kompetenca tokësore në Bashkitë Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Lezhë dhe Korçë.
Gjykata e Shkallës së Parë Durrës	Qyteti i Durrësit	Kompetenca tokësore në Bashkitë Durrës, Shijak, Kavajë dhe Rrogozhinë.
Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan	Qyteti i Elbasanit	Kompetenca tokësore në Bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd dhe Përrenjas.
Gjykata e Shkallës së Parë Fier	Qyteti i Fierit	Kompetenca tokësore në Bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Lushnjë, Divjakë dhe Mallakastër.
Gjykata e Shkallës së Parë Korçë	Qyteti i Korçës	Kompetenca tokësore në Bashkitë Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Devoll dhe Pogradec.
Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër	Qyteti i Shkodrës	Kompetenca tokësore në Bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë-Arës.
Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë	Qyteti i Vlorës	Kompetenca tokësore në Bashkitë Vlorë, Selenicë dhe Himarë.
Gjykata e Shkallës së Parë Berat	Qyteti i Beratit	Kompetenca tokësore në Bashkitë Berat, Dimal, Kuçovë, Skrapar dhe Poliçan.
Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë	Qyteti i Lezhës	Kompetenca tokësore në Bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin.
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë	Qyteti i Lushnjës	Kompetenca tokësore në Bashkitë Berat, Fier, Gjirokastër, Sarandë dhe Vlorë.
Gjykata e Shkallës së Parë Dibër	Qyteti i Peshkopisë	Kompetenca tokësore në Bashkitë Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos.
Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastër	Qyteti i Gjirokastrës	Kompetenca tokësore në Bashkitë Gjirokastër, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë dhe Dropull.
Gjykata e Shkallës së Parë Kukës	Qyteti i Kukësit	Kompetenca tokësore në Bashkitë Kukës, Has dhe Tropojë.
Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë	Qyteti i Sarandës	Kompetenca tokësore në Bashkitë Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë

Përkufizime dhe Terma kryesore

Institucione dhe pozicione

- **Koordinator për të Drejtën e Informimit**: Nëpunësi civil i përcaktuar në nenin 10 të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", përgjegjës për administrimin e kërkesave për informacion nga publiku dhe sigurimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit.
- **Zyra e Marrëdhënieve me Publikun (ZMP)**: Njësi e dedikuar në gjykata dhe institucione për të garantuar informimin e publikut dhe ndërveprimin efektiv me median dhe grupet e interesit.
- **Gjyqtari i Medias**: Gjyqtar i caktuar për të komunikuar me median dhe publikun, duke siguruar që informacionet të jenë të sakta, të qarta dhe në përputhje me ligjet dhe rregullat etike.
- **Nëpunësi për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun (NMMP)**: Personel civil i gjykatave përgjegjës për përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit publik, mbajtjen e faqes së internetit dhe ndërveprimin me median nën mbikëqyrjen e Gjyqtarit të Medias.

Dokumente dhe procedura

- **Plani Strategjik i Komunikimit për Sistemin Gjyqësor**: Dokument i miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor që përcakton strategjitë dhe masat për përmirësimin e marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median, duke promovuar transparencën dhe besimin publik.
- **Programi i Transparencës**: Dokument që përcakton kategoritë e informacioneve që duhet të publikohen nga gjykatat në mënyrë proaktive, përfshirë vendimet gjyqësore, raportet financiare dhe informacionin mbi procedurat administrative.
- **Udhëzuesi Standard i Shtypit**: Një model dokumenti i përgatitur nga ZMP ose NMMP për njoftime për shtyp, që përfshin të dhëna mbi aktivitetet dhe vendimet e rëndësishme për publikun.
- **Njoftimi për Shtyp**: Dokument i shkurtuar dhe deklarativ për t'i informuar mediat dhe publikun mbi ngjarjet, iniciativat ose vendimet e rëndësishme.

Përkufizime dhe Terma kryesore

Platforma dhe mjete të komunikimit

- **Faqja e Internetit e Gjykatave**: Platforma elektronike që siguron akses të drejtpërdrejtë në informacion mbi gjykatat, vendimet gjyqësore, procedurat dhe kontaktet për qytetarët dhe median.
- **Rrjetet Sociale**: Kanale si Facebook, Twitter dhe YouTube të përdorura për informimin e shpejtë dhe të gjerë të publikut përmes postimeve dhe njoftimeve periodike.
- **Buletini Elektronik**: Përmbledhje periodike e informacioneve të rëndësishme nga sistemi gjyqësor, e shpërndarë përmes email-it ose platformave të tjera elektronike.

Parime dhe praktika të komunikimit

- **Transparenca**: Parim themelor që nënkupton publikimin e informacionit të saktë dhe në kohë, duke respektuar të drejtën e informimit dhe privatësinë.
- **Profesionalizmi në Komunikim**: Qasja e kujdesshme dhe e mirësjellshme ndaj qytetarëve dhe medias, duke siguruar që çdo informacion i shpërndarë të jetë i saktë dhe i kuptueshëm.
- **Besueshmëria**: Përgjegjësia për të garantuar që informacionet e dhëna publikut janë të sakta dhe të përditësuara, duke korrigjuar çdo gabim sa më shpejt të jetë e mundur.
- **Proaktiviteti**: Praktika e publikimit të informacionit pa pasur kërkesë paraprake nga publiku, për të rritur aksesin dhe ndërgjegjësimin.

Standardet Ndërkombëtare

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Neni 6: Ky nen garanton të drejtën për një proces të drejtë dhe publik. Ai parashikon që seancat gjyqësore të jenë të hapura për publikun dhe që vendimet gjyqësore të shpallen publikisht, me përjashtime të kufizuara për arsye sigurie, morale ose për mbrojtjen e jetës private. Kjo dispozitë përfaqëson themelin normativ të transparencës në gjyqësor, duke theksuar se drejtësia jo vetëm duhet të ushtrohet, por edhe të shihet se po ushtrohet.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) – Komenti i Përgjithshëm Nr. 32: Ky interpretim i Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut thekson se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara dhe të aksesueshme nga publiku. Komenti vë në dukje se transparenca është një komponent kyç i të drejtës për një proces të drejtë dhe shërben për të garantuar llogaridhënie dhe paanshmëri në vendimmarrje.

Parimet e Bangalore për Sjelljen Gjyqësore (2002): Këto parime etike për gjyqtarët promovojnë transparencën si një nga vlerat thelbësore të sjelljes gjyqësore. Në veçanti, Parimi 6 nënvizon rëndësinë e aksesit në drejtësi dhe të transparencës në administrimin e saj. Publikimi i informacionit mbi funksionimin e gjykatave dhe sjellja e hapur e gjyqtarëve konsiderohen si mjete për të ndërtuar dhe ruajtur besimin e publikut.

Opinionet e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE): CCJE ka prodhuar një sërë opinionsh që theksojnë rolin e gjykatave në komunikimin me publikun dhe në edukimin qytetar. Në Opinionet Nr. 7 dhe Nr. 12, theksohet se transparenca nuk kufizohet vetëm në hapjen e seancave gjyqësore, por shtrihet edhe në përdorimin e teknologjisë, komunikimin proaktiv me median, publikimin e statistikave dhe informacionit mbi organizimin e brendshëm të gjykatave.

Standardet Ndërkombëtare

Parimet e OSBE/ODIHR për Transparencën e Gjykatave: **OSBE/ODIHR e konsideron transparencën si një element kyç për forcimin e sundimit të ligjit dhe rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Udhëzimet e saj përfshijnë publikimin e kalendarëve gjyqësorë, aksesin në dokumentet e çështjeve, regjistrat dhe statistikat gjyqësore, përditësimin në kohë reale të informacionit për publikun, si dhe krijimin e portaleve publike të aksesueshme në internet.**

Komisioni i Venecias – Opinionet mbi Pavarësinë dhe Transparencën: Komisioni i Venecias ka theksuar se transparenca është një parakusht për të garantuar pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit. Ai ka rekomanduar që vendimet gjyqësore të jenë të arsyetuara dhe të publikohen në mënyrë të qasshme, që informacioni mbi funksionimin e sistemit gjyqësor të jetë i hapur për publikun, dhe që gjykatat të ndërveprojnë rregullisht me shoqërinë.

Deklarata Universale për Aksesin në Informacionin Publik në Sistemin Gjyqësor (UNESCO): Kjo deklaratë ofron një kornizë të plotë për qasjen publike në dokumentet zyrtare gjyqësore dhe për përdorimin e teknologjisë në funksion të transparencës. Ajo rekomandon që sistemet gjyqësore të sigurojnë portale elektronike për publikimin e vendimeve, statistikave, kalendarëve dhe njoftimeve zyrtare, duke garantuar përditësim të rregullt dhe akses të barabartë për të gjithë qytetarët.

Përmbushja e këtyre standardeve ndërkombëtare kërkon përkushtim të vazhdueshëm nga ana e institucioneve gjyqësore. Kjo përfshin vendosjen e praktikave që sigurojnë publikimin e rregullt dhe të arsyetuar të vendimeve, transparencën në kalendarët dhe proceset gjyqësore, si dhe komunikimin efektiv me publikun për të rritur besimin dhe llogaridhënien në sistemin e drejtësisë.

Kuadri Ligjor Kombëtar

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e përcakton transparencën gjyqësore si një parim themelor të shtetit të së drejtës dhe një garanci për besimin publik në drejtësi. Ajo siguron që çdo person të ketë të drejtë për një gjykim të drejtë dhe publik nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, duke nënvizuar rëndësinë e hapjes së procesit gjyqësor për publikun si mjet kontrolli demokratik dhe llogaridhënieje. Seancat gjyqësore zhvillohen në mënyrë të hapur, përveç rasteve të veçanta kur interesi publik ose mbrojtja e privatësisë e kërkojnë ndryshe, ndërsa vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast, duke garantuar transparencën e aktit përfundimtar të drejtësisë.

Ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" Ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" përbën një instrument tjetër kyç në drejtim të transparencës institucionale në sistemin gjyqësor shqiptar. Ai vendos detyrimin që institucionet e drejtësisë, veçanërisht Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe gjykatat, të ndërtojnë marrëdhënie të hapura dhe të vazhdueshme komunikimi me publikun. Ligji e përkufizon transparencën si mjet për të ndërtuar besim publik dhe llogaridhënie, duke kërkuar që funksionimi i drejtësisë të jetë i kuptueshëm dhe i aksesueshëm për qytetarët. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka rol të veçantë në hartimin e politikave dhe mekanizmave të informimit publik, përmes komunikimit të paanshëm, të saktë dhe të kuptueshëm mbi veprimtarinë gjyqësore dhe institucionale. Në thelb, ky kuadër ligjor pasqyron angazhimin për ndërtimin e një sistemi drejtësie të hapur dhe të përgjegjshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtën e informimit dhe gjykimin publik. Ai përbën themelin mbi të cilin ndërtohen të gjitha aktet nënligjore dhe praktikat që garantojnë transparencën dhe afërsinë e institucioneve të drejtësisë me qytetarët.

Kuadri Ligjor Kombëtar

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit": Ky ligj synon të garantojë akses të gjerë të qytetarëve në informacion publik, përfshirë atë që prodhojnë gjykatat. Ai vendos standarde të qarta për transparencën proaktive, duke i detyruar institucionet të publikojnë në mënyrë të rregullt dhe të përditësuar të dhëna mbi strukturën, buxhetin, vendimmarrjen dhe politikat e tyre, pa qenë e nevojshme kërkesa individuale nga qytetarët.
Ligji kërkon gjithashtu krijimin e një regjistri publik të kërkesave për informacion, për të siguruar gjurmueshmëri dhe llogaridhënie mbi mënyrën e trajtimit të kërkesave nga institucionet. Refuzimi i informacionit lejohet vetëm në raste të kufizuara dhe të përcaktuara qartë me ligj, si ruajtja e sekretit hetimor, mbrojtja e sigurisë kombëtare ose privatësia e individëve. Në këtë mënyrë, ligji ndihmon në parandalimin e abuzimeve dhe garanton llogaridhënie në ushtrimin e funksioneve publike, përfshirë ato të sistemit gjyqësor.

Ligji nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" vendos standardet për publikimin dhe përdorimin e të dhënave të hapura nga institucionet publike, përfshirë gjykatat. Ai përcakton se çdo dokument i administruar nga institucioni mund të vihet në dispozicion të publikut për ripërdorim të lirë, për qëllime fitimi ose jo, për sa kohë nuk cenohen kufizimet ligjore. Të dhënat duhet të jenë të aksesueshme, në formate të hapura dhe të lexueshme nga kompjuteri, të shoqëruara me metadata përkatëse dhe, kur është e mundur, të publikohen në kohë reale përmes ndërfaqeve API. Gjykatat kanë detyrimin të publikojnë lista të dokumenteve të hapura që mund të ripërdoren nga publiku, ndërkohë që ligji përjashton të dhënat personale, informacionin konfidencial dhe materialet e mbrojtura nga e drejta e autorit.

Kuadri Ligjor Kombëtar

Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor: miratuar në vitin 2020 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, përbën dokumentin kryesor që orienton mënyrën se si sistemi gjyqësor duhet të ndërtojë një komunikim të hapur, transparent dhe të besueshëm me publikun dhe median. Ai synon të forcojë marrëdhëniet midis gjykatave dhe qytetarëve, duke rritur ndërgjegjësimin dhe besimin publik në drejtësi.

Në thelb, plani përcakton objektiva strategjikë afatgjatë për përmirësimin e imazhit të sistemit gjyqësor dhe rritjen e kuptueshmërisë së funksionimit të tij. Dokumenti parashikon përdorimin e një game të gjerë kanalesh, nga mediat tradicionale deri te platformat dixhitale dhe aktivitetet me komunitetin, për të siguruar që informacioni të jetë i qasshëm për të gjithë qytetarët. Plani përcakton gjithashtu masat konkrete për zbatim, duke ndarë qartë përgjegjësitë ndërmjet institucioneve gjyqësore dhe duke vendosur mekanizma për monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të progresit.

Plani i Komunikimit për Gjykatat 2022–2024: i miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, është një dokument udhëzues për forcimin e transparencës dhe komunikimit publik të gjykatave, i shoqëruar me një plan veprimi konkret. Ai synon të rrisë besimin e qytetarëve në drejtësi përmes një komunikimi të strukturuar, të qartë dhe të mbështetur në mjetet moderne të informimit.

Plani vendos në qendër transparencën si parim bazë, duke promovuar informimin e publikut mbi funksionimin e gjykatave, përdorimin e teknologjisë për akses më të gjerë dhe zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese që afron qytetarët me institucionet e drejtësisë. Ai parashikon përfshirjen e grupeve vulnerabël dhe krijimin e mekanizmave për monitorimin dhe raportimin periodik të zbatimit, nën koordinimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë mënyrë, dokumenti përforcon kulturën e hapjes dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor shqiptar.

Kuadri Ligjor Kombëtar

Rregulloren për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median: Përcakton standarde të qarta për mënyrën se si KLGJ informon publikun dhe bashkëpunon me median, duke siguruar që komunikimi të jetë profesional, i saktë dhe i koordinuar. Rregullorja e trajton median si partner strategjik në rritjen e besimit publik ndaj drejtësisë, duke vendosur parime si barazia e aksesit, përgjegjshmëria dhe respektimi i etikës në dhënien e informacionit. Ajo përcakton qartë procedurat për trajtimin e kërkesave nga media, rolet dhe përgjegjësitë për komunikimin zyrtar, si dhe kufijtë e informacionit që mund të jepet, në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Rregullorja synon të kontribuojë drejtpërdrejt në rritjen e llogaridhënies publike dhe në ndërtimin e një komunikimi të qëndrueshëm mes institucioneve të drejtësisë dhe qytetarëve.

Material shtesë që informon dhe udhëzon gjykatat në zbatimin e Planit të Komunikimit: Ky material udhëzues mbështet gjykatat në zbatimin e Planit të Komunikimit, duke ofruar një kornizë praktike dhe ligjore për rritjen e transparencës dhe besimit publik në sistemin gjyqësor. Ai udhëzon gjykatat të komunikojnë në mënyrë të qartë, të saktë dhe të aksesueshme për qytetarët. Dokumenti nënvizon rolin e faqes zyrtare të gjykatës, Programit të Transparencës, Koordinatorit për të drejtën e informimit dhe gjyqtarëve të medias si instrumente kyçe për komunikim efektiv me publikun. Ai identifikon sfida si mungesa e burimeve dhe përdorimi i zhargonit juridik, duke propozuar një qasje të re të bazuar në komunikim të unifikuar, digjitalizim dhe angazhim qytetar-qendror. Në thelb, materiali synon ndërtimin e një kulture të hapur dhe profesionale komunikimi që afron drejtësinë me qytetarët dhe rrit transparencën në të gjithë sistemin gjyqësor.

Gjetje të Përgjithshme

SHPËRNDARJE JO KOHERENTE E INFORMACIONIT NDËRMJET RUBRIKAVE TË FAQES ZYRTARE

Është vërejtur mospërputhje dhe mungesë koherence në organizimin e informacionit ndërmjet rubrikave të ndryshme të faqeve zyrtare të gjykatave. Të dhëna dhe materiale që i përkasin një kategorie të caktuar shpesh publikohen në rubrika të tjera, pa ndarje të qartë tematikash apo logjike strukturore. Kjo e bën më të vështirë navigimin dhe identifikimin e informacionit nga publiku dhe sinjalizon mungesë unifikimi në mënyrën e menaxhimit të përmbajtjes online.

MOSPËRPUTHJE NË PERIUDHËN KOHORE TË PUBLIKIMIT TË MATERIALEVE INSTITUCIONALE

Është konstatuar mungesë uniformiteti në periudhën kohore të publikimeve në faqet zyrtare të gjykatave. Ndërkohë që disa gjykata publikojnë raporte dhe materiale për disa vite radhazi, të tjera ofrojnë informacion vetëm për periudha të kufizuara ose të fragmentuara. Kjo praktikë e pakoordinuar pengon krijimin e një panorame të plotë mbi veprimtarinë institucionale dhe ul vlerën krahasuese e informuese të të dhënave të publikuara.

MUNGESË KATEGORIZIMI LOGJIK TË INFORMACIONIT NË RUBRIKAT PËRKATËSE

Është vërejtur mungesë konsistence në kategorizimin e informacionit në faqet zyrtare të gjykatave. Materiale që i përkasin një rubrike të caktuar shpesh publikohen në seksione të tjera pa lidhje tematike ose funksionale, duke krijuar mbivendosje dhe konfuzion në strukturën e përmbajtjes. Kjo tregon mungesë të një logjike të unifikuar në organizimin e informacionit dhe vështirëson identifikimin e të dhënave nga publiku apo përdoruesit institucionalë.

Gjetje të Përgjithshme

PËRDORIM I RUBRIKAVE TEPËR TË PËRGJITHSHME DHE JO FUNKSIONALE PËR PUBLIKIMIN E INFORMACIONIT

Në faqet zyrtare të gjykatave janë vërejtur rubrika me emërtime shumë të përgjithshme, si "Njoftime", "Njoftime të tjera", "Publikime" apo "Njoftime për publikun". Për shkak të mungesës së një ndarjeje të qartë sipas tematikës dhe funksionit, në këto rubrika publikohet një gamë e gjerë materialesh pa lidhje mes tyre. Kjo qasje jo e strukturuar ul cilësinë e transparencës institucionale dhe krijon paqartësi për publikun në identifikimin e informacionit zyrtar.

PUBLIKIM I MATERIALEVE QË I PËRKASIN GJYKATAVE TË TJERA NË FAQET ZYRTARE INDIVIDUALE

Është vërejtur se disa gjykata publikojnë në faqet e tyre materiale që i përkasin gjykatave të tjera, ndonëse çdo institucion ka një faqe zyrtare të dedikuar. Kjo praktikë shfaqet kryesisht në rubrikat për vendet vakante dhe në publikime të tjera administrative, duke krijuar konfuzion mbi burimin e informacionit dhe kufijtë institucionalë. Fenomeni tregon mungesë koordinimi në menaxhimin e përmbajtjes ndërmjet gjykatave dhe cenon qartësinë e komunikimit publik.

PËRSËRITJE DHE MBIVENDOSJE E RUBRIKAVE ME PËRMBAJTJE TË NGJASHME

Në faqet zyrtare të gjykatave janë identifikuar rubrika me emërtime ose funksione të përafërta, si "Rregullore" apo "Njoftime të tjera". Kjo mbivendosje terminologjike dhe funksionale krijon konfuzion në strukturën e faqes dhe vështirëson orientimin e përdoruesve. Mungesa e një ndarjeje të qartë dhe të harmonizuar të rubrikave tregon nevojën për standardizim në organizimin e informacionit institucional.

Gjetje të Përgjithshme

INFORMACION I PAPËRDITËSUAR DHE MOSPËRPUTHJE ME NDRYSHIMET INSTITUCIONALE TË SISTEMIT GJYQËSOR

Është konstatuar se në disa faqe zyrtare të gjykatave vazhdon të qëndrojë informacion i vjetëruar, i cili nuk pasqyron ndryshimet e ndodhura në sistemin gjyqësor pas reformës në drejtësi. Kjo vihet re kryesisht në lista të stafit, rregullore të brendshme dhe dokumente institucionale të papërditësuara. Mungesa e mirëmbajtjes së vazhdueshme të përmbajtjes online dëmton besueshmërinë e informacionit dhe e kufizon funksionin e faqes si mjet i transparencës reale.

MUNGESË UNIFIKIMI NË STRUKTURËN DHE PËRMBAJTJEN E FAQES KRYESORE TË GJYKATAVE

Është vërejtur se faqja kryesore (home page) e gjykatave nuk ndjek një strukturë të unifikuar apo standard të përbashkët. Disa gjykata përfshijnë në këtë faqe një sasi të madhe informacioni, shpesh të përsëritur me rubrika të tjera, ndërsa të tjera kufizohen në një përshkrim të shkurtër të institucionit. Kjo qasje e fragmentuar tregon mungesë standardizimi vizual dhe funksional, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në qartësinë dhe koherencën e komunikimit publik.

MUNGESË ARKIVIMI DHE RUAJTJEJE TË MATERIALEVE TË PUBLIKUARA NË RUBRIKAT ME NGARKESË TË LARTË INFORMACIONI

Është konstatuar se rubrikat me numër të lartë publikimesh, që shpesh arrijnë deri në dhjetëra faqe të brendshme, nuk ofrojnë mekanizëm arkivimi apo akses në njoftimet e mëparshme. Pasi tejkalohet një numër i caktuar postimesh, materialet e vjetra zhduken nga pamja, duke u bërë të paaksesueshme për publikun. Mungesa e një sistemi të qëndrueshëm arkivimi cenon transparencën afatgjatë dhe ruajtjen e gjurmës institucionale të informacionit publik.

Gjetje të Përgjithshme

MOSPËRDITËSIM I PLOTË I FAQEVE PAS ZBATIMIT TË HARTËS SË RE GJYQËSORE DHE EKZISTENCA E VERSIONEVE TË VJETRA ONLINE

Pas zbatimit të hartës së re gjyqësore, është vërejtur se faqet e disa gjykatave të shkrira ose të ristrukturuara vijojnë të jenë të aksesueshme online dhe të shfaqen në rezultatet e kërkimit. Këto faqe të vjetra shpesh përmbajnë informacion të plotë dhe për këtë arsye mund të ngatërrojnë publikun dhe të krijojnë pasiguri mbi faqen zyrtare aktive të gjykatës. Mungesa e një procesi të centralizuar për mbylljen, ridrejtimin apo arkivimin e faqeve të vjetra pengon transparencën dhe orientimin e saktë të qytetarëve në sistemin e ri gjyqësor.

Gjetje specifike

Organizimi dhe funksionimi i gjykatës

Në përgjithësi, faqet e gjykatave paraqiten me një strukturë të qëndrueshme organizative dhe bazë të qartë informacioni institucional, por me mospërputhje në nivelin e përditësimit, unifikimit dhe transparencës reale.

Publikimet mbi strukturën organizative dhe listën e gjyqtarëve janë të pranishme pothuajse kudo, por mangëson rregullsia në përditësim dhe shpesh mungojnë jetëshkrimet profesionale. Rregulloret e brendshme janë të publikuara, por një pjesë e tyre janë të vjetra dhe të papërditësuara, pa reflektuar ndryshimet e fundit institucionale.

Ka mungesë uniformiteti në mënyrën e paraqitjes së akteve financiare, si raportet buxhetore, regjistrat e prokurimeve dhe raportet e auditimit, të cilat shpesh gjenden në rubrika të shpërndara dhe me format të paqëndrueshëm. Raportet e auditimit publikohen rrallë, pavarësisht rëndësisë së tyre për llogaridhënie.

Rubrika për vendet vakante funksionon rregullisht në shumicën e gjykatave dhe përbën një praktikë pozitive për transparencën në rekrutime, ndonëse haset ende mungesë qartësie dhe standardizimi të njoftimeve.

Në thelb, kategoria reflekton përmbushje formale të transparencës, por kërkon rishikim të përmbajtjes dhe harmonizim të praktikave, sidomos në dokumentet që lidhen me funksionimin e brendshëm, prokurimet dhe raportimin financiar.

Gjetje specifike

Seancat, çështjet dhe vendimet gjyqësore

Kjo kategori përfaqëson bërthamën e transparencës gjyqësore, duke pasqyruar mënyrën si qytetarët informohen mbi zhvillimet dhe vendimmarrjen në gjykata. Në përgjithësi, ka përmirësim të ndjeshëm në ofrimin e informacionit procedural, por mungon uniformiteti dhe përditësimi i rregullt.

Rubrikat për shortin elektronik, listat e çështjeve dhe kalendarin e seancave janë funksionale dhe shpesh interaktive, por informacioni mbetet i shpërndarë në disa seksione dhe jo gjithmonë i plotë. Publikimi i vendimeve gjyqësore është përmirësuar, por në shumë raste ato janë të pjesshme, duke kufizuar transparencën substanciale.

Statistikat gjyqësore paraqiten në formate dhe periudha të ndryshme, pa standard të unifikuar, ndërsa aktet e brendshme dhe formularët audio janë të pranishëm, por jo gjithmonë të shoqëruar me udhëzime praktike. Videot informuese, të parashikuara në Planin e Komunikimit të KLGJ-së, janë publikuar vetëm nga pak gjykata.

Në tërësi, transparenca në këtë kategori është e përmirësuar por jo e plotë, duke kërkuar unifikim të formateve, përditësim më të rregullt dhe përdorim më të gjerë të mjeteve vizuale për ta bërë informacionin më të qartë dhe të aksesueshëm.

Gjetje specifike

Shërbimet e Gjykatës

Kjo kategori pasqyron mënyrën se si gjykatat komunikojnë me qytetarët përmes shërbimeve praktike dhe mjeteve ndihmëse për orientim. Në përgjithësi, faqet gjyqësore ofrojnë informacion bazë mbi kompetencat, procedurat dhe mjetet e aksesit publik, por nivelet e detajimit dhe formatet e paraqitjes ndryshojnë ndjeshëm.

Rubrikat për kompetencat e gjykatës, paraqitjen e padive dhe të drejtën e ankimit janë pothuajse universale dhe përmbajnë udhëzime të qarta për qytetarët. Megjithatë, materialet ndihmëse si fletëpalosjet informuese, udhëzuesit praktikë dhe videot orientuese janë të publikuara në mënyrë fragmentare dhe jo gjithmonë në rubrika të dedikuara.

Informacioni mbi ndihmën juridike falas është i pranishëm në të gjitha faqet, por i shpërndarë në formate të ndryshme (linke, kontakte, materiale vizuale), ndërsa tarifat gjyqësore dhe formularët elektronikë janë funksionalë, por kërkojnë standardizim më të qartë dhe integrim të plotë me portalet e shërbimeve publike.

Në tërësi, kjo kategori tregon përmbushje formale të detyrimeve për transparencë, por kërkon bashkërendim më të mirë ndërmjet përmbajtjeve, përditësim vizual e funksional dhe përdorim më të gjerë të formateve ndërvepruese për të bërë shërbimet gjyqësore më të kuptueshme dhe të aksesueshme për qytetarët.

Gjetje specifike

Informimi dhe komunikimi me publikun

Kjo kategori përfshin mënyrën se si gjykatat sigurojnë transparencë, akses në informacion dhe komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe median. Në tërësi, evidentohet një strukturë funksionale, por e pabarabartë në cilësi dhe unifikim institucional.

Rubrikat për njoftime publike, raportet vjetore dhe regjistrat e kërkesave për informacion janë të pranishme pothuajse në të gjitha faqet, duke garantuar një bazë minimale transparence. Megjithatë, frekuenca, formatet dhe përditësimet ndryshojnë ndjeshëm, sidomos në gjykatat e niveleve të ulëta. Informacioni për koordinatorin e të drejtës për informim, formularët për kërkesa dhe ankesa, si dhe kontaktet institucionale, është i aksesueshëm dhe i organizuar në mënyrë të qëndrueshme, por shpesh mungon detajimi mbi procedurat praktike dhe afatet.

Sa i takon komunikimit institucional, dokumentet si Plani Strategjik i Komunikimit dhe Plani i Komunikimit për Gjykatat 2022–2024 janë të publikuara vetëm nga një pjesë e kufizuar e gjykatave, duke treguar mospërhapje të njëtrajtshme të standardeve të komunikimit publik.

Në tërësi, gjykatat kanë vendosur bazat për një sistem transparent komunikimi, por sfidat mbeten në standardizimin e mënyrës së publikimit, rritjen e përdorimit të rrjeteve sociale dhe zhvillimin e formateve vizuale e interaktive, për të rritur aksesin dhe besimin publik në sistemin gjyqësor.

Gjetje specifike

Marrëdhëniet me median dhe gazetarët

Kjo kategori përfshin mekanizmat përmes të cilëve gjykatat ndërveprojnë me median dhe sigurojnë komunikim transparent mbi aktivitetin e tyre institucional. Në përgjithësi, strukturat për komunikimin me median janë të ngritura, por niveli i zbatimit praktik dhe standardizimit mbetet i pjesshëm. Rubrika "Njoftime për median" është e pranishme në pothuajse të gjitha faqet gjyqësore dhe përmban deklarata, njoftime ose komunikata që lidhen me veprimtarinë gjyqësore. Megjithatë, përmbajtja është shpesh e përzier me njoftime të karakterit administrativ, duke kufizuar qartësinë e saj si kanal i posaçëm për median.

Dokumentet si Rregullorja për komunikimin me median, Udhëzuesi për marrëdhëniet me publikun, si dhe deklaratat e konfidencialitetit dhe pëlqimit për publikimin e të dhënave personale, janë të publikuara nga shumica e gjykatave, por shpesh të shpërndara në rubrika të ndryshme, pa një vendndodhje të unifikuar. Në aspektin e kontakteve, gjyqtari për median dhe nëpunësi për marrëdhëniet me median dhe publikun janë të publikuar në një pjesë të madhe të gjykatave.

Rubrika që lidhen me aktivitetet institucionale dhe publikimet mediatike janë aktive, por vetëm disa gjykata i përdorin në mënyrë të qëndrueshme për të pasqyruar komunikimin me publikun, median dhe eventet.
Në tërësi, marrëdhëniet me median janë të institucionalizuara por jo të konsoliduara, duke kërkuar një qasje më sistematike, të koordinuar dhe vizualisht të unifikuar, në mënyrë që transparenca gjyqësore të shoqërohet me besueshmëri dhe komunikim profesional me median.

Përmbledhje e Pikëve

	E Ulët	Mesatare	E Lartë
Gjykata e Lartë			93
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm		65	
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar		65	
Gjykata e Apelit Administrativ		66	
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë		65	
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar		68	
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë		76	
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës		76	
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan		66	
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier		71	
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			85
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			80
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë		75	
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			83
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë		67	
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë		73	
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër		69	
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër		75	
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës		72	
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë		52	

A

Organizimi dhe funksionimi i gjykatës

Gjyqtarët e Gjykatës

Përshkrim i indikatorit	Lista e gjyqtarëve të gjykatës është një element bazë i transparencës institucionale, pasi u jep qytetarëve dhe palëve të interesuara informacion të qartë mbi trupën gjyqësore që ushtron funksionin e drejtësisë.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar lista e plotë e gjyqtarëve të gjykatës në faqen zyrtare dhe a është ajo e azhornuar?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i listës së gjyqtarëve siguron transparencë mbi përbërjen e trupës gjyqësore dhe ndihmon në rritjen e besimit publik. Ai gjithashtu kontribuon në parimin e llogaridhënies dhe shmang çdo perceptim të mungesës së aksesit në informacion.
Matja e indikatorit	Vlerësimi bëhet mbi bazën e ekzistencës, plotësisë dhe azhornimit: • 0 pikë – lista mungon • 1 pikë – lista ekziston, por është e paplotë ose e vjetëruar • 2 pikë – lista ekziston, është e plotë, e dukshme dhe e azhornuar.

Indikatori i Vlerësimit: Gjyqtarët e Gjykatës

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm		✓		1 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë		✓		1 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë		✓		1 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë		✓		1 pikë

Indikatori i Vlerësimit: Gjyqtarët e Gjykatës

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në të gjitha faqet zyrtare të gjykatave ekziston një rubrikë e veçantë e titulluar "Gjyqtarët e gjykatës". Kjo rubrikë përmban zakonisht një listë me emrat e gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin pranë gjykatës përkatëse. Në një pjesë të madhe të rasteve, lista është e publikuar në mënyrë të qasshme për publikun, por pa të dhëna shtesë për secilin gjyqtar.

Në disa raste, në përmbajtjen e rubrikës janë përfshirë emra gjyqtarësh që nuk e ushtrojnë më funksionin pranë asaj gjykate, ndërsa emrat e gjyqtarëve të sapoemëruar mungojnë. Ka raste kur përmbajtja nuk është e përditësuar për periudha të gjata kohe. Në asnjë prej faqeve nuk shfaqet informacion mbi datën e përditësimit të fundit të listës.

Vetëm në pak raste janë publikuar të dhëna plotësuese mbi gjyqtarët, si jetëshkrime të shkurtra ose përshkrime profesionale. Kjo formë paraqitjeje gjendet kryesisht në faqen e Gjykatës së Lartë, ku secili gjyqtar ka një profil të veçantë me të dhëna identifikuese. Në pjesën tjetër të gjykatave, listat përmbajnë vetëm emrat, pa informacion shtesë mbi përvojën, detyrën apo kontaktet.

Në disa gjykata, përveç rubrikës kryesore, lista e gjyqtarëve është përsëritur edhe në seksione të tjera të faqes. Edhe në këto raste, përmbajtja mbetet e njëjtë me atë që gjendet në rubrikën zyrtare dhe nuk përmban informacion të përditësuar ose të plotë. Përsëritja e listës nuk sjell shtesë të dhënash apo sqarime të mëtejshme për publikun, ndërsa në disa raste versionet e përsëritura përmbajnë të njëjtin përmbajtje tekstuale me ndryshime të vogla në formatim.

Në mënyrën e publikimit, lista e gjyqtarëve shfaqet në një format pothuajse të njëtrajtshëm në të gjitha faqet, zakonisht si renditje lineare e emrave pa elemente të tjera dalluese. Përmbajtja nuk përfshin të dhëna për statusin aktual të gjyqtarëve, për ndarjen sipas funksioneve apo për periudhën e ushtrimit të detyrës. Mungon informacioni i plotë mbi përbërjen e trupës gjyqësore dhe përditësimi i saj mbetet i pjesshëm edhe në rastet kur lista është e përsëritur në rubrika të tjera të faqes.

Struktura/Organigrama e Gjykatës

Përshkrim i indikatorit	Organigrama e gjykatës paraqet strukturën organizative të institucionit, duke treguar njësitë, sektorët dhe hierarkinë administrative. Ajo pasqyron mënyrën se si është ndërtuar organizativisht gjykata dhe lidhjet ndërmjet funksioneve.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar organigrama e gjykatës në faqen zyrtare dhe a reflekton ajo strukturën aktuale të institucionit?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i organigramës rrit transparencën institucionale duke i dhënë publikut një pamje të qartë mbi funksionimin e brendshëm të gjykatës. Ai ndihmon qytetarët dhe palët e interesuara të kuptojnë se cilat njësi dhe sektorë ekzistojnë dhe si ndahen përgjegjësitë administrative.
Matja e indikatorit	Vlerësimi bëhet mbi bazën e ekzistencës, qartësisë dhe azhornimit: • 0 pikë – organigrama mungon • 1 pikë – organigrama ekziston, por është e vjetëruar ose jo e plotë • 2 pikë – organigrama ekziston, është e qartë, e aksesueshme dhe e azhornuar sipas strukturës aktuale.

Indikatori i Vlerësimit: Struktura/Organigrama e Gjykatës

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Struktura/Organigrama e Gjykatës

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave ekziston një rubrikë e dedikuar për strukturën organizative, e cila në shumicën e rasteve mban titullin "Struktura e Gjykatës". Kjo rubrikë është pjesë përbërëse e seksionit "Gjykata" dhe përmban informacion mbi ndarjen e brendshme strukturore të institucionit, përfshirë njësitë administrative, zyrat ndihmëse dhe drejtuesit e tyre.

Në përmbajtje, organigrama pasqyron hierarkinë dhe funksionet kryesore të gjykatës, duke përfshirë:

- organet drejtuese (Kryetari i Gjykatës, Këshilli i Gjykatës),
- sektorët administrativë (personeli gjyqësor, financa, statistika, IT, marrëdhëniet me publikun),
- si dhe raportet vertikale të përgjegjësisë ndërmjet njësive.
-

Ky publikim ndihmon qytetarët, median dhe aktorët institucionalë të kuptojnë strukturën funksionale dhe zinxhirin e përgjegjësive, duke përmirësuar transparencën e brendshme dhe llogaridhënien administrative të gjykatës.

Përveç rubrikës së dedikuar, informacion mbi organigramën e gjykatës parashikohet edhe brenda "Programit të Transparencës", konkretisht në komponentin që lidhet me "Rreth autoritetit". Ky seksion përfshin të dhëna për strukturën, organikën dhe drejtuesit e njësive përbërëse, të cilat shpesh publikohen në format dokumenti (PDF) ose si skemë grafike e organigramës.

Megjithatë, në disa raste, organigrama nuk është e publikuar në rubrikën përkatëse të faqes, por vetëm në programin e transparencës, gjë që tregon mungesë uniformiteti në mënyrën e publikimit. Në raste të tjera, përmbajtja e organigramës është e pjesshme, pa informacion mbi përbërjen e plotë të njësive ndihmëse ose pa përditësim të datës së fundit të miratimit.

Në përmbledhje, organigrama e gjykatës është e pranishme në pjesën më të madhe të faqeve, qoftë në formë grafike apo dokumentare, por vendet e publikimit dhe niveli i përditësimit ndryshojnë nga një gjykatë në tjetrën. Për këtë arsye, elementi konsiderohet i përmbushur në pjesën më të madhe të rasteve, por me mangësi në standardizim dhe në centralizimin e informacionit nën një rubrikë të vetme.

Rregullore e Brendshme e Gjykatës

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat ekzistencën dhe publikimin e Rregullores së Brendshme të Gjykatës, dokument që përcakton mënyrën e organizimit të brendshëm, procedurat e funksionimit, detyrat e organeve drejtuese, si dhe marrëdhëniet ndërmjet gjyqtarëve dhe stafit administrativ.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar në faqen zyrtare të gjykatës Rregullorja e Brendshme dhe a është ajo e aksesueshme për publikun?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është thelbësor për transparencën institucionale dhe llogaridhënien e brendshme, pasi rregullorja e brendshme siguron zbatimin e standardeve të menaxhimit të drejtësisë, përcakton përgjegjësitë administrative dhe garanton qartësi mbi mënyrën se si funksionon gjykata në praktikë. Publikimi i saj ndihmon qytetarët dhe palët e interesuara të kuptojnë funksionimin e institucionit.
Matja e indikatorit	y është një indikator statik-normativ, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe përditësimin e dokumentit: • 0 pikë – rregullorja mungon • 1 pikë – ekziston, por është e pjesshme, jo e qartë, e vjetëruar ose jo e lehtësisht e aksesueshme • 2 pikë – ekziston rregullore e plotë, e qartë, e azhurnuar, e publikuar në format të shkarkueshëm (PDF/Word) dhe e vendosur në rubrikën përkatëse të transparencës në faqen zyrtare të gjykatës.

Indikatori i Vlerësimit: Rregullore e brendshme e Gjykatës

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë		✓		1 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë		✓		1 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Rregullore e brendshme e Gyjkatës

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave ekziston një rubrikë e dedikuar "Rregullore të gjykatës", ku parashikohet publikimi i rregulloreve që lidhen me funksionimin dhe organizimin e brendshëm të institucionit.

Përveç kësaj rubrike kryesore, rregulloret janë gjithashtu të përfshira edhe në nënrubrikën "Rregullore" brenda Programit të Transparencës, si dhe si një komponent i veçantë brenda vetë programit, çka tregon për një strukturim formal të këtij informacioni në disa nivele të faqes zyrtare.

Megjithatë, përmbajtja e këtyre rubrikave nuk është gjithmonë e qartë ose e kategorizuar saktë. Në shumë raste, nën seksionin "Rregullore të gjykatës" janë përfshirë dokumente të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me rregulloren e brendshme, si p.sh. kode etike, udhëzime ose dokumente të përgjithshme institucionale. Kjo e bën informacionin të përzier dhe jo gjithmonë të dallueshëm për publikun.

Një element tjetër për t'u theksuar është fakti që edhe pse disa gjykata kanë publikuar rregulloren e tyre të brendshme ose rregullore të tjera të brendshme organizative, këto dokumente shpesh janë të vjetra dhe nuk janë përditësuar për të reflektuar ndryshimet e fundit institucionale, përfshirë ato që lidhen me riformatimin e hartës gjyqësore apo riorganizimin e strukturave administrative.

Në përgjithësi, rubrika "Rregullore të gjykatës" ekziston dhe është funksionale në pjesën më të madhe të faqeve zyrtare, por përmbajtja e saj kërkon unifikim, përditësim dhe kategorizim më të saktë të dokumenteve për të mundësuar një akses më të qartë dhe të strukturuar për publikun.

Kodi i Etikës Gjyqësore

Përshkrim i indikatorit	Kodi i Etikës Gjyqësore përmban standardet dhe parimet e sjelljes etike që duhet të respektojnë gjyqtarët në ushtrimin e funksionit të tyre. Ai është një dokument themelor për integritetin dhe profesionalizmin e sistemit gjyqësor.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar në faqen zyrtare të gjykatës Kodi i Etikës Gjyqësore dhe a është versioni i tij i fundit në fuqi?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i Kodit të Etikës garanton transparencë mbi standardet që rregullojnë sjelljen e gjyqtarëve, forcon besimin e publikut tek gjykatat dhe shërben si mjet orientues për qytetarët dhe profesionistët e drejtësisë mbi pritshmëritë etike.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik dhe vlerësohet mbi bazën e ekzistencës dhe azhornimit: • 0 pikë – Kodi mungon në faqen e gjykatës • 1 pikë – Kodi ekziston, por është i vjetëruar ose jo i aksesueshëm qartë • 2 pikë – Kodi ekziston, është i qartë, i aksesueshëm dhe përputhet me versionin më të fundit në fuqi.

Indikatori i Vlerësimit: Kodi i Etikës Gjyqësore

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Kodi i Etikës Gjyqësore

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave nuk ekziston një rubrikë e veçantë e dedikuar vetëm për Kodin e Etikës Gjyqësore (Vendimi i KLGJ Nr. 171, date 22.04.2021 për miratimin e "Kodi i Etikës Gjyqësore"). Në strukturën standarde të faqeve, ky dokument nuk është i vendosur si kategori më vete, por parashikohet nëpërmjet nenpikatëve të programit të transparencës, konkretisht në pjesën që lidhet me aktet ligjore dhe rregullatore.

Në pjesën më të madhe të rasteve, Kodi i Etikës Gjyqësore është i publikuar në faqet e gjykatave, por jo në një vend të unifikuar. Vendndodhja e dokumentit ndryshon nga një faqe në tjetrën. Në disa raste, kodi është i vendosur te rubrika "Rregullore të gjykatës", në të tjera te "Publikime", "Njoftime për publikun", "Njoftime të tjera", ose brenda materialeve të programit të transparencës.

Në disa faqe, kodi shfaqet si dokument i vetëm i ngarkuar në format PDF, ndërsa në të tjera është përfshirë si pjesë e një pakete aktesh të bashkangjitura, ku përfshihen edhe ligje dhe rregullore të tjera. Në disa raste, kodi i etikës është i vendosur në më shumë se një rubrikë, duke u përsëritur në mënyrë të ngjashme në pjesë të ndryshme të faqes.

Janë konstatuar edhe disa raste kur Kodi i Etikës Gjyqësore nuk është i publikuar në asnjë nga rubrikat ekzistuese, megjithëse parashikohet në programin e transparencës. Në këto raste, rubrika përkatëse nuk përmban asnjë lidhje ose dokument aktiv që e çon tek kodi.

Në përmbajtjen e faqeve, formatet dhe mënyra e prezantimit të dokumentit janë të ndryshme, por teksti i publikuar është i njëjtë, duke iu referuar kodit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Pjesa më e madhe e publikimeve janë të qasshme për shkarkim, ndërsa në disa raste dokumenti hapet drejtpërdrejt në faqe.

Në përgjithësi, Kodi i Etikës Gjyqësore është i pranishëm në pothuajse të gjitha faqet e gjykatave, por pozicionimi i tij ndryshon në varësi të mënyrës së ndërtimit të faqes dhe të rubrikave ndihmëse. Nuk ka një standard unik për vendosjen e tij, por dokumenti rezulton i aksesueshëm në të paktën një nga rubrikat kryesore të secilës faqe gjyqësore.

Akte dhe Dokumente mbi Vendimmarrjen e Këshillit të Gjykatës

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator i referohet publikimit të akteve, vendimeve dhe dokumenteve të nxjerra nga Këshilli i Gjykatës. Ai pasqyron procesin e vendimmarrjes administrative dhe garanton informim të qartë mbi mënyrën se si merren dhe zbatohen vendimet institucionale.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A janë publikuar në faqen zyrtare të gjykatës aktet dhe vendimmarrjet e Këshillit të Gjykatës dhe a përfshijnë ato vitin e fundit?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i vendimmarrjeve është një mjet kyç për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së gjykatës si institucion. Ai lejon qytetarët dhe palët e interesuara të ndjekin proceset administrative, të kuptojnë logjikën e vendimeve dhe të ushtrojnë të drejtën e tyre për mbikëqyrje publike.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik dhe vlerësohet mbi bazën e viteve radhazi: • 0 pikë – nuk ka asnjë akt/vendim të publikuar • 1 pikë – ekzistojnë publikime vetëm për 1–2 vite ose mungon viti i fundit • 2 pikë – aktet/vendimet janë publikuar rregullisht për të paktën 3 vite radhazi, duke përfshirë vitin më të fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Akte dhe Dokumente mbi Vendimmarrjen e Këshillit të Gjykatës

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë		✓		1 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Akte dhe Dokumente mbi Vendimmarrjen e Këshillit të Gjykatës

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave është e pranishme një rubrikë e dedikuar për Këshillin e Gjykatës, e përfshirë në strukturën standarde të çdo faqeje gjyqësore. Rubrika përdoret për publikimin e materialeve që lidhen me mbledhjet dhe vendimmarrjet e këtij organi, si njoftime, procesverbale ose vendime.

Në të gjitha nivelet e gjyqësorit, kjo rubrikë është funksionale dhe përmban dokumente të publikuara në mënyrë të vazhdueshme ndër vite. Periudhat e mbuluara nga publikimet janë shumëvjeçare dhe shtrihen zakonisht nga viti 2019 ose 2020 deri në vitin 2025. Përmbajtja përditësohet rregullisht, duke e bërë këtë një nga rubrikat më aktive dhe më të qëndrueshme në faqet zyrtare të gjykatave.

Në disa raste, informacioni që lidhet me Këshillin e Gjykatës është i përfshirë edhe në rubrikën "Të dhënat e hapura", ku janë publikuar dokumente që pasqyrojnë mbledhjet, vendimmarrjet apo aktet e tjera përkatëse të këtij organi.

Gjithashtu, dokumente që lidhen me mbledhjet e Këshillit të Gjykatës gjenden të shpërndara edhe në rubrika të tjera të faqeve zyrtare, përveç asaj kryesore. Në disa raste, materialet janë publikuar në rubrikat "Njoftime për publikun", "Njoftime për median", "Rregullore të gjykatës" ose "Publikime". Në raste të veçanta, përmbajtje që lidhen me vendimmarrje apo nisma të këshillit gjenden edhe në seksione të tjera informuese të faqes, në varësi të mënyrës së organizimit të saj.

Në përmbajtje, materialet janë të qasshme dhe të organizuara sipas viteve ose në formë liste, pa dallime të mëdha ndërmjet faqeve të gjykatave. Rubrika "Mbledhja e Këshillit të Gjykatës" paraqitet si një nga seksionet më të konsoliduara dhe më të përditësuara në të gjithë sistemin gjyqësor, duke ofruar një pasqyrë të qëndrueshme të dokumenteve që lidhen me mbledhjet dhe aktet vendimmarrëse të këtij organi.

Raport Vjetor për Zbatimin e Buxhetit dhe Anekset

Përshkrim i indikatorit	Raporti vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset përkatëse përmbajnë të dhëna mbi përdorimin e fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit për gjykatën gjatë vitit. Ai përfshin shpenzimet reale krahasuar me planifikimin fillestar, si dhe anekset me të dhëna të detajuara financiare.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar online raporti vjetor për zbatimin e buxhetit të gjykatës dhe a përfshin ai të dhënat e vitit më të fundit me anekset shpjeguese?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i këtij raporti është thelbësor për transparencën financiare dhe llogaridhënien institucionale. Ai u jep qytetarëve, mediave dhe organizatave monitoruese mundësinë të shohin si përdoren fondet publike dhe nëse ka devijime midis planit dhe realizimit.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik dhe vlerësohet mbi bazën e viteve radhazi: • 0 pikë – raporti mungon krejtësisht • 1 pikë – ekziston raporti, por vetëm për 1–2 vite ose mungon ai i vitit të fundit • 2 pikë – raporti është publikuar rregullisht për të paktën 3 vite radhazi, duke përfshirë vitin më të fundit me anekset shoqëruese.

Indikatori i Vlerësimit: Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë		✓		1 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave nuk ekziston një rubrikë e veçantë e dedikuar për buxhetin dhe zbatimin e tij. Ky informacion është i parashikuar kryesisht nëpërmjet programit të transparencës, në seksionin që lidhet me të dhënat financiare dhe dokumentet që pasqyrojnë menaxhimin buxhetor të institucionit.

Në pjesën më të madhe të rasteve, informacioni mbi buxhetin gjendet vetëm në materialet e programit të transparencës, ku janë të publikuara dokumentet përkatëse sipas strukturës së përcaktuar nga modeli standard. Megjithatë, ka raste kur raportet e monitorimit të buxhetit ose materiale që lidhen me zbatimin e tij gjatë vitit janë publikuar edhe në rubrika të tjera të faqes, si "Publikime", "Njoftime për publikun" ose "Rregullore të gjykatës".

Gjithashtu, në disa gjykata janë publikuar dokumente që lidhen me buxhetin edhe në rubrikën "Të dhënat e hapura", ku gjenden të dhëna mbi planifikimin financiar, shpenzimet vjetore apo raportet për zbatimin e buxhetit. Këto raste përbëjnë një formë shtesë të publikimit, përtej materialeve të përfshira në programin e transparencës.

Në përmbajtje, materialet që lidhen me zbatimin e buxhetit nuk paraqiten në mënyrë të njëtrajtshme. Ka gjykata që kanë publikuar dokumentet për disa vite radhazi dhe e kanë bërë këtë në mënyrë të sistematizuar, ndërsa të tjera kanë publikime të fragmentuara vetëm për disa periudha të kufizuara. Në disa raste, dokumentet janë publikuar vetëm për një vit ose për një periudhë disa mujore, dhe në raste të tjera nuk janë të pranishme materiale të kësaj natyre.

Në përgjithësi, informacioni për zbatimin e buxhetit është i përfshirë brenda programit të transparencës dhe, në disa raste, në rubrika shtesë të faqes, por niveli i publikimit dhe vazhdimësia në vite ndryshon. Materialet që ekzistojnë paraqiten në formate të ndryshme, në varësi të mënyrës së organizimit të faqes dhe të periudhës që mbulojnë dokumentet përkatëse.

Raporte Auditimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Kontrolli i Lartë i Shtetit

Përshkrim i indikatorit	Raportet e auditimit të realizuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor përfshijnë kontrollin e menaxhimit financiar, administrativ dhe organizativ të gjykatave. Publikimi i tyre siguron transparencë mbi përdorimin e burimeve publike dhe respektimin e rregullave të menaxhimit.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A janë publikuar online raportet e auditimit të kryera nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për gjykatën dhe a përfshijnë ato vitin e fundit?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i raporteve të auditimit rrit llogaridhënien financiare dhe institucionale, duke ofruar garanci për qytetarët dhe institucionet mbikëqyrëse se gjykatat menaxhojnë me transparencë fondet dhe burimet publike. Këto raporte janë gjithashtu një mjet parandalues ndaj korrupsionit dhe keqmenaxhimit.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, i vlerësuar mbi bazën e viteve radhazi: • 0 pikë – nuk ka asnjë raport auditimi të publikuar • 1 pikë – ekzistojnë raporte auditimi, por vetëm për 1–2 vite ose mungon viti i fundit • 2 pikë – raportet e auditimit janë publikuar rregullisht për të paktën 3 vite radhazi, duke përfshirë vitin më të fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Raporte Auditimi

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Raporte Auditimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave janë të parashikuara raportet e auditimit si pjesë e detyrimeve të transparencës institucionale. Këto raporte zakonisht përgatiten nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), përmes Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, ose në disa raste nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), në varësi të objektit të auditimit dhe kompetencave të përfshira.

Në përgjithësi, një pjesë e madhe e gjykatave kanë publikuar raporte të tilla në faqet e tyre zyrtare, duke siguruar akses publik në dokumente që lidhen me menaxhimin financiar, administrativ dhe operacional të institucioneve. Këto raporte ndihmojnë në forcimin e llogaridhënies dhe kontrollit të brendshëm administrativ.

Duhet theksuar se Programi i Transparencës përmban një komponent të dedikuar për raportet e auditimit, ku është parashikuar në mënyrë të qartë publikimi i këtyre dokumenteve, si pjesë e detyrueshme e informacionit që duhet të jetë i hapur për publikun. Megjithatë, në praktikë, raportet e auditimit shpesh gjenden të shpërndara në disa rubrika të faqes, përfshirë “Publikime”, “Të dhënat e hapura” ose “Njoftime të tjera”, në varësi të mënyrës së organizimit të faqes së secilës gjykatë.

Në disa raste, raportet e publikuara janë të pjesshme ose i përkasin vetëm disa viteve të fundit, ndërsa në të tjera janë të përditësuara në mënyrë të rregullt dhe të plotë. Pavarësisht kësaj, ekzistenca e tyre në shumicën e faqeve tregon një zbatim të dukshëm të kërkesave të transparencës, edhe pse me nevojë për unifikim dhe përqendrim më të qartë të informacionit në një rubrikë të vetme.

Regjistri i Parashikimeve të Prokurimit Publik

Përshkrim i indikatorit	Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik përmban planin vjetor të procedurave të prokurimit që gjykata parashikon të zhvillojë gjatë vitit. Ky dokument është i detyrueshëm sipas legjislacionit mbi prokurimin publik dhe një element themelor i transparencës financiare.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar online regjistri i parashikimeve të prokurimit publik të gjykatës dhe a përfshin ai vitin e fundit?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i këtij regjistri ndihmon në parandalimin e abuzimeve dhe favorizimit në prokurime, rrit transparencën mbi planifikimin e shpenzimeve publike dhe u mundëson operatorëve ekonomikë dhe publikut të interesuar të kenë qasje në informacion paraprak mbi kontratat publike.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, vlerësuar mbi bazën e viteve radhazi: • 0 pikë – nuk ka asnjë regjistër të publikuar • 1 pikë – ekziston regjistri, por vetëm për 1–2 vite ose mungon viti i fundit • 2 pikë – regjistri është publikuar rregullisht për të paktën 3 vite radhazi, duke përfshirë vitin më të fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Regjistri i Parashikimeve të Prokurimit Publik

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë		✓		1 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Regjistri i Parashikimeve të Prokurimit Publik

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave nuk ekziston një rubrikë e veçantë e dedikuar për regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik. Ky informacion është i përfshirë në mënyrë standarde në programin e transparencës, në seksionin që lidhet me të dhënat financiare dhe dokumentet mbi procedurat e prokurimit.

Në pjesën më të madhe të rasteve, dokumentet që lidhen me parashikimet e prokurimit publik janë të publikuara vetëm brenda programit të transparencës, sipas strukturës së përcaktuar për këtë rubrikë. Publikimet përmbajnë të dhëna mbi procedurat e planifikuara dhe, në disa raste, edhe dokumente që pasqyrojnë realizimin e tyre gjatë vitit.

Ashtu si në rastin e informacionit buxhetor, në disa faqe raportet mbi parashikimet e prokurimeve gjenden gjithashtu në rubrikën "Të dhënat e hapura", ku janë publikuar materiale që lidhen me planifikimin apo zbatimin e procedurave të prokurimit publik. Në raste të tjera, dokumente të lidhura me këtë temë janë publikuar edhe në rubrika të tjera të faqes, si "Publikime", "Njoftime për publikun", "Njoftime për median", ose "Njoftime të tjera". Këto publikime paraqesin forma shtesë të informimit, të cilat ndryshojnë në varësi të mënyrës së organizimit të faqes së secilës gjykatë.

Në përmbajtje, dokumentet për regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik nuk janë të njëtrajtshme në kohë. Ka raste kur materialet janë publikuar për disa vite radhazi dhe ndjekin një logjikë të rregullt përditësimi; raste kur publikimet janë të fragmentuara dhe mbulojnë vetëm disa vite të caktuara; si dhe raste kur dokumentet janë të kufizuara në një periudhë të shkurtër ose mungojnë plotësisht.

Në përgjithësi, informacioni mbi parashikimet e prokurimeve publike është i përfshirë kryesisht në programin e transparencës dhe në disa raste edhe në rubrika shtesë të faqes, por frekuenca dhe vazhdimësia e publikimit ndryshojnë. Formatet dhe periudhat e mbuluara ndryshojnë nga një faqe në tjetrën, në varësi të organizimit dhe ritmit të përditësimit të informacionit.

Regjistri i Realizimeve të Prokurimit Publik

Përshkrim i indikatorit	Regjistri i realizimit të prokurimit përmban të dhëna mbi kontratat e përfunduara dhe procedurat e zhvilluara gjatë vitit nga gjykata. Ai është dokument që pasqyron realisht shpenzimet dhe menaxhimin financiar të institucionit.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar online regjistri i realizimit të prokurimit për vitin dhe a përfshin ai të dhënat e vitit më të fundit?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky regjistër është një instrument i rëndësishëm për llogaridhënien financiare, pasi u mundëson qytetarëve dhe palëve të interesuara të shohin sesi janë përdorur fondet publike. Publikimi i tij ndihmon në parandalimin e korrupsionit dhe rrit transparencën në përdorimin e burimeve financiare.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik dhe vlerësohet mbi bazën e viteve radhazi: • 0 pikë – nuk ka asnjë regjistër të publikuar • 1 pikë – ekziston regjistri, por vetëm për 1–2 vite ose mungon viti i fundit • 2 pikë – regjistri është publikuar rregullisht për të paktën 3 vite radhazi, duke përfshirë vitin më të fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Regjistri i Realizimeve të Prokurimit Publik

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë		✓		1 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm		✓		1 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë		✓		1 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Regjistri i Realizimeve të Prokurimit Publik

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave nuk ekziston një rubrikë e veçantë e dedikuar për regjistrin e realizimeve të prokurimit publik. Ky informacion është i përfshirë brenda programit të transparencës, në pjesën që trajton dokumentet financiare dhe të dhënat mbi prokurimet.

Në shumicën e rasteve, dokumentet që pasqyrojnë realizimin e procedurave të prokurimit publik janë të publikuara në mënyrë standarde në programin e transparencës, ku përfshihen të dhëna mbi procedurat e zhvilluara dhe rezultatet përkatëse. Përmbajtja e dokumenteve ndryshon në varësi të periudhës së raportimit dhe mënyrës së organizimit të faqes.

Në disa raste, materialet që lidhen me realizimet e prokurimeve janë publikuar gjithashtu në rubrikën "Të dhënat e hapura", ku janë përfshirë dokumente që përmbajnë të dhëna mbi kontratat e përfunduara, vlerat financiare dhe përmbledhje të shkurtuara të procedurave të zhvilluara.

Gjithashtu, informacioni për realizimet e prokurimeve gjendet shpesh i shpërndarë në rubrika të tjera të faqes, si "Publikime", "Njoftime për publikun", "Njoftime për median" ose "Njoftime të tjera". Kjo mënyrë e paraqitjes bën që i njëjti material ose dokument të përsëritet në disa seksione të faqes, në vend që të jetë i përqendruar në një rubrikë të vetme. Si pasojë, informacioni rezulton i shpërndarë në disa pika dhe jo i grupuar në mënyrë të unifikuar, gjë që ndikon në qartësinë e pasqyrimit të të dhënave.

Në përmbajtje, frekuenca dhe vazhdimësia e publikimeve ndryshojnë. Ka raste kur dokumentet janë publikuar rregullisht për disa vite radhazi, raste kur publikimet janë të pjesshme ose të fragmentuara, dhe raste kur raportet janë të kufizuara në periudha shumë të shkurtra.

Në përgjithësi, informacioni mbi regjistrin e realizimeve të prokurimit publik është i pranishëm në programin e transparencës dhe, në disa raste, në rubrika shtesë të faqes, por përsëritja dhe shpërndarja e dokumenteve në disa seksione e bën informacionin më pak të përqendruar dhe të organizuar në një vend të vetëm.

Vendet vakante në shërbimin civil gjyqësor

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator i referohet publikimit online të njoftimeve për vendet vakante në shërbimin civil gjyqësor (administrata e gjykatës). Ai përfshin shpalljen e konkurseve, afatet, kriteret e përzgjedhjes dhe mënyrën e aplikimit.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A janë publikuar rregullisht njoftimet për vendet vakante në shërbimin civil gjyqësor dhe a përfshijnë ato vitin e fundit?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i vendeve vakante rrit transparencën dhe siguron barazi në akses për kandidatë, duke garantuar rekrutime meritore dhe paanshmëri në përzgjedhjen e nëpunësve civilë të gjykatave. Ai është gjithashtu një mekanizëm parandalues ndaj klientelizmit dhe mungesës së transparencës.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, i vlerësuar mbi bazën e vazhdimësisë: • 0 pikë – asnjë njoftim për vende vakante nuk është publikuar • 1 pikë – ekzistojnë njoftime, por vetëm të pjesshme (1–2 vite ose mungon viti i fundit) • 2 pikë – njoftimet për vendet vakante janë publikuar rregullisht për të paktën 3 vite radhazi, duke përfshirë vitin më të fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Vendet vakante në shërbimin civil gjyqësor

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Vendet vakante në shërbimin civil gjyqësor

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Rubrika e dedikuar për vendet vakante në shërbimin civil gjyqësor është një nga seksionet më funksionale të faqeve zyrtare, duke shërbyer si mjet i drejtpërdrejtë transparence për proceset e rekrutimit dhe lëvizjes në shërbimin gjyqësor. Publikimet në këtë rubrikë janë të qëndrueshme në kohë, duke u shtrirë në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2021 deri në vitin 2025, çka dëshmon për funksionalitet të plotë dhe përdorim të rregullt të saj për njoftime mbi pozicione të lira pune.

Në përmbajtje, njoftimet përfshijnë informacion mbi pozicionin e punës, kriteret e pranueshmërisë, afatet e aplikimit, si dhe dokumentacionin e kërkuar, duke plotësuar kërkesat bazë të transparencës administrative. Në disa raste, rubrika përmban gjithashtu njoftime të përbashkëta që përfshijnë vende të lira edhe për gjykata të tjera, një praktikë që, ndonëse lehtëson aksesin e kandidatëve, krijon njëfarë mungese qartësie institucionale në ndarjen e informacionit sipas gjykatës përkatëse.

Ritmi i përditësimit të njoftimeve nuk është uniform. Disa institucione e përditësojnë rubrikën në mënyrë të vazhdueshme, përfshirë publikime deri në muajt shtator-tetor 2025, ndërsa në raste të tjera përditësimet ndalen më herët gjatë vitit, duke reflektuar intensitet të ndryshëm të aktivitetit administrativ.

Megjithëse rubrika “Vende vakante” është e pranishme në të gjitha faqet e gjykatave, mungon një standard i unifikuar për formatin dhe strukturën e publikimeve. Dallimet vërehen në mënyrën e titullimit, renditjes dhe klasifikimit të njoftimeve, çka sugjeron nevojën për një harmonizim të mëtejshëm institucional në prezantimin e informacionit për rekrutim.

B

Seancat, çështjet dhe vendimet gjyqësore

Informacion mbi Shortin Gjyqësor

Përshkrim i indikatorit	Informacionet mbi shortin lidhen me publikimin e mënyrës së shpërndarjes së çështjeve gjyqësore ndërmjet gjyqtarëve përmes sistemit elektronik apo procedurave të tjera ligjore. Publikimi i këtij informacioni është garanci për paanshmërinë dhe shmangien e konfliktit të interesit.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A publikohet rregullisht informacion mbi shortin gjyqësor (hedhjet e çështjeve) dhe a përfshin ai vitin më të fundit?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është thelbësor për të garantuar paanshmërinë dhe transparencën në shpërndarjen e çështjeve. Ai rrit besimin e publikut se gjyqtarët nuk zgjedhin rastet vetë dhe se procesi është i drejtë dhe objektiv.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, i vlerësuar mbi bazën e vazhdimësisë: • 0 pikë – informacioni mbi shortin mungon • 1 pikë – informacioni ekziston, por është i pjesshëm, jo i azhurnuar ose nuk përfshin vitin e fundit • 2 pikë – informacioni ekziston, është i plotë, i qartë, i aksesueshëm dhe i publikuar rregullisht për të paktën 3 vite radhazi, duke përfshirë vitin më të fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Informacione mbi Shortin Gjyqësor

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Informacione mbi Shortin Gjyqësor

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave ekziston një rubrikë e dedikuar me titull "Informacion mbi shortin", e cila shërben për publikimin e të dhënave mbi shpërndarjen elektronike të çështjeve gjyqësore. Kjo rubrikë është interaktive, pasi i mundëson përdoruesit të kërkojë informacion sipas datës, gjyqtarit apo tipit të shortit, duke gjeneruar automatikisht një raport për periudhën e zgjedhur.

Në pjesën e sipërme të faqes ndodhet një filtruese kohore me dy fusha — Nga data dhe Deri në datën — për përzgjedhjen e intervalit kohor. Pas vendosjes së datave, klikimi mbi butonin "View Report" gjeneron automatikisht një tabelë dinamike me të dhëna të tilla si:

- Numri i çështjes
- Tipi i shortit
- Gjyqtari përgjegjës
- Titulli i çështjes
- Palët në proces

Këto të dhëna krijohen nga sistemi elektronik i gjykatës dhe përditësohen në kohë reale, duke siguruar një formë transparente, të menjëhershme dhe të aksesueshme për publikun mbi mënyrën e shpërndarjes së çështjeve gjyqësore. Kjo ndërfaqe përfaqëson një mjet të rëndësishëm për monitorimin e paanshmërisë dhe eficiencës së procesit të shortit, në përputhje me standardet e transparencës publike.

Megjithatë, pavarësisht ekzistencës së këtij sistemi interaktiv, informacione mbi shortin publikohen shpesh edhe në rubrika të tjera të faqes, si "Njoftime për publikun", "Publikime" ose "Njoftime të tjera". Kjo tregon se, përveç sistemit elektronik, gjykatat vazhdojnë të përdorin edhe forma të tjera komunikimi për t'i bërë publike të dhënat mbi shortet, veçanërisht kur bëhet fjalë për njoftime të përgjithshme ose përditësime shtesë.

Në përgjithësi, rubrika "Informacion mbi shortin" është funksionale dhe përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt dixhitalizimit dhe hapjes së të dhënave, megjithëse informacioni mbështetës mbi shortet gjyqësore vijon të jetë i shpërndarë në disa pjesë të faqes, duke kërkuar një strukturim më të unifikuar të publikimeve.

Lista e Çështjeve për Gjykim

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e listës së përditësuar të çështjeve për gjykim në faqen zyrtare të gjykatës. Lista duhet të përfshijë datën e seancës, numrin e çështjes, palët, dhe gjyqtarin/shkallën përkatëse, në përputhje me kërkesat e transparencës gjyqësore dhe udhëzimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A publikohet në mënyrë të rregullt dhe të përditësuar lista e çështjeve për gjykim në faqen zyrtare të gjykatës?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është thelbësor për të garantuar akses publik në proceset gjyqësore dhe për të forcuar besimin në drejtësi. Ai mundëson informimin paraprak të palëve dhe transparencë në menaxhimin e kalendarit të gjykatës, duke kontribuar në parimin e “gjykimit publik”.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, i vlerësuar mbi bazën e rregullshmërisë së publikimit: • 0 pikë – lista e çështjeve për gjykim mungon • 1 pikë – ekziston lista, por është e pjesshme, jo e përditësuar rregullisht ose nuk përfshin të gjitha datat • 2 pikë – lista publikohet rregullisht, në mënyrë të plotë dhe të azhurnuar, duke përfshirë vazhdimisht çështjet për gjykim për të paktën 3 periudha radhazi (javore/mujore) dhe vitin më të fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Lista e çështjeve në gjykim

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Lista e çështjeve për gjykim

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave ekziston një rubrikë e dedikuar për listën e çështjeve për gjykim, e cila ndodhet në seksionin "Çështjet gjyqësore" dhe përfshin në mënyrë të ndarë çështjet civile, penale dhe administrative, në varësi të juridiksionit të gjykatës. Kjo rubrikë është interaktive dhe lejon kërkimin dinamik të çështjeve nëpërmjet disa filtrave të integruar, si:

- Numri i çështjes ose aktit,
- Lloji i çështjes (civile, penale, administrative),
- Statusi i çështjes,
- Emri i gjyqtarit,
- Datat e regjistrimit dhe të vendimit.

Pas vendosjes së parametrave të kërkimit, sistemi gjeneron një tabelë automatike me të dhënat përkatëse, ku shfaqen:

- Numri i aktit dhe i vendimit,
- Emri i gjyqtarit,
- Palët në proces,
- Data e regjistrimit dhe e vendimit,
- Një kolonë me opsionin "Detaje" për shikimin e mëtejshëm të informacionit.

Kjo ndërfaqe interaktive përbën një mjet të drejtpërdrejtë transparence, pasi mundëson që çdo përdorues të informohet për çështjet në shqyrtim, datat përkatëse dhe gjyqtarët përgjegjës, duke rritur nivelin e qasjes në të dhënat procedurale. Megjithatë, krahas këtij sistemi elektronik, disa gjykata publikojnë listat e çështjeve për gjykim edhe në formë dokumentesh të veçanta (PDF). Këto publikime shpesh gjenden në rubrika të tjera të faqes, si "Njoftime për publikun", "Publikime", ose "Njoftime të tjera". Në këto raste, listat mund të jenë javore, mujore apo të ndara sipas gjyqtarëve përkatës, duke pasqyruar një praktikë më tradicionale të komunikimit institucional, që plotëson sistemin dixhital. Në përmbajtje, rubrika "Lista e çështjeve për gjykim" është funksionale dhe përfshirëse, por mungesa e një standardi unik për mënyrën e publikimit — ndërmjet sistemit interaktiv dhe dokumenteve të ngarkuara manualisht — e bën informacionin të fragmentuar në disa seksione të faqes. Në tërësi, sistemi interaktiv për listat e çështjeve për gjykim siguron një transparencë të lartë procedurale, ndërsa publikimet shtesë në rubrika të tjera e plotësojnë informacionin për rastet ku të dhënat paraqiten në formate të përmbledhura ose periodike.

Kalendari i Seancave Gjyqësore

Përshkrim i indikatorit	Kalendari i seancave gjyqësore është një rubrikë online ku publikohen datat, oraret dhe sallat e zhvillimit të seancave. Ai është një element thelbësor i transparencës dhe i aksesit të publikut në procesin gjyqësor.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A publikohet dhe azhurnohet rregullisht kalendari i seancave gjyqësore në faqen zyrtare të gjykatës dhe a përfshin ai vitin më të fundit?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për garantimin e parimit të publicitetit të procesit gjyqësor, për informimin e palëve, avokatëve dhe publikut, si dhe për rritjen e transparencës dhe besimit tek gjykatat.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, i vlerësuar mbi bazën e vazhdimësisë: • 0 pikë – kalendari i seancave mungon • 1 pikë – kalendari ekziston, por është i paplotë, jo i azhurnuar rregullisht ose nuk përfshin vitin e fundit • 2 pikë – kalendari ekziston, është i plotë, i qartë, i aksesueshëm dhe azhurnohet rregullisht për të paktën 3 vite radhazi, duke përfshirë vitin më të fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Kalendari i Seancave Gjyqësore

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Kalendari i Seancave Gjyqësore

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave ekziston një rubrikë e dedikuar me titull "Kalendari i seancave", e cila shërben për publikimin e të dhënave mbi planifikimin ditor të seancave gjyqësore. Kjo rubrikë është plotësisht interaktive, duke i mundësuar përdoruesit të kërkojë dhe të filtrojë informacionin sipas datës së zhvillimit të seancës, gjyqtarit, apo tipit të çështjes.

Në pjesën e sipërme të faqes ndodhen fushat për përzgjedhjen e periudhës kohore – Nga data dhe Deri në datën – që lejojnë gjenerimin automatik të kalendarit për ditën ose periudhën e interesuar. Pas kërkimit, sistemi shfaq një tabelë dinamike që përfshin të dhëna si:

- Numri i çështjes,
- Data dhe ora e fillimit dhe përfundimit të seancës,
- Salla ku zhvillohet seanca,
- Palët pjesëmarrëse (Pala 1 dhe Pala 2),
- Lloji ose përshkrimi i çështjes.

Ky modul elektronik përditësohet në mënyrë automatike dhe ofron një pasqyrë të qartë të veprimtarisë gjyqësore ditore, duke i mundësuar publikut dhe palëve të interesuara të informohen në kohë reale për zhvillimin e seancave. Për shkak të këtij funksionaliteti, rubrika përbën një nga mjetet më të rëndësishme të transparencës proaktive në sistemin gjyqësor.

Megjithatë, informacione mbi kalendarin e seancave publikohen shpesh edhe në rubrika të tjera të faqes së gjykatës, si "Njoftime për publikun", "Publikime" ose "Njoftime të tjera". Në këto raste, gjykatat ngarkojnë dokumente në format PDF që përmbajnë listat e seancave për periudha më të gjata — javore, mujore apo sipas gjyqtarëve përkatës. Kjo praktikë tregon një kombinim midis publikimit dixhital dhe formës tradicionale të njoftimit, që synon të garantojë akses të plotë në informacion edhe për përdoruesit që nuk shfrytëzojnë kërkimin interaktiv.

Në përgjithësi, "Kalendari i seancave" është një sistem funksional dhe transparent, që pasqyron në mënyrë të vazhdueshme aktivitetin gjyqësor, por përmbajtjet shtesë që ndodhen në rubrika të tjera të faqes tregojnë mungesë uniformiteti në mënyrën e publikimit. Një përqendrim i gjithë informacionit në rubrikën interaktive do të ndihmonte në forcimin e qartësisë dhe aksesueshmërisë për publikun.

Vendimet e gjykatës për çështjet

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjykata, të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare, në përputhje me standardet e transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale (sipas Ligjit nr. 119/2014 dhe udhëzimeve të KLGJ-së për publikimin e vendimeve).
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A janë publikuar vendimet e gjykatës në faqen zyrtare dhe a përfshijnë ato vendimet e viteve të fundit të aktivitetit gjyqësor?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i vendimeve gjyqësore është thelbësor për transparencën, arsyetimin ligjor dhe llogaridhënien e gjyqësorit. Ai ndihmon qytetarët, juristët dhe studiuesit të kuptojnë praktikat gjyqësore, kontribuon në unifikimin e jurisprudencës dhe në forcimin e besimit publik në sistemin e drejtësisë.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe vazhdimësinë e publikimit: • 0 pikë – asnjë vendim gjyqësor nuk është publikuar në faqen zyrtare • 1 pikë – ekziston publikim i pjesshëm (p.sh. vetëm disa vendime ose pa përditësim për vitet e fundit) • 2 pikë – vendimet publikohen rregullisht, në mënyrë të plotë dhe të përditësuar, duke përfshirë të paktën 3 vite radhazi dhe vitin më të fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Vendimet e gjykatës për çështjet

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm		✓		1 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar		✓		1 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë		✓		1 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar		✓		1 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë		✓		1 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë		✓		1 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Vendimet e gjykatës për çështjet

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave, vendimet gjyqësore janë të aksesueshme përmes një sistemi të dedikuar elektronik, që mundëson publikimin dhe kërkimin e vendimeve të dhëna nga gjykata përkatëse. Ky sistem funksionon përmes rubrikës "Çështjet gjyqësore", ku në çdo listë çështjesh shfaqet opsioni "Detaje", që hap një dritare të veçantë me informacionin e plotë mbi çështjen dhe vendimin përkatës.
Në ndërfaqen e këtij sistemi paraqiten elemente kyçe si:

- Numri i çështjes dhe i aktit,
- Data e regjistrimit dhe tipi i çështjes,
- Lloji i fillimit dhe statusi i procedimit,
- Objekti i padisë dhe kategoria ligjore,
- Palët përkatëse dhe historiku i seancave,
- Seksione të dedikuara për vendimin përfundimtar dhe për vendimet e mëparshme.

Një element me rëndësi të veçantë është fusha për shkarkimin e vendimit të anonimizuar, e cila siguron balancën ndërmjet transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Ky mekanizëm i lejon publikun të njihet me përmbajtjen e vendimeve pa ekspozuar informacion të ndjeshëm për palët në proces.

Megjithatë, pavarësisht përmirësimeve të dukshme në këtë drejtim, transparenca mbi vendimet gjyqësore nuk është ende e përmbushur plotësisht. Në shumë raste, vendimet publikohen vetëm në pjesë të tyre, duke përfshirë zakonisht vetëm dispozitivin ose përfundimin, pa arsyetimin e plotë ligjor. Gjithashtu, ka raste kur vendimet nuk janë të publikuara për të gjitha çështjet ose nuk shfaqen në mënyrë të rregullt për të gjitha periudhat kohore.

Një veçori e rëndësishme është fakti se vendimet gjyqësore përbëjnë materialin e vetëm që publikohet ekskluzivisht brenda këtij sistemi elektronik, pa u përsëritur në ndonjë rubrikë tjetër të faqes së gjykatës. Ato nuk gjenden në "Publikime", "Njoftime" apo në rubrika të tjera mbështetëse, çka e bën këtë modul kanalin e vetëm të dedikuar për aksesin publik në aktet vendimmarrëse të gjykatave.

Statistikat Gjyqësore

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e statistikave vjetore të gjykatës që lidhen me numrin e çështjeve të regjistruara, të përfunduara, në shqyrtim, afatet mesatare të gjykimit dhe tregues të tjerë të performancës, në përputhje me Udhëzuesin e Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave".
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A janë publikuar në faqen zyrtare të gjykatës statistikat gjyqësore dhe a përfshijnë ato vitet e fundit të aktivitetit gjyqësor?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është thelbësor për llogaridhënien institucionale dhe matjen e performancës gjyqësore. Publikimi i statistikave ndihmon qytetarët, studiuesit dhe institucionet të vlerësojnë ecurinë e gjykatës në trajtimin e çështjeve, ngarkesën e punës dhe efektivitetin e saj, duke nxitur transparencën dhe besimin në sistemin e drejtësisë.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, i vlerësuar mbi bazën e vazhdimësisë dhe përditësimit të publikimit: • 0 pikë – statistikat gjyqësore mungojnë plotësisht • 1 pikë – ekziston publikim i pjesshëm ose për një vit të vetëm, pa përditësim për vitet e fundit • 2 pikë – statistikat gjyqësore publikohen rregullisht dhe në mënyrë të plotë për të paktën 3 vite radhazi, duke përfshirë vitin më të fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Statistikat gjyqësore

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit: Statistikat gjyqësore

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave ekziston një rubrikë e dedikuar për statistikat gjyqësore, e cila përbën një nga elementet më të rëndësishme dhe më kompleksë të transparencës institucionale. Kjo rubrikë është interaktive, duke i mundësuar përdoruesit të kërkojë dhe të shikojë të dhëna statistikore sipas periudhës, llojit të çështjeve (civile, penale, administrative) dhe kategori-ve specifike, si për shembull: numri i çështjeve të regjistruara, të përfunduara, koha mesatare e shqyrtimit dhe dinamika e veprimtarisë gjyqësore.

Në ndërfaqen interaktive, përdoruesi mund të përzgjedhë periudhën e raportimit dhe vitin përkatës, pas së cilës sistemi gjeneron automatikisht një tabelë statistikore me treguesit bazë të performancës së gjykatës. Kjo formë elektronike e raportimit siguron qasje të drejtpërdrejtë në të dhëna, duke e bërë më të lehtë ndjekjen e ngarkesës dhe ecurisë së çështjeve në kohë reale.

Megjithatë, informacioni statistikor nuk është i përqendruar në një rubrikë të vetme. Përveç seksionit kryesor "Statistika", të dhëna të ngjashme gjenden të publikuara edhe në rubrika të tjera të faqes, si "Programi i Transparencës", "Të dhënat e hapura", apo në faqen hyrëse (homepage), ku shpesh përfshihen përditësime mbi ngarkesën gjyqësore ose rezultatet vjetore. Kjo shpërndarje e gjerë e informacionit e bën qasjen më të pasur, por në të njëjtën kohë e vështirëson unifikimin dhe identifikimin e burimit kryesor të të dhënave.

Një tjetër element për t'u theksuar është mungesa e uniformitetit në formatin, përmbajtjen dhe periodicitetin e statistikave. Disa gjykata publikojnë statistikat sipas formateve të përcaktuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), të tjera ndjekin modelin e Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa një pjesë i paraqesin drejt nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve, pa ndërhyrje redaktuese. Po ashtu, periudhat raportuese variojnë, nga tremujore dhe gjashtëmujore deri te vjetore, ndërsa disa gjykata i përgatisin dhe i përpunojnë vetë në format të personalizuar.

Në përmbajtje, statistikat gjyqësore ofrojnë një pasqyrë të gjerë të funksionimit të sistemit, por mënyra e publikimit të tyre mbetet jo e standardizuar dhe e fragmentuar, duke reflektuar qasje të ndryshme ndërmjet gjykatave si në aspektin teknik, ashtu edhe në atë metodologjik.

Akte të brendshme që rregullojnë zhvillimin e seancave dhe administrimin e çështjeve

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e akteve të brendshme normative të miratuara nga gjykata (p.sh. rregullore të brendshme, udhëzime, urdhra të kryetarit të gjykatës apo të këshillit të gjykatës) që rregullojnë mënyrën e zhvillimit të seancave gjyqësore, administrimin e dosjeve, shpërndarjen e çështjeve me short, oraret dhe rregullat e sjelljes në sallë.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A janë publikuar në faqen zyrtare të gjykatës aktet e brendshme që përcaktojnë rregullat për zhvillimin e seancave gjyqësore dhe administrimin e çështjeve?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator vlerëson nivelin e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale të gjykatës në raport me standardet e procesit të rregullt ligjor. Publikimi i këtyre akteve ndihmon qytetarët, avokatët dhe palët në proces të kuptojnë procedurat e brendshme që garantojnë paanësinë, rregullin dhe efikasitetin e administrimit të drejtësisë.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-normativ, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe qartësinë e dokumenteve të publikuara: • 0 pikë – mungojnë aktet e brendshme për zhvillimin e seancave dhe administrimin e çështjeve • 1 pikë – ekzistojnë dokumente të pjesshme ose jo të plota • 2 pikë – ekzistojnë akte të plota dhe të aksesueshme, që rregullojnë qartë zhvillimin e seancave dhe administrimin e çështjeve në faqen zyrtare.

Indikatori i Vlerësimit: Akte të brendshme që rregullojnë zhvillimin e seancave dhe administrimin e çështjeve

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Lista e kreditorëve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Shumica e gjykatave kanë të publikuara në faqet e tyre zyrtare akte të brendshme që lidhen me rregullimin e zhvillimit të seancave gjyqësore dhe administrimin e çështjeve, duke përfshirë urdhra të brendshëm, udhëzime administrative apo vendime organizative të gjykatës. Këto dokumente janë pjesë e rëndësishme e transparencës institucionale, pasi përcaktojnë mënyrën e funksionimit të brendshëm dhe standardet procedurale që ndjekin gjykatat në administrimin e proceseve gjyqësore.

Në strukturën e faqeve zyrtare, ekziston zakonisht një rubrikë e dedikuar për "Urdhra të Gjykatës" apo "Akte të Brendshme", ku vendosen këto dokumente. Megjithatë, vërehet se informacioni mbetet i shpërndarë në rubrika të ndryshme brenda faqes, si "Njoftime", "Publikime", "Lista e çështjeve për gjykim", apo në rubrikën që lidhet me "Shortin e gjykatës". Në disa raste, dokumentet janë të përfshira edhe në seksione që kanë karakter më të përgjithshëm, si "Të dhënat e hapura" ose "Programi i transparencës".

Përmbajtja e akteve të publikuara lidhet kryesisht me:

- procedurat për shpërndarjen automatike të çështjeve (shorti),
- rregullimin e zhvillimit të seancave gjyqësore,
- organizimin e orareve të seancave dhe përdorimin e sallave,
- si dhe me menaxhimin e ngarkesës gjyqësore dhe veprimtarive administrative të brendshme.
-

Në disa faqe, dokumentet janë të përditësuara dhe të ndara sipas viteve, ndërsa në të tjera paraqiten pa datim të qartë ose në formë të pjesshme. Po ashtu, mungon një standard unik për titullimin dhe klasifikimin e këtyre akteve, gjë që vështirëson identifikimin dhe qasjen e drejtpërdrejtë të publikut në informacionin përkatës.
Në tërësi, edhe pse ekziston një prani e dukshme e këtyre akteve në faqet e gjykatave, informacioni është i fragmentuar dhe i organizuar në mënyrë jo të njëtrajtshme, duke reflektuar nevojën për konsolidim dhe unifikim të rubrikës në mënyrë që dokumentet e natyrës së brendshme të jenë lehtësisht të identifikueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

Formulari i kërkesës për kopje të regjistrimit audio

Përshkrim i indikatorit	Formulari i kërkesës për kopje të regjistrimit audio është dokument standard që u jep qytetarëve ose palëve në proces gjyqësor mundësinë të aplikojnë për të marrë një kopje të regjistrimit audio të seancës gjyqësore, në përputhje me ligjin dhe rregulloret përkatëse.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar online formulari i kërkesës për kopje të regjistrimit audio dhe a është i aksesueshëm për qytetarët?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të garantuar transparencën e procedurave gjyqësore, për të forcuar të drejtën e palëve për informacion dhe për të rritur besimin tek gjykata.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-binar, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe përditësimin: • 0 pikë – formulari mungon • 1 pikë – formulari ekziston, por është i pjesshëm, jo i plotë ose jo lehtësisht i aksesueshëm • 2 pikë – formulari ekziston, është i plotë, i qartë, i aksesueshëm dhe i azhornuar sipas modelit ligjor.

Indikatori i Vlerësimit: Formulari i kërkesës për kopje të regjistrimit audio

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Formulari i kërkesës për kopje të regjistrimit audio

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave është i publikuar formulari standard për kërkesën e kopjes së regjistrimit audio nga publiku, sipas formatit të miratuar për të gjitha gjykatat. Ky formular shërben për të mundësuar kërkesën zyrtare nga publiku për të marrë kopje të regjistrimit audio të seancave gjyqësore. Ai përdoret nga palët e interesuara, qytetarët apo përfaqësuesit ligjorë që dëshirojnë të aksesojnë regjistrimin audio të një seance të zhvilluar në gjykatë, në përputhje me rregullat për transparencën dhe aksesin në informacion gjyqësor. Formulari përcakton të dhënat identifikuese të kërkuesit, të seancës përkatëse dhe mënyrën e marrjes së kopjes së regjistrimit.

Dokumenti është i aksesueshëm në shumicën e faqeve gjyqësore dhe përmban modelin zyrtar që përdoret për paraqitjen e kërkesës nga qytetarët apo palët e interesuara.
Ashtu si disa dokumente të tjera institucionale, formulari nuk është i vendosur në një rubrikë të vetme të dedikuar, por gjendet i shpërndarë në rubrika të ndryshme të faqeve të gjykatave. Në pjesën më të madhe të rasteve, ai është publikuar në seksione si “Rregullore të gjykatës”, “Pasqyra e shtypit”, “Njoftime për publikun” ose “Njoftime të tjera”, në varësi të strukturës së faqes përkatëse.

Në disa raste, dokumenti gjendet edhe në rubrikën “Publikime” ose përfshihet si bashkëngjitje në materialet informuese për shërbimet ndaj publikut. Ky variacion në mënyrën e vendosjes bën që formulari të jetë i pranishëm në shumicën e faqeve, por jo gjithmonë në një vend të unifikuar ose të parashikueshëm për përdoruesin.

Formati i dokumentit është i njëtrajtshëm në të gjitha rastet, në përputhje me versionin zyrtar të publikuar në portalin kombëtar të gjykatave.

Video informuese rreth kërkimit të informacionit mbi çështjen gjyqësore

Përshkrim i indikatorit	Videoja informuese shpjegon për qytetarët procedurën e marrjes së informacionit mbi një çështje gjyqësore (p.sh. në cilën rubrikë të faqes të kërkojnë, si të përdorin regjistrin elektronik, çfarë dokumentesh nevojiten). Ajo ofron udhëzim praktik dhe të thjeshtuar.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A ka publikuar gjykata një video informuese që udhëzon qytetarët se si të kërkojnë informacion mbi çështjen gjyqësore?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm sepse ndihmon qytetarët të kuptojnë dhe përdorin në praktikë të drejtën e tyre për informacion gjyqësor. Ai lehtëson aksesin në drejtësi dhe ul pengesat administrative, duke rritur transparencën dhe besimin tek gjykata.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-sensibilizues, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe qartësinë: • 0 pikë – videoja mungon • 1 pikë – videoja ekziston, por është e pjesshme, jo e qartë ose e vjetëruar • 2 pikë – videoja ekziston, është e plotë, e qartë, praktike, e aksesueshme dhe e azhornuar sipas mënyrës aktuale të funksionimit të sistemit gjyqësor.

Indikatori i Vlerësimit: Video informuese rreth kërkimit të informacionit mbi çështjen gjyqësore

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Video informuese rreth kërkimit të informacionit mbi çështjen gjyqësore

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Ky indikator është i parashikuar në Planin e Komunikimit për Gjykatat 2022-2024, si një element i rëndësishëm për lehtësimin e aksesit të publikut në informacion mbi çështjet gjyqësore. Qëllimi i këtij materiali është të udhëzojë qytetarët në mënyrë të thjeshtë dhe vizuale për mënyrën se si mund të kërkojnë dhe gjejnë informacion për çështjet e tyre përmes faqeve zyrtare të gjykatave ose sistemeve elektronike për ndjekjen e proceseve gjyqësore.

Pavarësisht parashikimit të qartë në dokumentet strategjike të komunikimit, rezulton se vetëm një numër shumë i kufizuar gjykatash kanë përgatitur dhe publikuar një video të tillë në faqet e tyre. Në ato pak raste ku ekziston, videoja është e vendosur në faqen hyrëse (homepage) ose në seksionin "Multimedia", duke u përdorur si mjet orientues për qytetarët që kërkojnë të informohen mbi statusin e një çështjeje apo mbi mënyrën e navigimit në sistemet online të gjykatave.

Mungesa e gjerë e këtij materiali tregon se komponenti vizual i komunikimit institucional mbetet i pazhvilluar në pjesën më të madhe të faqeve gjyqësore, megjithëse ai përbën një instrument praktik dhe efektiv për rritjen e transparencës dhe aksesueshmërisë së publikut. Në disa faqe ku videoja është publikuar, ajo shoqërohet me përshkrime të shkurtra ose lidhje drejt rubrikave ku ndodhen listat e çështjeve për gjykim apo kalendari i seancave, duke ofruar një përvojë më të plotë informimi për përdoruesin.

Vlen të theksohet se ky indikator është përfshirë si element i veçantë në vlerësimin e transparencës, pasi proceset gjyqësore përbëjnë një fushë ku qytetarët shpesh hasin vështirësi për të gjetur informacionin e nevojshëm. Një video e tillë, e realizuar sipas modelit të rekomanduar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, do të kontribuonte ndjeshëm në shpjegimin praktik të mënyrës së kërkimit të informacionit, uljen e barrës administrative për gjykatat dhe përmirësimin e komunikimit publik të sistemit gjyqësor në tërësi.

Në përfundim, prania shumë e kufizuar e këtij materiali në faqet gjyqësore mbetet një mangësi e dukshme në zbatimin e standardeve të komunikimit me publikun, ndërkohë që potenciali i tij për të rritur qartësinë, transparencën dhe ndërveprimin me qytetarët është i lartë dhe i pazëvendësueshëm.

Video informuese rreth përdorimit të informacionit mbi shortin

Përshkrim i indikatorit	Videoja informuese shpjegon në mënyrë të thjeshtuar për publikun si funksionon shorti gjyqësor për shpërndarjen e çështjeve, si mund të konsultohet informacioni mbi shortin dhe pse është e rëndësishme kjo procedurë për paanshmërinë e procesit gjyqësor.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A ka publikuar gjykata një video informuese për përdorimin e informacionit mbi shortin dhe a është ajo e aksesueshme për publikun?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të rritur transparencën dhe besimin e publikut se shpërndarja e çështjeve gjyqësore bëhet në mënyrë të paanshme dhe të drejtë. Edukimi i publikut mbi këtë mekanizëm ul perceptimet e ndërhyrjeve të jashtme dhe rrit legjitimitetin e procesit gjyqësor.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-sensibilizues, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe cilësinë: • 0 pikë – videoja mungon • 1 pikë – videoja ekziston, por është e pjesshme, jo e qartë ose e vjetëruar • 2 pikë – videoja ekziston, është e plotë, e qartë, praktike, e aksesueshme dhe e azhornuar sipas procedurave aktuale të shortit.

Indikatori i Vlerësimit: Video informuese rreth përdorimit të informacionit mbi shortin

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Video informuese rreth përdorimit të informacionit mbi shortin

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Ky indikator është i parashikuar në Planin e Komunikimit për Gjykatat 2022-2024 dhe synon të lehtësojë kuptueshmërinë dhe aksesin e publikut në procesin e shpërndarjes së çështjeve gjyqësore përmes shortit elektronik. Videoja informuese është konceptuar si një mjet praktik për të shpjeguar, në mënyrë të thjeshtë dhe vizuale, se si funksionon shorti gjyqësor, cilat janë garancitë e tij ligjore dhe si mund të konsultohen publikisht të dhënat përkatëse në faqet zyrtare të gjykatave.
Në praktikë, vetëm një numër shumë i kufizuar gjykatash e kanë përgatitur dhe publikuar këtë video informuese në faqet e tyre. Në rastet kur ajo është e pranishme, videoja zakonisht vendoset në faqen hyrëse (homepage) ose në seksionin "Multimedia", duke i ofruar qytetarëve një udhëzues të drejtpërdrejtë mbi mënyrën e përdorimit të rubrikës "Shorti i Gjykatës". Këto materiale synojnë të orientojnë publikun për të kuptuar mënyrën e shpërndarjes së çështjeve, transparencën e procesit dhe funksionimin e sistemit elektronik që garanton parimin e rastësisë në caktimin e gjyqtarëve.

Megjithatë, në pjesën më të madhe të faqeve gjyqësore, kjo video mungon, edhe pse procesi i shortit përbën një nga komponentët më të rëndësishëm të transparencës në sistemin gjyqësor. Informacioni mbi shortin ekziston në rubrikat përkatëse të faqeve, shpesh në formë interaktive, por mungon materiali vizual shpjegues që e bën këtë informacion më të kuptueshëm dhe të përdorshëm për publikun e gjerë.

Përfshirja e këtij materiali si indikator i veçantë është e justifikuar nga fakti se shorti gjyqësor është një proces me rëndësi të lartë për besueshmërinë publike, por që shpesh perceptohet si kompleks nga qytetarët për shkak të terminologjisë teknike dhe mënyrës së prezantimit në faqe. Një video shpjeguese, e realizuar sipas modeleve të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, do të kontribuonte ndjeshëm në rritjen e transparencës procedurale, forcimin e besimit publik dhe uljen e konfuzionit në lidhje me mënyrën e shpërndarjes së çështjeve.

Në përfundim, mungesa e këtyre videove në pjesën më të madhe të faqeve gjyqësore përbën një boshllëk të dukshëm në zbatimin e standardeve të komunikimit proaktiv, ndërkohë që potenciali i këtij materiali për sqarimin vizual dhe edukimin qytetar në lidhje me proceset e brendshme të drejtësisë mbetet i lartë dhe i pashfrytëzuar.

Video informuese rreth përdorimit të kalendarit të seancave

Përshkrim i indikatorit	Videoja informuese shpjegon si mund të përdoret kalendari i seancave gjyqësore nga qytetarët: si të gjendet në faqen zyrtare, si të filtrohen datat, çfarë informacioni jep dhe si ndihmon palët të ndjekin procesin gjyqësor.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A ka publikuar gjykata një video informuese për përdorimin e kalendarit të seancave gjyqësore dhe a është ajo e aksesueshme për publikun?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të rritur transparencën dhe lehtësuar aksesin e qytetarëve tek informacioni procedural. Ai ndihmon publikun të kuptojë si të përdorë kalendarin online për të gjetur datat/oraret e seancave, duke forcuar parimin e publicitetit të procesit gjyqësor.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-sensibilizues, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe cilësinë: • 0 pikë – videoja mungon • 1 pikë – ekziston, por është e pjesshme, jo e qartë ose e vjetëruar • 2 pikë – videoja ekziston, është e plotë, e qartë, praktike, e aksesueshme dhe e azhornuar sipas mënyrës aktuale të funksionimit të kalendarit.

Indikatori i Vlerësimit: Video informuese rreth përdorimit të kalendarit të seancave

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Video informuese rreth përdorimit të kalendarit të seancave

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Ky indikator është pjesë e parashikuar e Planit të Komunikimit për Gjykatat 2022-2024, me qëllim rritjen e transparencës dhe lehtësimin e aksesit publik në informacionin mbi oraret dhe zhvillimin e seancave gjyqësore. Videoja informuese synon të udhëzojë qytetarët, në mënyrë të qartë dhe vizuale, se si të përdorin rubrikën "Kalendari i seancave" për të gjetur të dhënat mbi datën, orën, gjyqtarin dhe sallën e zhvillimit të çështjeve.

Megjithëse ky element është parashikuar si pjesë integrale e komunikimit publik gjyqësor, shumica e gjykatave nuk e kanë të publikuar një video të tillë në faqet e tyre zyrtare. Në ato pak raste ku është e pranishme, ajo zakonisht vendoset në faqen hyrëse (homepage) ose në rubrikën "Multimedia", duke shërbyer si udhëzues praktik për përdoruesit që kërkojnë informacion mbi kalendarin ditor apo javor të seancave. Videoja ka funksion orientues dhe ndihmon qytetarët të kuptojnë se si mund të kërkojnë seancat sipas datës, llojit të çështjes apo gjyqtarit, si dhe mënyrën e leximit të informacionit që shfaqet në seksionin interaktiv të faqes. Kjo formë komunikimi është veçanërisht e dobishme për publikun e gjerë, pasi shumë përdorues e kanë të vështirë të navigojnë vetë në strukturat teknike të faqeve ose të kuptojnë terminologjinë juridike që përdoret në njoftime.

Në pjesën më të madhe të rasteve, mungesa e këtyre materialeve tregon një mospërdorim të potencialit vizual dhe edukues të mjeteve të komunikimit publik, të cilat janë të parashikuara në dokumentet strategjike të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Materialet e tilla mund të kontribuojnë ndjeshëm në përmirësimin e ndërveprimit me qytetarët, duke reduktuar paqartësitë dhe duke rritur qasjen e tyre në informacionet bazë të procedurave gjyqësore.

Në përfundim, përfshirja shumë e kufizuar e videove informuese për kalendarin e seancave përfaqëson një boshllëk në zbatimin e plotë të standardeve të komunikimit institucional. Këto materiale kanë vlerë të veçantë në ndërtimin e një marrëdhënieje të qartë dhe të kuptueshme midis sistemit gjyqësor dhe publikut, duke shërbyer si instrument praktik për rritjen e transparencës dhe besimit në proceset gjyqësore.

C

Shërbimet e Gjykatës

Informacion mbi kompetencat e gjykatës

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e përmbajtjes shpjeguese mbi kompetencat materiale, territoriale dhe funksionale të gjykatës, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, Civile ose Administrative (sipas rastit) dhe aktet përkatëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar në faqen zyrtare të gjykatës informacion i qartë mbi kompetencat e saj dhe juridiksionin që ushtron?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është themelor për aksesin e qytetarëve në drejtësi dhe për informimin ligjor të publikut. Ai ndihmon qytetarët të kuptojnë nëse një çështje hyn në kompetencën e kësaj gjykate, duke shmangur keqkuptime ose referime të gabuara procedurale. Publikimi i qartë i këtij informacioni është një tregues i transparencës bazike institucionale.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-informues, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe cilësinë e informacionit: • 0 pikë – mungon çdo informacion mbi kompetencat e gjykatës • 1 pikë – ekziston informacion i pjesshëm ose jo i qartë (p.sh. përmendet vetëm lloji i gjykatës, pa shpjegim të kompetencave specifike) • 2 pikë – ekziston informacion i plotë, i qartë dhe i aksesueshëm, që shpjegon në mënyrë të kuptueshme kompetencat materiale, territoriale dhe funksionale të gjykatës.

Indikatori i Vlerësimit: Informacion mbi kompetencat e gjykatës

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Informacion mbi kompetencat e gjykatës

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave është e pranishme një rubrikë e dedikuar për informacionin mbi kompetencat dhe funksionimin e gjykatës, e cila përfshihet zakonisht në pjesën hyrëse të faqes ose në rubrikën "Gjykata". Kjo rubrikë përmban një përshkrim të përgjithshëm të fushës së juridiksionit të gjykatës, llojit të çështjeve që shqyrton, si dhe mënyrës së organizimit të saj.

Përmbajtja e kësaj rubrike është e qasshme në të gjitha nivelet e gjyqësorit dhe përmban informacion të përditësuar dhe të plotë mbi rolin dhe kompetencat funksionale të gjykatës, duke përfshirë juridiksionin lëndor dhe atë territorial. Në shumicën e faqeve, informacioni është i shprehur në mënyrë të qartë, përmes një përshkrimi të shkurtër që shpjegon fushat e veprimit dhe kompetencat përkatëse të gjykatës.

Në disa faqe, përveç përshkrimit të përgjithshëm, janë përfshirë edhe referenca ndaj dispozitave ligjore që përcaktojnë kompetencat, si dhe sqarime shtesë mbi mënyrën e ndarjes së çështjeve apo funksioneve brenda gjykatës. Në raste të tjera, përmbajtja është më e përmbledhur, por ruan të njëjtin qëllim informues për publikun.

Rubrika mbi kompetencat përbën një nga seksionet më të qëndrueshme dhe më uniformë në të gjitha faqet gjyqësore, duke ofruar një përshkrim bazë të funksioneve të gjykatës dhe mënyrës së organizimit të saj. Teksti është i formuluar në mënyrë standarde dhe i përshtatur me nivelin e gjykatës, pa ndryshime të mëdha ndërmjet faqeve.

Në përgjithësi, informacioni mbi kompetencat e gjykatës është i përqendruar në rubrikën përkatëse dhe përmban të dhëna të qarta, të qasshme dhe të strukturuara, duke shërbyer si pikë orientuese për qytetarët dhe palët e interesuara mbi rolin, funksionin dhe juridiksionin e secilës gjykatë.

Informacion orientues për qytetarët mbi mënyrën e paraqitjes së një kërkese padie

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e informacionit udhëzues mbi mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së një kërkese padie në gjykatë — përfshirë formatin e saj, dokumentacionin shoqërues, mënyrën e dorëzimit, taksën gjyqësore dhe sportelet përgjegjëse.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A ka publikuar gjykata në faqen e saj zyrtare udhëzime të qarta për mënyrën e paraqitjes së një kërkese padie nga qytetarët?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për aksesin praktik në drejtësi dhe informimin ligjor të qytetarëve. Ai ndihmon personat pa përfaqësim ligjor të kuptojnë hapat themelorë për fillimin e një procesi gjyqësor dhe redukton barrierat administrative për marrjen e shërbimeve të gjykatës. Publikimi i këtij informacioni tregon përkushtim ndaj transparencës dhe qasjes së barabartë në drejtësi.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-praktik, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe qartësinë e udhëzimit: • 0 pikë – mungon çdo informacion orientues për mënyrën e paraqitjes së padisë • 1 pikë – ekziston informacion i pjesshëm, jo i plotë ose jo i qartë (p.sh. pa udhëzime të hollësishme ose pa referencë për dokumentacionin shoqërues) • 2 pikë – ekziston informacion i plotë, i qartë dhe i aksesueshëm, që përfshin hapat, dokumentet, tarifat dhe mënyrën e dorëzimit të kërkesës padie.

Indikatori i Vlerësimit: Informacion orientues për qytetarët mbi mënyrën e paraqitjes së një kërkese padie

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Informacion orientues për qytetarët mbi mënyrën e paraqitjes së një kërkese padie

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave është e pranishme një rubrikë e dedikuar për informacionin orientues për qytetarët, e cila ka për qëllim ofrimin e udhëzimeve bazë mbi mënyrën e paraqitjes së një kërkese padie pranë gjykatës. Kjo rubrikë gjendet në mënyrë të qëndrueshme në faqet e gjykatave të të gjitha niveleve, zakonisht me titujt "Informacion për qytetarët" ose "Udhëzime për paraqitjen e kërkesës padie".

Në përmbajtje, rubrika përfshin sqarime të qarta dhe të strukturuara mbi hapat që duhet të ndiqen për paraqitjen e një padie, dokumentet që kërkohen, vendin e dorëzimit dhe formatin e kërkesës. Në disa raste, teksti shoqërohet me udhëzime plotësuese ose shembuj orientues që ndihmojnë qytetarët të kuptojnë procedurën fillestare të depozitimit të padive.

Informacioni është i paraqitur në mënyrë të qasshme dhe të kuptueshme për publikun, pa nevojë për navigim të ndërlikuar. Në një pjesë të gjykatave, përmbajtja gjendet drejtpërdrejt në faqen hyrëse (homepage), si pjesë e seksionit informues të dedikuar për qytetarët, ndërsa në të tjera është e vendosur në rubrikën e posaçme që trajton këtë temë.

Në përgjithësi, ky informacion është i përqendruar dhe lehtësisht i aksesueshëm, duke shërbyer si udhëzues praktik për qytetarët që duan të paraqesin një kërkesë padie pranë gjykatës.

Informacion për qytetarët mbi të drejtën e ankimit dhe rekursit

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e informacionit orientues që shpjegon të drejtën e qytetarëve për të paraqitur ankim ose rekurs ndaj vendimeve gjyqësore, afatet ligjore për ushtrimin e tyre, mënyrën e depozitimit të ankimit dhe gjykatat kompetente për shqyrtim.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	Ky indikator është i rëndësishëm për garantimin e së drejtës për mjet juridik efektiv dhe për informimin procedural të qytetarëve. Ai siguron që palët të kuptojnë në mënyrë të qartë mundësitë që kanë për të kundërshtuar vendimet gjyqësore, duke rritur transparencën dhe besimin në procesin gjyqësor.
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i tarifave siguron transparencë mbi kostot e shërbimeve gjyqësore dhe rrit besimin e publikut tek barazia e aksesit në drejtësi. Ai është gjithashtu një mekanizëm për të shmangur arbitraritetin apo praktikat joformale.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-procedural, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe cilësinë e informacionit: • 0 pikë – mungon informacioni mbi të drejtën e ankimit dhe rekursit • 1 pikë – ekziston informacion i pjesshëm ose jo i qartë (p.sh. përmendje të përgjithshme pa afate dhe pa procedurë) • 2 pikë – ekziston informacion i plotë, i qartë dhe i aksesueshëm, që shpjegon procedurën, afatet dhe gjykatat kompetente për ankim dhe rekurs.

Indikatori i Vlerësimit: Informacion për qytetarët mbi të drejtën e ankimit dhe rekursit

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Informacion për qytetarët mbi të drejtën e ankimit dhe rekursit

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave ekziston një rubrikë e dedikuar që titullohet "Si të bëjmë një ankim në gjykatë", e cila synon të informojë qytetarët mbi procedurat dhe mënyrat e ushtrimit të së drejtës së ankimit dhe rekursit. Kjo rubrikë është e strukturuar për të ofruar udhëzime praktike dhe të kuptueshme për qytetarët, duke ndihmuar në rritjen e aksesit në drejtësi dhe kuptueshmërisë së proceseve gjyqësore.

Pjesa më e madhe e gjykatave e kanë aktivizuar këtë rubrikë dhe kanë vendosur aty informacion përkatës mbi të drejtën e ankimit dhe rekursit, si dhe mbi mënyrën e paraqitjes së ankimeve pranë gjykatës përkatëse. Përmbajtja e publikuar zakonisht përfshin përshkrimin e hapave kryesorë të procedurës, afatet ligjore dhe organet kompetente për shqyrtimin e ankimeve.

Në disa raste, informacioni është i plotësuar edhe me referenca ligjore ose me lidhje drejt formularëve përkatës, duke e bërë rubrikën funksionale dhe të qasshme për publikun. Përmes këtij seksioni, gjykatat përmbushin një nga kërkesat themelore të transparencës në raport me qytetarët, duke ofruar një mjet praktik për orientim në proceset gjyqësore.

Fletëpalosje për shërbimet që ofrojnë gjykatat për qytetarët

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat ekzistencën dhe publikimin e fletëpalosjeve informuese (në format elektronik ose PDF) që përshkruajnë shërbimet që ofron gjykata për qytetarët — si dorëzimi i kërkesave, informimi për seancat, ndërmjetësimi, përjashtimi nga tarifat gjyqësore, ndihma ligjore falas, etj.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A ka publikuar gjykata në faqen e saj zyrtare fletëpalosje informuese për shërbimet që u ofrohen qytetarëve?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator ka për qëllim të vlerësojë nivelin e komunikimit proaktiv dhe lehtësinë e aksesit në informacion. Fletëpalosjet përbëjnë një formë të qartë, vizuale dhe të kuptueshme për publikun e gjerë, duke kontribuar në përfshirjen qytetare dhe rritjen e besimit ndaj institucioneve të drejtësisë.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-informues, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe cilësinë e publikimit: • 0 pikë – mungojnë fletëpalosjet për shërbimet e gjykatës • 1 pikë – ekzistojnë fletëpalosje të pjesshme (p.sh. vetëm për disa shërbime ose në format jo të aksesueshëm) • 2 pikë – ekzistojnë fletëpalosje të plota, të qarta dhe të aksesueshme, që mbulojnë të gjitha shërbimet bazë për qytetarët (në format PDF ose web).

Udhëzues për paraqitjen dhe shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e udhëzuesit zyrtar që përshkruan mënyrën e paraqitjes, regjistrimit, shqyrtimit dhe trajtimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, Penale dhe në aktet e brendshme të Gjykatës së Lartë.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë udhëzuesi zyrtar për paraqitjen dhe shqyrtimin e çështjeve?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator synon të vlerësojë transparencën normative dhe qartësinë procedurale në veprimtarinë e Gjykatës së Lartë. Udhëzuesi ndihmon qytetarët, avokatët dhe palët në proces të kuptojnë hapat dhe kriteret për paraqitjen e rekursit, afatet, mënyrën e shqyrtimit dhe strukturën e vendimeve, duke garantuar trajtim të barabartë dhe parashikueshmëri në procedura.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-normativ, i vlerësuar vetëm mbi ekzistencën dhe aksesin publik të dokumentit: • 0 pikë – udhëzuesi mungon në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë • 1 pikë – ekziston referencë e pjesshme (p.sh. citim ose fragment i udhëzuesit, por pa dokument të plotë ose të aksesueshëm) • 2 pikë – udhëzuesi është i publikuar në mënyrë të plotë, të qartë dhe të aksesueshme, në format PDF ose web, në rubrikën përkatëse të faqes së Gjykatës së Lartë.

Indikatori i Vlerësimit: Fletëpalosje për shërbimet që ofrojnë gjykatat për qytetarët

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë	✓			0 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Fletëpalosje për shërbimet që ofrojnë gjykatat për qytetarët

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Fletëpalosjet informuese përbëjnë një nga produktet e parashikuara në Planin e Komunikimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), me qëllim rritjen e transparencës dhe orientimin e qytetarëve mbi shërbimet që ofrojnë gjykatat. Këto materiale synojnë të ofrojnë informacion të përmbledhur dhe të kuptueshëm mbi funksionet institucionale, procedurat gjyqësore dhe kanalet e kontaktit për publikun.

Në faqet zyrtare të gjykatave, Programi i Transparencës përfshin një rubrikë të dedikuar për shërbimet e gjykatës, ku parashikohet publikimi i këtyre fletëpalosjeve, së bashku me materiale vizuale ose video orientuese. Megjithatë, gjatë vëzhgimit rezulton se produktet e këtij lloji mungojnë në pjesën dërrmuese të faqeve gjyqësore, duke përfshirë si fletëpalosjet ashtu edhe videot shoqëruese që janë konceptuar si pjesë e komunikimit publik institucional.

Në disa raste të izoluara, rubrika për shërbimet e gjykatës përmban informacione të përgjithshme mbi shërbimet që ofron institucioni (si ndihma juridike, mënyra e dorëzimit të kërkesave, pagesa e tarifave apo qasja në vendime gjyqësore), por pa formatin standard të fletëpalosjeve të miratuara nga KLGJ. Gjithashtu, mungon edhe përdorimi i materialeve multimediale që lidhen me këtë tematikë, pavarësisht se ato janë parashikuar në dokumentet udhëzuese të komunikimit gjyqësor.

Në tërësi, ky komponent mbetet i paplotësuar në shumicën e faqeve gjyqësore, si në aspektin e përmbajtjes, ashtu edhe në zbatimin e standardeve të komunikimit publik. Mungesa e fletëpalosjeve dhe materialeve vizuale përbën një boshllëk në informimin aktiv të qytetarëve mbi mënyrën e funksionimit të gjykatave dhe shërbimeve që ato ofrojnë.

Fletëpalosje informuese për Gjykatat dhe Zyrat e Shërbimit

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat ekzistencën dhe publikimin e fletëpalosjeve informuese që shpjegojnë në mënyrë të qartë rolin dhe funksionet e gjykatave, si dhe shërbimet që ofrohen nga Zyrat e Shërbimit (p.sh. marrja e informacionit, regjistrimi i kërkesave, orientimi për qytetarët, ndihma ligjore, ndërmjetësimi, etj.).
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A janë publikuar në faqen zyrtare të gjykatës fletëpalosje informuese për funksionet e gjykatës dhe Zyrat e Shërbimit që ndihmojnë qytetarët?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është thelbësor për orientimin e qytetarëve dhe lehtësimin e aksesit në drejtësi. Fletëpalosjet përbëjnë mjetet më të drejtpërdrejta për të komunikuar shërbimet e ofruara, duke ndihmuar qytetarët të kuptojnë ku të drejtohen dhe cilat dokumente u nevojiten. Kjo rrit transparencën, efikasitetin dhe besimin publik te sistemi gjyqësor.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-informues, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe përmbajtjen e materialeve të publikuara: • 0 pikë – mungojnë fletëpalosjet për gjykatat dhe Zyrat e Shërbimit • 1 pikë – ekzistojnë fletëpalosje të pjesshme (p.sh. vetëm për një kategori shërbimesh ose pa informacion të plotë) • 2 pikë – ekzistojnë fletëpalosje të plota, të qarta, të aksesueshme dhe të përditësuara, që mbulojnë shërbimet kryesore të gjykatës dhe Zyrave të Shërbimit (në format PDF ose web).

Udhërrëfyes për Funksionalitetin e Gjykatës së Lartë

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e udhërrëfyesit zyrtar që shpjegon mënyrën e funksionimit të Gjykatës së Lartë, përfshirë strukturën organizative, kompetencat e kolegjeve, mënyrën e ndarjes së çështjeve, përbërjen e trupave gjyqësore dhe funksionet e administratës gjyqësore.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë një udhërrëfyes që shpjegon strukturën, funksionet dhe mënyrën e funksionimit të saj institucional?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për transparencën institucionale dhe edukimin juridik të publikut. Ai i mundëson qytetarëve dhe profesionistëve të ligjit të kuptojnë në mënyrë të qartë rolin e Gjykatës së Lartë, proceset e saj të brendshme dhe mënyrën si trajtohen çështjet, duke rritur besimin publik dhe llogaridhënien institucionale.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-institucional, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe qartësinë e informacionit të publikuar: • 0 pikë – mungon çdo informacion ose dokument për funksionalitetin e Gjykatës së Lartë • 1 pikë – ekziston informacion i pjesshëm ose jo i plotë (p.sh. fragmentar ose pa përshkrim të detajuar të strukturës dhe kompetencave) • 2 pikë – ekziston udhërrëfyes i plotë, i qartë, i aksesueshëm dhe i përditësuar, që shpjegon në mënyrë të detajuar funksionalitetin e Gjykatës së Lartë.

Indikatori i Vlerësimit: Fletëpalosje informuese për Gjykatat dhe Zyrat e Shërbimit

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Fletëpalosje informuese për Gjykatat dhe Zyrat e Shërbimit

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave janë të publikuara fletëpalosjet informuese të përgatitura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) pas zbatimit të hartës së re gjyqësore. Këto materiale kanë për qëllim orientimin e qytetarëve lidhur me organizimin e ri të sistemit gjyqësor dhe ofrimin e shërbimeve në zyrat përkatëse të gjykatave.

Fletëpalosjet përfshijnë disa kategori kryesore, ndër to:

- fletëpalosje për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm,
- fletëpalosje për zyrat e shërbimit pranë ish-gjykatave të apelit,
- fletëpalosje për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm,
- fletëpalosje për zyrat e shërbimit pranë këtyre gjykatave,
- si dhe fletëpalosje për gjykatat administrative të shkallës së parë Tiranë/Lushnjë dhe zyrat e shërbimit pranë ish-gjykatave administrative.

Të gjitha këto materiale janë të publikuara në faqet përkatëse të gjykatave, por informacioni nuk është i përqendruar në një rubrikë të vetme. Fletëpalosjet gjenden të shpërndara në rubrika të ndryshme të faqeve, si “Publikime”, “Njoftime për publikun”, “Njoftime të tjera”, “Pasqyra e shtypit”, apo drejtpërdrejt në faqen hyrëse (homepage). Në disa raste, ato përsëriten në disa seksione të njëjtës faqe, pa ndarje apo kategorizim të qartë sipas llojit të gjykatës apo zyrës së shërbimit.

Përmbajtja e fletëpalosjeve është e njëtrajtshme në të gjitha faqet, duke ndjekur modelet zyrtare të miratuara nga KLGJ. Çdo dokument përmban informacione për juridiksionin territorial të gjykatës, adresën e re, kontaktet për komunikim dhe shërbimet që ofrohen për publikun.

Në tërësi, fletëpalosjet informuese janë të publikuara nga të gjitha gjykatat respektive, por materialet rezultojnë të shpërndara dhe të përsëritura në disa rubrika, çka e bën informacionin të pranishëm, por jo të përqendruar në një vend të vetëm brenda faqeve gjyqësore.

Ndihma juridike falas (kontakt, fletëpalosje, video, etj)

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e informacionit që lidhet me ofrimin e ndihmës juridike falas pranë gjykatës, përfshirë kontaktet e personit përgjegjës, mënyrën e aplikimit, fletëpalosjet informuese ose materialet vizuale që shpjegojnë procedurën e përfitimit.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A ka publikuar gjykata informacion të qartë dhe të aksesueshëm mbi ndihmën juridike falas dhe mënyrën e përfitimit të saj nga qytetarët?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është thelbësor për garantimin e aksesit efektiv në drejtësi, sidomos për qytetarët në kushte të vështira ekonomike. Ai ndihmon në zbatimin praktik të Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, duke promovuar transparencë, informim dhe barazi para ligjit.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-informues, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe përmbajtjen e informacionit të publikuar: • 0 pikë – mungon çdo informacion për ndihmën juridike falas • 1 pikë – ekziston informacion i pjesshëm (p.sh. vetëm kontakt ose përmendje pa fletëpalosje apo materiale shpjeguese) • 2 pikë – ekziston informacion i plotë, i qartë dhe i aksesueshëm, që përfshin kontaktet, mënyrën e aplikimit dhe materiale ndihmëse (fletëpalosje, video, etj.).

Buletini Informativ i Gjykatës së Lartë

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e buletineve periodike që përmbajnë informacion mbi vendimmarrjen, veprimtarinë, nismat institucionale dhe aktivitetet e komunikimit të Gjykatës së Lartë, si pjesë e transparencës së saj publike.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë buletine informuese periodike dhe a përfshijnë ato përditësime për vitet e fundit?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator vlerëson transparencën proaktive dhe komunikimin institucional të Gjykatës së Lartë. Buletinet informuese ndihmojnë në rritjen e aksesit të publikut dhe profesionistëve në informacionin zyrtar, duke shërbyer si mjet llogaridhënieje dhe dokumentimi publik.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik-informues, i vlerësuar mbi vazhdimësinë e publikimeve: • 0 pikë – asnjë buletin nuk është publikuar • 1 pikë – ekziston publikim i pjesshëm ose jo i përditësuar (p.sh. për një vit të vetëm) • 2 pikë – buletinet publikohen rregullisht dhe në mënyrë të plotë, përfshirë vitin më të fundit.

Indikatori i Ndihma juridike falas (kontakt, fletëpalosje, video, etj)

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Ndihma juridike falas (kontakt, fletëpalosje, video, etj)

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Ndihma juridike falas është një element i parashikuar si pjesë e mekanizmave që sigurojnë aksesin e barabartë në drejtësi për qytetarët. Ky komponent synon jo vetëm të informojë publikun për ekzistencën e shërbimit, por edhe të orientojë qytetarët mbi mënyrat e aplikimit, kategoritë përfituese dhe kontaktet përkatëse.

Në praktikë, informacioni mbi ndihmën juridike falas është i pranishëm në të gjitha faqet gjyqësore, por në forma dhe nivele të ndryshme paraqitjeje. Disa gjykata kanë publikuar fletëpalosje informuese, të hartuara sipas modeleve standarde të Ministrisë së Drejtësisë, të tjera kanë përfshirë video udhëzuese apo lidhje direkte drejt portalit zyrtar të Ndihmës Juridike, ndërsa një pjesë tjetër ofrojnë numra telefoni, adresa elektronike ose kontakte të drejtpërdrejta për qytetarët që kërkojnë këtë shërbim.

Megjithatë, informacioni është shpesh i shpërndarë në rubrika të ndryshme të faqes - si "Programi i Transparencës", "Njoftime", "Publikime", dhe në disa raste ndodhet edhe në faqen hyrëse (homepage). Kjo shpërndarje e fragmentuar bën që informacioni të mos jetë i lehtë për t'u gjetur nga përdoruesit dhe të mungojë një seksion i dedikuar posaçërisht për këtë kategori shërbimi. Edhe pse përmbajtja përmban elementët kryesorë informues (adresat, numrat e kontaktit, formularët apo lidhjet për aplikim), mungesa e unifikimit në formën e paraqitjes dhe dallimet vizuale ndërmjet faqeve ndikojnë në uljen e qartësisë dhe efikasitetit të komunikimit me publikun.

Në disa raste pozitive, gjykatat kanë kombinuar format e komunikimit duke përfshirë fletëpalosje të shkarkueshme dhe linke drejt portaleve të specializuara, duke rritur ndërveprimin dhe orientimin e qytetarëve drejt burimeve të sakta të informacionit. Këto praktika përbëjnë shembuj të mirë që mund të shërbejnë si model për standardizimin e këtij komponenti në të gjithë sistemin gjyqësor.

Në përfundim, ndonëse prania e informacionit mbi ndihmën juridike falas është universale në faqet gjyqësore, mungesa e një strukture të dedikuar dhe prezantimi i fragmentuar e kufizojnë ndikimin e tij praktik. Standardizimi i formës së publikimit dhe krijimi i një rubrike të qartë dhe unike për këtë shërbim do të përmirësonte ndjeshëm aksesin e qytetarëve në drejtësi dhe transparencën institucionale të gjykatave.

Tarifat e Shërbimeve Gjyqësore

Përshkrim i indikatorit	Tarifat e gjykatës përfshijnë pagesat që qytetarët duhet të bëjnë për shërbime të caktuara procedurale ose administrative. Publikimi i tyre i qartë ndihmon qytetarët të kuptojnë detyrimet financiare dhe të shmangin paqartësitë apo abuzimet.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A janë publikuar tarifat e gjykatës në faqen zyrtare dhe a janë ato të azhornuara sipas legjislacionit në fuqi?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i tarifave siguron transparencë mbi kostot e shërbimeve gjyqësore dhe rrit besimin e publikut tek barazia e aksesit në drejtësi. Ai është gjithashtu një mekanizëm për të shmangur arbitraritetin apo praktikat joformale.
Matja e indikatorit	Vlerësimi bëhet mbi bazën e ekzistencës dhe azhornimit: • 0 pikë – tarifat mungojnë • 1 pikë – tarifat ekzistojnë, por janë të vjetëruara ose të pjesshme • 2 pikë – tarifat ekzistojnë, janë të qarta, të aksesueshme dhe të azhornuara sipas ligjit.

Indikatori i Vlerësimit: Tarifat e Shërbimeve Gjyqësore

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Tarifat e Shërbimeve Gjyqësore

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave është i pranishëm informacioni mbi tarifat e shërbimeve gjyqësore, i cili përbën një element të rëndësishëm të transparencës institucionale dhe i mundëson publikut të njihet me kostot e shërbimeve që ofrohen nga gjykatat. Kjo listë tarifash është parashikuar edhe si komponent i detyrueshëm në Programin e Transparencës, ndaj gjendet e publikuar në pjesën më të madhe të gjykatave në këtë rubrikë.

Përveç publikimit në "Programin e Transparencës", informacioni mbi tarifat gjendet edhe në rubrika të tjera të faqeve zyrtare, si "Njoftime të tjera", "Publikime" ose "Informacione për qytetarët". Kjo shpërndarje tregon se gjykatat kanë zgjedhur forma të ndryshme për ta bërë informacionin më të aksesueshëm, edhe pse jo gjithmonë në një seksion të unifikuar.

Një element i veçantë pozitiv është fakti që për këtë komponent janë përgatitur materiale shtesë informuese, përfshirë video udhëzuese dhe fletëpalosje që sqarojnë si tarifat gjyqësore ashtu edhe rastet e përjashtimit nga tarifat gjyqësore. Këto materiale janë të publikuara nga shumë gjykata dhe ndihmojnë qytetarët të kuptojnë më mirë procedurat përkatëse, duke rritur nivelin e transparencës praktike dhe ndërveprimit publik.

Formular Elektronik Aplikimi (FEA)

Përshkrim i indikatorit	Formulari Elektronik i Aplikimit (FEA) është mjeti online që i mundëson qytetarëve të paraqesin kërkesa, ankesa ose aplikime në mënyrë elektronike. Ai shërben si instrument për lehtësimin e aksesit në drejtësi dhe modernizimin e shërbimeve gjyqësore.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është i publikuar dhe funksional Formulari Elektronik i Aplikimit në faqen zyrtare të gjykatës?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i FEA-së rrit transparencën, përmirëson shërbimin ndaj qytetarëve dhe ndihmon në dixhitalizimin e procedurave gjyqësore. Ky instrument siguron që qytetarët të kenë një rrugë të drejtpërdrejtë dhe të aksesueshme për komunikim me gjykatën.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator binar-statiko dhe vlerësohet mbi bazën e ekzistencës dhe funksionalitetit: • 0 pikë – FEA mungon • 1 pikë – FEA ekziston, por është i pjesshëm, jo i azhornuar ose jo funksional • 2 pikë – FEA ekziston, është i qartë, plotësisht funksional dhe i aksesueshëm për qytetarët.

Indikatori i Vlerësimit: Formular Elektronik Aplikimi (FEA)

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Formular Elektronik Aplikimi (FEA)

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave është e pranishme një rubrikë e dedikuar për formularin elektronik të aplikimeve, e cila gjendet në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha faqet gjyqësore. Rubrika mban zakonisht titullin "Formular aplikimi" dhe përbën një seksion të veçantë, të ndarë nga rubrikat e tjera të informacionit publik.

Formulari është i ndërtuar në format elektronik dhe lejon plotësimin e drejtpërdrejtë nga përdoruesi. Ai përfshin të dhëna identifikuese të kërkuesit, si emri, mbiemri, numri personal i identifikimit, numri i telefonit dhe adresa e e-mailit, si dhe hapësira për përshkrimin e kërkesës dhe ngarkimin e dokumenteve shoqëruese. Pas plotësimit, formulari dërgohet automatikisht përmes sistemit elektronik të faqes zyrtare të gjykatës.

Kjo rubrikë është funksionale dhe e disponueshme në të gjitha faqet e gjykatave, pa dallime të dukshme në strukturë apo format. Përmbajtja dhe mënyra e funksionimit të formularit janë të unifikuara dhe ndjekin të njëjtin model në nivel sistemi.

Në disa raste të kufizuara, përveç formularit, është publikuar edhe një video udhëzuese që shpjegon mënyrën e përdorimit dhe plotësimit të formularit online. Këto raste janë të rralla dhe gjenden vetëm në disa faqe gjykatash, si pjesë e planit të komunikimit institucional.

Në tërësi, formulari elektronik i aplikimeve është i aksesueshëm, funksional dhe i publikuar në një rubrikë të vetme për çdo gjykatë, duke ofruar një mënyrë standarde për paraqitjen e kërkesave dhe komunikimin elektronik me institucionet gjyqësore.

Formulari i Ankesës për nënpunësin civil gjyqësor

Përshkrim i indikatorit	Formulari i ankesës për nënpunësin civil gjyqësor është një dokument standard i cili u mundëson qytetarëve të parashtrojnë ankesë ndaj stafit administrativ të gjykatës, në rast shkeljesh apo sjelljeje të papërshtatshme gjatë kryerjes së detyrave.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar online formulari i ankesës për nënpunësin civil gjyqësor dhe a është ai i aksesueshëm për qytetarët?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky formular është një instrument i rëndësishëm për garantimin e llogaridhënies së administratës gjyqësore dhe për rritjen e besimit të publikut tek shërbimi civil gjyqësor. Ai siguron një rrugë të qartë për qytetarët për të ushtruar të drejtën e tyre të ankesës.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-binar, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe përditësimin: • 0 pikë – formulari mungon • 1 pikë – formulari ekziston, por është i pjesshëm, jo i qartë ose i vjetëruar • 2 pikë – formulari ekziston, është i plotë, i qartë, i aksesueshëm dhe i azhornuar.

Indikatori i Vlerësimit: Formulari i Ankesës për Nënpunësin Civil Gjyqësor

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Formulari i Ankesës për nënpunësin civil gjyqësor

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave është i publikuar formulari për paraqitjen e ankesave ndaj nënpunësve civilë gjyqësorë, i cili shërben për të mundësuar që qytetarët, palët ose personat e interesuar të raportojnë sjellje apo veprime që lidhen me shërbimin civil gjyqësor. Dokumenti përmban të dhëna për identifikimin e ankuesit, përshkrimin e shkurtër të rastit dhe informacion mbi nënpunësin për të cilin bëhet ankesa.

Ky formular është i pranishëm në pjesën më të madhe të faqeve zyrtare të gjykatave, por nuk gjendet në një rubrikë të unifikuar. Në disa raste, ai është përfshirë në programin e transparencës, në seksionin që lidhet me kërkesat dhe ankesat e publikut, ndërsa në të tjera ndodhet në rubrika të ndryshme të faqes, si "Publikime", "Pasqyra e shtypit", "Njoftime për publikun", ose "Njoftime të tjera".

Në disa faqe, formulari është i vendosur edhe në faqen hyrëse (homepage), si dokument i aksesueshëm drejtpërdrejt, duke e bërë të lehtë gjetjen dhe shkarkimin e tij. Kjo mënyrë e publikimit bën që informacioni të jetë i shpërndarë në disa seksione të faqes, pa një vend të përqendruar për këtë kategori dokumentesh.

Në përmbajtje, formulari është i unifikuar për të gjitha gjykatat, duke ndjekur të njëjtin model dhe format standard të miratuar për institucionet e sistemit gjyqësor. Ai përmban udhëzime të qarta për mënyrën e plotësimit dhe adresat për dorëzimin e ankesës.

Në tërësi, formulari i ankesës për nënpunësin civil gjyqësor është i publikuar në mënyrë të qëndrueshme në faqet e gjykatave, por paraçitet në rubrika të ndryshme, gjë që e bën dokumentin të aksesueshëm, por jo të përqendruar në një vend unik brenda strukturës së faqes.

Video për përdorimin e InfoPoint në Gjykatë

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat ekzistencën e një videoje informuese që shpjegon mënyrën e përdorimit të InfoPoint-it të gjykatës — pajisjes elektronike ose pikës së informacionit ku qytetarët mund të konsultojnë oraret e seancave, listat e çështjeve, udhëzimet për shërbime dhe informacionet institucionale.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A ka publikuar gjykata një video që shpjegon përdorimin e InfoPoint-it dhe a është ajo e aksesueshme për publikun (në faqen zyrtare ose rrjetet sociale)?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të lehtësuar orientimin e qytetarëve në ambientet e gjykatës dhe për të promovuar përdorimin e mjeteve digjitale të informimit. Ai ndihmon në rritjen e transparencës, përmirëson përvojën e përdoruesit dhe zvogëlon varësinë nga ndërhyrjet e stafit administrativ.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-sensibilizues, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe cilësinë e përmbajtjes: • 0 pikë – mungon videoja për përdorimin e InfoPoint-it • 1 pikë – ekziston video, por është e pjesshme, e vjetëruar ose e vështirë për t'u gjetur • 2 pikë – ekziston video e qartë, praktike dhe e azhurnuar që shpjegon hap pas hapi përdorimin e InfoPoint-it dhe është lehtësisht e aksesueshme online.

Indikatori i Vlerësimit:

Video për përdorimin e InfoPoint në Gjykatë

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Video për përdorimin e InfoPoint në Gjykatë

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Ky indikator është i parashikuar në Planin e Komunikimit për Gjykatat 2022-2024, me qëllim që gjykatat të ofrojnë mjete të qarta vizuale për orientimin e qytetarëve në ambientet e tyre, në veçanti përmes infopoint-it - pikës së informacionit që ndihmon publikun të marrë të dhëna mbi çështjet, oraret e seancave, tarifat apo shërbimet gjyqësore.

Megjithëse infopoint-et funksionojnë tashmë në të gjitha gjykatat e sistemit, shumica e gjykatave nuk kanë publikuar ende një video udhëzuese që t'u shpjegojë qytetarëve mënyrën e përdorimit të tyre. Vetëm një numër shumë i kufizuar faqesh zyrtare paraqesin materiale të tilla, zakonisht të vendosura në faqen hyrëse (homepage) ose në rubrikën "Multimedia", me karakter demonstrues mbi funksionin e infopoint-it dhe shërbimet që ofron.

Në pjesën më të madhe të rasteve, informacioni ekziston vetëm në formë tekstuale, përmes njoftimeve apo përshkrimeve të përgjithshme mbi rolin e infopoint-it, pa elemente vizuale shpjeguese. Mungesa e materialeve të tilla kufizon kuptueshmërinë dhe ndërveprimin e qytetarëve me gjykatën, sidomos për ata që kanë vështirësi në navigimin e faqeve ose në njohjen e strukturës së administratës gjyqësore.

Një video e dedikuar për përdorimin e infopoint-it do të kishte funksion orientues dhe edukues, duke treguar në mënyrë të thjeshtë se si qytetarët mund të kërkojnë informacion mbi çështjet, të paraqiten për kërkesa apo të marrin dokumente, si dhe cilat janë pikat e kontaktit për ndihmë. Ky lloj komunikimi vizual përbën një mjet efektiv për rritjen e transparencës dhe qasjes publike në drejtësi.

Në përfundim, përfshirja shumë e kufizuar e videove informuese mbi infopoint-et tregon se ky standard i komunikimit gjyqësor mbetet ende i pazbatuar në praktikë. Zbatimi i tij do të përforconte transparencën institucionale dhe do të ndihmonte qytetarët të ndërveprojnë më lehtë me gjykatat, duke e bërë procesin e informimit më të shpejtë, të kuptueshëm dhe miqësor për publikun.

D

Informimi dhe komunikimi me publikun

Njoftimet me Shpallje Publike

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator i referohet publikimit online të shpalljeve publike që lidhen me veprimtarinë gjyqësore dhe administrative të gjykatës. Ai përfshin njoftimet që gjykata është e detyruar t'i bëjë publike, duke garantuar transparencën dhe informimin e palëve.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A publikohen rregullisht shpalljet publike në faqen zyrtare të gjykatës dhe a përfshijnë ato vitin më të fundit?
Qëllimi dhe rëndësia	Shpalljet publike janë instrument i domosdoshëm për transparencën dhe aksesin në drejtësi, pasi sigurojnë që palët dhe publiku të informohen në kohë për procedura, afate dhe vendime që i përkasin. Ato kontribuojnë në barazinë e palëve dhe në parimin e publicitetit të procesit gjyqësor.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, i vlerësuar mbi bazën e vazhdimësisë: • 0 pikë – asnjë shpallje publike nuk është publikuar • 1 pikë – Ka shpallje publike, por me intervale të gjata, pa përditësim të rregullt, ose vetëm disa njoftime të rastësishme • 2 pikë – Shpalljet publike përditësohen rregullisht gjatë vitit të fundit (p.sh. muaj pas muaji ose në mënyrë të vazhdueshme)

Indikatori i Vlerësimit: Njoftimet me Shpallje Publike

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit: Njoftimet me Shpallje Publike

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Rubrika e shpalljeve publike përbën një nga komponentët më të konsoliduar të transparencës gjyqësore, duke siguruar akses të drejtpërdrejtë në njoftime që lidhen me çështje gjyqësore, vendime apo publikime me interes të përgjithshëm. Publikimet janë të pranishme në mënyrë të qëndrueshme për periudhën 2017-2025, me një intensitet të lartë gjatë viteve të fundit, veçanërisht për periudhën 2023-2025. Në disa raste, faqet përmbajnë edhe arkiva të zgjeruara që ruajnë shpalljet e hershme të viteve 2018-2020, duke ofruar një panoramë të plotë të historikut të njoftimeve publike.

Në aspektin strukturor, shpalljet janë të publikuara në rubrika të ndryshme të faqeve zyrtare, si "Publikime", "Njoftime për median", "Pasqyra e shtypit", "Njoftime të tjera" apo në seksione të posaçme të quajtura "Shpallje publike". Në disa raste, i njëjti informacion është i shpërndarë në më shumë se një rubrikë, gjë që, ndonëse rrit dukshmërinë, e bën më të vështirë identifikimin e një vendndodhjeje unike të njoftimeve.

Përmbajtja e shpalljeve publike është e larmishme dhe përfshin njoftime për palët në proces, vendime me interes publik, shpallje të vendimeve penale apo administrative, si dhe njoftime procedurale të natyrave të ndryshme. Në disa raste, janë përfshirë edhe publikime që lidhen me çështje me ndjeshmëri mediatike ose me procese penale të profilit të lartë. Zakonisht, dokumentet përmbajnë të dhëna standarde si emrin e palëve, numrin dhe datën e vendimit, objektin e çështjes dhe referencën përkatëse, duke garantuar një nivel bazë informimi për publikun. Në lidhje me ritmin e përditësimit, shumica e gjykatave ruajnë një vazhdimësi mujore të publikimeve, me përditësime të rregullta deri në tetor 2025. Gjykatat me ngarkesë më të lartë pune kanë një ritëm më të qëndrueshëm publikimi, ndërsa në disa raste vërehen periudha më të gjata midis përditësimeve, veçanërisht në gjykatat me volum më të ulët çështjesh.

Nga ana teknike, aksesueshmëria e të dhënave është e mirë. Njoftimet janë të disponueshme në format elektronik, të renditura në listë kronologjike sipas datës së publikimit. Disa faqe paraqesin njoftime të veçuara për çdo rast individual, ndërsa të tjera i grupojnë sipas muajit apo llojit të çështjes, duke ofruar mundësi kërkimi të lehtë. Në aspektin përmbajtësor, diversiteti i informacionit të publikuar mbetet i dukshëm. Disa institucione kufizohen në publikimin e njoftimeve standarde për palët në proces, ndërsa të tjera përfshijnë edhe komunikime informuese për publikun mbi çështje apo vendime me rëndësi më të gjerë. Kjo tregon niveli të ndryshëm të angazhimit dhe të hapjes institucionale, duke reflektuar qasje të ndryshme në zbatimin e detyrimeve për transparencë.

Raportet Vjetore të Gjykatës

Përshkrim i indikatorit	Raportet vjetore të gjykatës përmbledhin aktivitetin administrativ dhe gjyqësor të institucionit, duke ofruar një panoramë të përgjithshme për performancën dhe transparencën e tij.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A janë publikuar raportet vjetore të gjykatës në faqen zyrtare dhe a janë ato të azhornuara për vitet e fundit?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i raporteve vjetore është një detyrim ligjor dhe një mekanizëm kyç transparence. Ai rrit llogaridhënien ndaj publikut dhe u mundëson palëve të interesuara të informohen mbi aktivitetin dhe rezultatet e gjykatës.
Matja e indikatorit	Vlerësimi bëhet mbi bazën e ekzistencës dhe shpeshtësisë së publikimit: • 0 pikë – nuk ka raporte • 1 pikë – raporte të pjesshme (vetëm 1–2 vite ose mungon viti i fundit) • 2 pikë – raporte të plota, të publikuara për ≥3 vite radhazi dhe duke përfshirë vitin e fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Raportet Vjetore

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit: Raportet Vjetore

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Raportet dhe analizat vjetore përbëjnë një nga mjetet kryesore të transparencës dhe vetëvlerësimit institucional të gjykatave. Dokumentet e këtij lloji janë të pranishme në pjesën më të madhe të faqeve zyrtare për periudhën 2021-2024, ndërsa disa institucione ruajnë edhe arkiva më të zgjeruara që përfshijnë publikime të viteve të mëhershme. Në mënyrë të përgjithshme, publikimi i këtyre materialeve kryhet gjatë tremujorit të parë të vitit pasardhës, duke ruajtur një vazhdimësi të qëndrueshme në raportim dhe në dokumentimin e aktivitetit gjyqësor.

Në aspektin e strukturës së faqeve, raportet vjetore janë të publikuara në rubrika të ndryshme, si "Publikime", "Njoftime për median", "Pasqyra e shtypit", "Njoftime të tjera", apo në disa raste edhe në seksionin "Rregullore të gjykatës". Nuk ekziston një model unik për vendosjen e dokumenteve, dhe në disa raste raporti gjendet i shpërndarë në më shumë se një rubrikë, gjë që ndikon në lehtësinë e gjetjes dhe identifikimit të tij nga publiku.

Formati dhe përmbajtja e raportimeve ndryshojnë dukshëm ndërmjet institucioneve. Disa gjykata publikojnë raporte të plota që përfshijnë analiza statistikore, tregues të performancës dhe vlerësime të detajuara të punës, ndërsa të tjera kufizohen në përmbledhje të shkurtuara ose njoftime të përgjithshme mbi zhvillimin e analizës vjetore. Këto mospërputhje tregojnë mungesën e një formati të standardizuar institucional, që do të mundësonte krahasim dhe uniformitet më të madh ndërmjet gjykatave.

Në lidhje me aksesueshmërinë, shumica e dokumenteve janë të disponueshme në format elektronik (PDF ose si lidhje direkte në faqe), duke mundësuar lexim dhe shkarkim të menjëhershëm. Megjithatë, hasen edhe raste me lidhje joaktive ose me materiale që nuk mund të shkarkohen, gjë që krijon dallime në nivelin e aksesit publik ndaj informacionit.

Nga ana terminologjike, nuk ekziston një emërtim i unifikuar për këto dokumente: disa institucione përdorin titullin "Raport Vjetor", të tjera "Analizë Vjetore" apo "Analizë e Punës". Kjo mungesë standardizimi terminologjik ndikon në identifikimin e qartë të dokumenteve dhe kufizon krahasueshmërinë ndërmjet institucioneve të ndryshme.

Në aspektin kohor, pothuajse të gjitha gjykatat kanë të publikuara raportet ose analizat për vitin e fundit të vlerësuar (2024), duke treguar një përditësim të afërt dhe vijueshmëri në raportim. Në disa raste, dokumentet janë të ruajtura në mënyrë arkivore, duke ofruar një panoramë shumëvjeçare të aktivitetit dhe performancës institucionale, që përbën një praktikë të mirë për ndjekjen e ecurisë së punës në kohë.

Plani Strategjik i Komunikimit për Sistemin Gjyqësor

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor në faqen e gjykatës ose referencën ndaj tij (p.sh. përmes dokumenteve, njoftimeve apo aktiviteteve që tregojnë zbatim të drejtpërdrejtë). Ai evidenton nëse gjykata ndjek politikat kombëtare të transparencës dhe komunikimit të përcaktuara nga KLGJ.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar ose referuar në faqen zyrtare të gjykatës Plani Strategjik i Komunikimit për Sistemin Gjyqësor dhe a ka prova për zbatimin e tij në nivel institucional?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të vlerësuar përputhjen e gjykatës me strategjinë kombëtare të komunikimit, që synon të rrisë transparencën, koherencën dhe besimin publik në sistemin gjyqësor. Ai tregon nëse gjykata është pjesë aktive e reformës institucionale në komunikim publik dhe media.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator institucional-strategjik, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe nivelin e zbatimit: • 0 pikë – plani nuk është publikuar • 1 pikë – ekziston referencë e pjesshme ose dokumenti nuk është i aksesueshëm plotësisht • 2 pikë – plani është i publikuar plotësisht, i qartë dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare të gjykatës.

Indikatori i Vlerësimit: Plani Strategjik i Komunikimit për Sistemin Gjyqësor

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar		✓		1 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Plani Strategjik i Komunikimit për Sistemin Gjyqësor

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Plani Strategjik i Komunikimit për Sistemin Gjyqësor është një dokument orientues që synon të unifikojë standardet e komunikimit publik, transparencës dhe marrëdhënieve me median për të gjitha gjykatat e vendit. Dokumenti është i pranishëm në një numër të konsiderueshëm faqesh gjyqësore, veçanërisht në ato që i përkasin kategorive të larta dhe të mesme, ndërsa në gjykatat e tjera publikimi është më i pjesshëm.

Në aspektin e organizimit në faqe, dokumenti nuk është vendosur në një rubrikë të dedikuar posaçërisht për komunikimin institucional, por është i shpërndarë në disa rubrika të ndryshme, përfshirë "Publikime", "Programi i transparencës", "Rregullore të gjykatës" dhe "Rreth gjykatës". Në disa raste, ai është i aksesueshëm përmes lidhjeve të brendshme në faqe, ndërsa në raste të tjera vetëm i përmendur në tekstin shpjegues, pa u shoqëruar me dokumentin e plotë.

Gjykatat e kategorisë së parë janë më aktive në publikimin e këtij dokumenti, ndërsa gjykatat e kategorive të mesme dhe të ulëta tregojnë një prani më të fragmentuar. Disa institucione e kanë përfshirë planin në nenrubrikën "Njoftime të tjera" brenda programit të transparencës, ndërsa të tjera e kanë publikuar si pjesë të materialeve udhëzuese të komunikimit publik.

Në faqet ku dokumenti është i pranishëm, ai paraqitet zakonisht në versionin e miratuar për të gjithë sistemin gjyqësor, me përmbajtje të unifikuar që mbulon fushat kryesore të transparencës, komunikimit institucional, marrëdhënieve me median dhe ndërtimit të besimit publik. Përjashtimisht, disa gjykata kanë strategji komunikimi të veçantë të vetën, të ndarë nga plani i përgjithshëm, çka tregon një nivel më të lartë të personalizimit institucional në këtë fushë.

Në përgjithësi, prania e Planit Strategjik të Komunikimit në faqet e gjykatave përbën një praktikë pozitive për standardizimin e komunikimit publik dhe transparencës, megjithatë mungesa e një rubrike të dedikuar dhe shpërndarja e informacionit në disa seksione e kufizon qartësinë dhe lehtësinë e aksesit për publikun.

Plani i Komunikimit për Gjykatat 2022-2024

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator i referohet ekzistencës së informacionit publik në faqen zyrtare të gjykatës që tregon se institucioni ndjek dhe zbaton Planin e Komunikimit 2022–2024, të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Ai mund të përfshijë publikimin e vetë dokumentit, raporte zbatimi, aktivitete sensibilizuese apo elementë të komunikimit proaktiv.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A pasqyron gjykata në faqen e saj zyrtare zbatimin e Planit të Komunikimit 2022–2024 dhe a ka prova konkrete për zbatimin e tij (dokumente, njoftime, aktivitete, materiale informuese)?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm sepse vlerëson përputhjen e praktikave të gjykatave me standardet kombëtare të komunikimit dhe transparencës të përcaktuara nga KLGJ. Ai tregon nëse gjykata vepron në mënyrë strategjike dhe të koordinuar në komunikimin me publikun dhe median.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator institucional-strategjik, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe zbatimin konkret: • 0 pikë – nuk ka asnjë referencë për Planin e Komunikimit 2022–2024 • 1 pikë – gjykata ka bërë referenca të pjesshme (p.sh. përmend planin, por pa aktivitete apo publikime konkrete) • • 2 pikë – gjykata pasqyron zbatim aktiv të planit, me publikime, materiale, aktivitete ose nisma konkrete në përputhje me objektivat e Planit të Komunikimit 2022–2024.

Indikatori i Vlerësimit: Plani i Komunikimit për Gjykatat 2022-2024

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë		✓		1 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë		✓		1 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Plani i Komunikimit për Gjykatat 2022-2024

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Plani i Komunikimit për Gjykatat 2022-2024 është dokumenti bazë që udhëzon gjykatat në ndërtimin e një komunikimi të hapur dhe efektiv me publikun dhe median, si pjesë e politikës së përgjithshme të transparencës në sistemin gjyqësor. Dokumenti është i publikuar nga pjesa më e madhe e gjykatave, duke dëshmuar përfshirjen e tij të gjerë në mjetet e informimit institucional.

Megjithatë, publikimi i planit nuk është i përqendruar në një rubrikë unike. Ai gjendet shpesh i shpërndarë në disa seksione të faqeve zyrtare, si "Publikime", "Njoftime", "Të dhënat e hapura" ose "Rregullore të gjykatës". Kjo mënyrë paraqitjeje siguron që dokumenti të jetë i aksesueshëm për publikun, por tregon gjithashtu mungesë uniformiteti ndërmjet faqeve të gjykatave në mënyrën e publikimit.

Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve

Përshkrim i indikatorit	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është dokumenti ku regjistrohen të gjitha kërkesat për informacion të paraqitura pranë gjykatës dhe përgjigjet e dhëna. Ky regjistër është një mjet i detyrueshëm për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe një element kyç i transparencës proaktive.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar online regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve të gjykatës dhe a përditësohet ai rregullisht?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i regjistrit siguron llogaridhënie mbi mënyrën se si gjykatat u përgjigjen qytetarëve dhe shërben si instrument parandalues kundër vonesave ose refuzimeve të pajustifikuara. Ai ndihmon gjithashtu në rritjen e besimit publik dhe në forcimin e transparencës institucionale.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, pasi regjistri duhet të azhurnohet vazhdimisht: • 0 pikë – Regjistri mungon krejtësisht. • 1 pikë – Ekziston, por i publikuar vetëm për 1–2 vite ose nuk përfshin vitin e fundit. • 2 pikë – Ekziston dhe është i publikuar rregullisht për të paktën 3 vite radhazi, duke përfshirë vitin e fundit të azhurnuar.

Indikatori i Vlerësimit: Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve përbëjnë një nga instrumentet më të rëndësishëm të transparencës aktive të gjykatave, pasi dokumentojnë në mënyrë periodike mënyrën se si trajtohen kërkesat për informacion nga publiku. Këto regjistra janë të publikuar në mënyrë të vazhdueshme për periudhën 2015-2025, me intervale kohore që variojnë nga mujore e tremujore, deri te përmbledhjet vjetore. Për vitin 2025, pjesa më e madhe e gjykatave ka publikuar të paktën regjistrat e gjashtëmujorit të parë (janar-qershor), duke ruajtur një vijimësi të qartë në publikim.

Në aspektin e strukturës së faqeve, informacioni vendoset kryesisht në nenrubrikën "Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve" brenda seksionit "Programi i transparencës". Në disa raste, dokumentet gjenden edhe në rubrika si "Njoftime", "Publikime" apo "Njoftime të tjera". Edhe pse struktura e faqeve nuk është plotësisht uniforme, të gjitha publikimet përmbajnë titullin e dokumentit dhe periudhën që mbulon, çka garanton identifikim të qartë për përdoruesin.

Ritmi i përditësimit ndryshon ndërmjet gjykatave: disa institucione e publikojnë regjistrin çdo tre muaj, ndërsa të tjera në fund të çdo gjashtëmujori ose në fund të vitit kalendarik. Publikimet më të fundit datojnë nga korriku 2025, duke mbuluar periudhën janar-qershor të vitit aktual, çka tregon një nivel të qëndrueshëm të përditësimit në përputhje me detyrimet ligjore për transparencë.

Sa i përket formatit dhe përmbajtjes, regjistrat pasqyrojnë rubrika standarde që përfshijnë: numrin rendor të kërkesës, datën e paraqitjes, objektin e kërkesës, datën dhe mënyrën e dhënies së përgjigjes, si dhe shënime për respektimin e afateve ligjore. Në disa raste përfshihet edhe ndarja sipas kategorive të kërkesave (të miratuara, të refuzuara apo të deleguara), çka e bën dokumentin më analitik dhe më të dobishëm për monitorim institucional.

Nga pikëpamja teknike, regjistrat janë të aksesueshëm në format elektronik, zakonisht në PDF, dhe mund të shkarkohen drejtpërdrejt nga faqja përkatëse. Në disa gjykata dokumentet janë të publikuara si skedarë individualë për çdo periudhë, ndërsa në të tjera si raporte përmbledhëse vjetore, që përfshijnë të gjitha periudhat raportuese të vitit.

Në aspektin institucional, gjykatat e kategorisë së parë dhe të dytë kanë një mbulim të plotë për periudhën 2020-2025, ndërsa gjykatat e kategorisë së tretë kanë një përfshirje të rregullt për vitet 2023-2025, duke reflektuar vazhdimësi dhe funksionalitet të rubrikës në pothuajse të gjithë sistemin gjyqësor.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit

Përshkrim i indikatorit	Koordinatori për të Drejtën e Informimit është personi përgjegjës në gjykatë për pranimin, regjistrimin dhe ndjekjen e kërkesave për informacion nga publiku. Publikimi i të dhënave të tij (emër, kontakt, email, numër telefoni) është një kërkesë ligjore dhe një element bazë i transparencës.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar në faqen zyrtare të gjykatës emri dhe kontaktet e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe a janë ato të azhurnuara?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është thelbësor për garantimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit dhe për lehtësimin e qasjes së qytetarëve në informacion publik. Ai siguron një pikë të qartë kontakti për publikun dhe rrit përgjegjshmërinë institucionale.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik dhe vlerësohet mbi bazën e ekzistencës dhe azhornimit: • 0 pikë – mungojnë të dhënat e koordinatorit • 1 pikë – të dhënat ekzistojnë, por janë të pjesshme ose të vjetëruara • 2 pikë – të dhënat ekzistojnë, janë të plota (emër + kontakt) dhe të azhurnuara.

Indikatori i Vlerësimit: Koordinatori për të drejtën e informimit

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Koordinatori për të drejtën e informimit

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Të gjitha gjykatat e analizuara, nga Gjykata e Lartë deri te gjykatat e shkallës së parë në rrethe, kanë të publikuar emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit, duke reflektuar përfshirje universale të këtij elementi në faqet zyrtare. Kjo përbën një tregues pozitiv për respektimin formal të detyrimit ligjor për emërimin dhe publikimin e kontaktit të funksionit përgjegjës për zbatimin e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Në aspektin e strukturës së faqeve, informacioni vendoset në mënyrë të qëndrueshme në nenrubrikën "Koordinatori për të Drejtën e Informimit" brenda seksionit "Programi i transparencës". Ky pozicionim i unifikuar ndihmon përdoruesin të gjejë me lehtësi të dhënat përkatëse dhe përbën një praktikë të konsoliduar në nivel institucional. Në disa faqe, lidhja me këtë nenrubrikë është e drejtpërdrejtë nga menuja kryesore, duke e bërë informacionin edhe më të aksesueshëm.

Në lidhje me cilësinë dhe qartësinë e publikimeve, dallohen qartësisht nivele të ndryshme të përmbushjes. Gjykatat e kategorisë së parë – përfshirë ato të nivelit të lartë dhe të posaçme – publikojnë të dhëna të plota që përfshijnë: emrin dhe mbiemrin e koordinatorit, adresën elektronike, numrin e kontaktit, orarin e pritjes dhe adresën zyrtare të institucionit. Në disa raste shtohen edhe të dhëna ndihmëse si përshkrimi i rolit apo kanalet alternative të komunikimit. Ndërkohë, në gjykatat e kategorive të mesme dhe të ulëta, megjithëse koordinatori është i emëruar dhe i publikuar, shpesh mungojnë elementë plotësues, si orari i punës, funksioni zyrtar apo informacioni mbi mënyrën e paraqitjes së kërkesave, duke reduktuar transparencën funksionale.

Praktika të mira vërehen në disa institucione kryesore, të cilat ofrojnë publikim të detajuar dhe të përditësuar të informacionit. Disa gjykata të mëdha dhe të posaçme kanë publikuar jo vetëm kontaktet e koordinatorit, por edhe adresa shtesë për njoftime publike apo komunikim elektronik, duke e bërë këtë rubrikë më gjithëpërfshirëse dhe praktike për qytetarët. Megjithatë, mungesa e uniformitetit në mënyrën e paraqitjes së të dhënave mbetet një problem i përsëritur. Disa faqe përdorin formate tabelare, me ndarje të qartë të elementeve si emri, emaili, orari dhe adresa, ndërsa të tjera ofrojnë informacion në formë teksti të lirë, pa strukturë vizuale të standardizuar. Kjo e vështirëson orientimin e përdoruesve dhe pengon krahasueshmërinë ndërmjet institucioneve.

Në tërësi, rubrika "Koordinatori për të Drejtën e Informimit" paraqitet si një ndër seksionet më funksionale dhe më të konsoliduara në faqet gjyqësore, megjithatë kërkon përmirësim në aspektin e harmonizimit të formatit, përditësimit të vazhdueshëm dhe pasurimit të informacionit për mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte nga publiku.

Formulari i kërkesës për informacion sipas Ligjit nr. 119/2014”

Përshkrim i indikatorit	Formulari i kërkesës për informacion është dokument standard që u jep qytetarëve mundësinë të paraqesin zyrtarisht kërkesë për marrjen e informacionit publik pranë gjykatës. Ai është i detyrueshëm të ofrohet sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar online formulari i kërkesës për informacion sipas Ligjit nr. 119/2014 dhe a është i aksesueshëm në faqen zyrtare të gjykatës?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është themelor për të garantuar ushtrimin e të drejtës kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve për të pasur akses në informacion publik. Ai forcon llogaridhënien dhe transparencën institucionale dhe ofron një instrument standard të barabartë për të gjithë qytetarët.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-binar, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe qartësinë: • 0 pikë – formulari mungon • 1 pikë – formulari ekziston, por është i pjesshëm, jo i plotë ose jo lehtësisht i aksesueshëm • 2 pikë – formulari ekziston, është i plotë, i qartë, i aksesueshëm dhe i azhornuar sipas modelit të miratuar nga Komisioneri.

Indikatori i Vlerësimit: Formulari i kërkesës për informacion sipas Ligjit nr. 119/2014"

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Formulari i kërkesës për informacion sipas Ligjit nr. 119/2014"

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Formulari i kërkesës për informacion është një komponent thelbësor i transparencës aktive, që mundëson ushtrimin efektiv të së drejtës për t'u informuar, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe udhëzimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP). Shumica e gjykatave e kanë të publikuar formularin standard, në versionin e miratuar institucional, duke siguruar një nivel të qëndrueshëm formal të përmbushjes së detyrimit ligjor.
Në aspektin e strukturës dhe organizimit të faqeve, formulari vendoset kryesisht në rubrikën "Programi i Transparencës", por në disa raste gjendet edhe në seksione të tjera ndihmëse si "Njoftime", "Rregullore të gjykatës" apo "Publikime". Ky shpërndarje tregon një qasje të ndryshme në menaxhimin e informacionit, megjithëse prania e formularit është pothuajse universale.

Në raport me kategoritë e gjykatave, gjykatat e nivelit të lartë dhe ato të posaçme e kanë formularin të aksesueshëm dhe funksional, me lidhje aktive që hapin dokumentin direkt në format PDF ose Word. Gjykatat e apelit dhe ato të shkallës së parë e përfshijnë zakonisht si dokument të shkarkueshëm, por ka dallime të vogla në vendndodhje dhe formën e paraqitjes. Në disa raste formularët janë të përditësuar me versionet më të fundit, ndërsa në të tjera janë të pjesshëm ose të vjetëruar.
Sa i përket aksesueshmërisë dhe funksionalitetit, pjesa më e madhe e faqeve ofrojnë lidhje funksionale dhe të drejtpërdrejta, ndërsa në një numër më të vogël linket janë joaktive ose dokumentet mungojnë në përmbajtje. Në disa raste mungon referenca e plotë ligjore, ose versioni i formularit nuk përfshin të gjitha elementet e modelit të standardizuar të KDIMDHP-së. Në nivel përmbajtjeje, formularët ekzistues përfshijnë zakonisht rubrikat bazë të përcaktuara nga modeli zyrtar: të dhënat identifikuese të kërkuesit, përshkrimin e informacionit të kërkuar, mënyrën e marrjes së informacionit dhe nënshkrimin e kërkuesit. Vetëm në pak raste janë shtuar elementë plotësues institucionalë, si adresa fizike për dorëzim personal ose lidhje për aplikim elektronik.

Në përgjithësi, rubrika "Programi i Transparencës" mbetet vendndodhja më e përdorur për publikimin e formularit, ndërsa nënrubrika si "Njoftime të tjera" apo "Rregullore të gjykatës" shërbejnë si hapësira alternative për aksesin e publikut. Linket për formularët e KDIMDHP-së janë të pranishëm në shumicën e faqeve, duke mundësuar përdorim praktik dhe standardizim të formës së kërkesës për informacion.
Në tërësi, ky indikator paraqet një praktikë të konsoliduar dhe të harmonizuar ligjërisht, megjithëse kërkon përmirësim në aspektin e përditësimit teknik dhe uniformitetit të vendndodhjes në faqe, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje sa më të qartë dhe të drejtpërdrejtë në ushtrimin e kësaj të drejte.

Formulari i ankesës për informacion sipas Ligjit nr. 119/2014”

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat ekzistencën dhe publikimin e formularit standard të ankesës që qytetarët përdorin për të kundërshtuar refuzimin, vonesën ose mospërgjigjen e kërkesës për informacion, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 dhe aktet nënligjore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar në faqen zyrtare të gjykatës Formulari i Ankesës për Informacion dhe a është ai i aksesueshëm për publikun?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të garantuar zbatimin praktik të të drejtës për informim dhe për të krijuar një mekanizëm efektiv ankimi administrativ. Publikimi i formularit demonstron angazhimin e gjykatës ndaj transparencës, përgjegjshmërisë dhe respektimit të standardeve të qeverisjes së hapur.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-administrativ, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe qartësinë e formularit: • 0 pikë – formulari mungon • 1 pikë – formulari ekziston, por është i pjesshëm, jo i qartë, ose jo i lehtësisht i aksesueshëm • 2 pikë – formulari ekziston, është i plotë, i qartë, i shkarkueshëm (PDF/Word) dhe i publikuar në mënyrë të dukshme në rubrikën përkatëse të transparencës në faqen e gjykatës.

Indikatori i Vlerësimit: Formulari i ankesës për informacion sipas Ligjit nr. 119/2014"

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Formulari i ankesës për informacion sipas Ligjit nr. 119/2014"

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Formulari i ankesës përbën një instrument shtesë të transparencës aktive, që garanton ushtrimin e mekanizmit të mbrojtjes së së drejtës për informim në rastet kur kjo e drejtë refuzohet ose nuk përmbushet nga institucioni. Pothuajse të gjitha gjykatat e sistemit gjyqësor e kanë të publikuar formularin standard të ankesës, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe me modelet zyrtare të miratuara nga KDIMDHP. Ky publikim përfaqëson një harmonizim të gjerë institucional dhe tregon respektimin formal të detyrimeve ligjore për sigurimin e mjeteve efektive të ankimit.

Në aspektin e strukturës dhe vendndodhjes, formulari gjendet kryesisht në rubrikën "Programi i Transparencës", e cila mbart nënseksione të dedikuara për të drejtën e informimit. Në disa raste dokumenti është i vendosur edhe në rubrika ndihmëse si "Njoftime të tjera" ose "Publikime", ndërsa në pak faqe është integruar drejtpërdrejt në faqen hyrëse të gjykatës (home page). Shumica e dokumenteve janë të shkarkueshme në format PDF, sipas modelit zyrtar të KDIMDHP-së, me tituj standard si "Formulari i tip i ankesës" ose "Ankesë pranë Komisionerit". Në disa gjykata, ky formular përfshihet brenda paketës së dokumenteve ndihmëse për ushtrimin e të drejtës për informim.

Në raport me aksesueshmërinë dhe funksionalitetin, pjesa dërrmuese e faqeve ofrojnë linke aktive dhe të përdorshme nga publiku, duke mundësuar shkarkim të drejtpërdrejtë të dokumentit. Përjashtime të kufizuara janë vërejtur në disa raste, ku lidhjet rezultojnë joaktive ose me skedarë të munguar. Këto raste tregojnë më shumë probleme teknike sesa mungesë të përmbajtjes në strukturën e faqes.

Sa i përket përmbajtjes dhe standardizimit, formularët e publikuar ndjekin modelin zyrtar të përcaktuar nga Komisioneri, duke përfshirë rubrikat:

- të dhënat identifikuese të ankuesit;
- përshkrimin e kërkesës së refuzuar ose të papërgjigjur;
- arsyetimin e ankesës;
- mënyrën e dorëzimit pranë KDIMDHP.

Në disa raste, dokumentit i bashkëlidhet edhe udhëzimi ligjor mbi afatet dhe procedurat e ankimit, gjë që ndihmon në orientimin praktik të qytetarëve për mënyrën e paraqitjes së ankesës.

Në tërësi, ky indikator paraqet një nivel të lartë të përfshirjes institucionale dhe respektimit të standardeve ligjore, me nevojë të kufizuar për përmirësim, që lidhet kryesisht me përditësimin teknik të lidhjeve dhe unifikimin e vendndodhjes së dokumentit brenda faqeve gjyqësore.

Adresa dhe Kontaktet e Gjykatës

Përshkrim i indikatorit	Adresa dhe kontaktet përfshijnë informacionin bazë mbi vendndodhjen e gjykatës (adresën fizike), numrat e telefonit, adresën elektronike dhe, kur aplikohet, orarin e punës. Ky informacion është themelor për orientimin e publikut.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar në faqen zyrtare adresa dhe kontaktet zyrtare të gjykatës (telefon, email) dhe a janë ato të azhornuara?
Qëllimi dhe rëndësia	Publikimi i adresës dhe kontakteve është parakusht për transparencë institucionale dhe akses publik. Ky informacion i mundëson qytetarëve të identifikojnë lehtësisht gjykatën dhe të komunikojnë me të, duke shmangur pasiguritë dhe mungesën e informacionit bazë.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik dhe vlerësohet mbi bazën e ekzistencës dhe azhornimit: • 0 pikë – mungojnë të dhënat e adresës/kontakteve • 1 pikë – ekzistojnë, por janë të pjesshme ose të vjetëruara • 2 pikë – ekzistojnë, janë të plota (adresë + telefon + email) dhe të azhornuara.

Indikatori i Vlerësimit: Adresa dhe Kontaktet e Gjykatës

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Adresa dhe Kontaktet e Gjykatës

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Të gjitha gjykatat e sistemit gjyqësor kanë të publikuar informacionin kontaktues në faqet e tyre zyrtare, duke përfshirë adresën, numrat e telefonit, email-et institucionale dhe në disa raste të dhëna për zyrat e shërbimit. Rubrika "Kontakt" ose "Na kontaktoni" është e pranishme në çdo faqe dhe përbën një përbërës bazë të komunikimit institucional ndërmjet qytetarëve, mediave dhe administratës gjyqësore.

Në aspektin e strukturës dhe organizimit, të dhënat kontaktuese paraqiten në mënyrë të detajuar dhe të ndarë sipas funksioneve:

- Adresat fizike të gjykatave dhe, në disa raste, të zyrave të shërbimit;
- Numrat e telefonit dhe fax-it për zyrat kryesore (kryesekretaria, zyra e shërbimit, sektori i informacionit);
- Adresat elektronike institucionale, si për komunikim të përgjithshëm ashtu edhe për seksione specifike (civil, penal, marrëdhënie me publikun, ndihmë juridike falas);
- Kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit, i cili shpesh ushtron edhe funksionin e nëpunësit për marrëdhënie me median ose shefit të sektorit përkatës.

Një pjesë e madhe e gjykatave ofrojnë edhe formulare elektronike për kërkesa, aplikime ose marrje dokumentacionesh, të shoqëruara me udhëzime të thjeshta për plotësim, që përfshijnë dokumentet e nevojshme për identifikim dhe mënyrat e marrjes së përgjigjeve. Në disa raste janë përfshirë gjithashtu udhëzues standardë për komunikimin me median dhe publikun, të harmonizuar me dokumentet udhëzuese të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Sa i përket kohës dhe orareve të shërbimit publik, të gjitha gjykatat përcaktojnë orarin standard të punës (zakonisht E hënë – E premte, ora 08:00-16:00), ndërsa në disa raste janë parashikuar edhe intervale të veçanta për pritjen e qytetarëve, zakonisht midis orës 10:00 dhe 14:00. Në rubrikën e kontaktit përfshihen shpesh edhe të dhënat e gjyqtarëve për median dhe specialistëve për marrëdhënie me publikun, si dhe lidhje me dokumente referuese, përfshirë Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor dhe Rregulloren e KLGJ-së për komunikimin me median. Kjo ndihmon në krijimin e një pike të vetme referimi për çdo formë komunikimi institucional. Aksesueshmëria e kësaj rubrike është e lartë: informacioni është i dukshëm dhe i klikueshëm nga menuja kryesore e faqes, me përditësime të rregullta të adresave dhe të dhënave kontaktuese. Në disa faqe është vënë re edhe përdorimi i formateve të standardizuara të KLGJ-së, që ndihmojnë në unifikimin vizual dhe përmbajtësor të mënyrës së komunikimit publik ndërmjet gjykatave.

Në tërësi, kjo rubrikë përfaqëson një nga komponentët më të qëndrueshëm dhe më funksionalë të transparencës gjyqësore, duke ofruar qasje të drejtpërdrejtë dhe të qartë për komunikimin e publikut me institucionet gjyqësore.

Ekzistenca dhe përdorimi i faqeve zyrtare të gjykatës në rrjetet sociale

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat nëse gjykata ka faqe zyrtare në rrjetet sociale dhe nëse ato përdoren rregullisht për të informuar publikun mbi njoftimet, aktivitetet dhe shërbimet e saj.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A ka gjykata faqe zyrtare në rrjetet sociale dhe a i përdor ato për komunikim të rregullt dhe transparent me publikun?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm sepse rrjetet sociale janë një kanal modern komunikimi që rrit aksesin e publikut tek informacionet e gjykatës, duke forcuar transparencën dhe llogaridhënien. Përmes tyre gjykata arrin audienca më të gjera dhe ndikon pozitivisht në perceptimin publik.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator institucional-periodik, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe përdorimin: • 0 pikë – gjykata nuk ka faqe zyrtare në rrjetet sociale • 1 pikë – gjykata ka faqe zyrtare, por përdorimi është sporadik ose i pakët • 2 pikë – gjykata ka faqe zyrtare aktive, të azhurnuara rregullisht dhe që përdoren në mënyrë të plotë për komunikim transparent me publikun.

Indikatori i Vlerësimit: Ekzistenca dhe përdorimi i faqeve zyrtare të gjykatës në rrjetet sociale

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Ekzistenca dhe përdorimi i faqeve zyrtare të gjykatës në rrjetet sociale

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Ky indikator është parashikuar si pjesë e Planit të Komunikimit për Gjykatat 2022-2024, i cili nxit gjykatat të përdorin rrjetet sociale si një mjet shtesë për transparencë dhe ndërveprim me publikun. Në përputhje me këtë, shumica e gjykatave kanë hapur profilet ose faqet e tyre zyrtare në rrjete të ndryshme sociale, duke synuar të informojnë publikun për veprimtarinë institucionale, njoftimet dhe komunikimet publike.

Megjithatë, nuk vërehet një standardizim në mënyrën e përdorimit dhe menaxhimit të këtyre faqeve. Disa gjykata kanë hapur llogari në disa platforma njëkohësisht – si Facebook, Instagram, LinkedIn apo në raste më të rralla Twitter (X) – ndërsa të tjera përdorin vetëm një kanal komunikimi. Gjithashtu, ka një numër të kufizuar gjykatash që ende nuk kanë hapur faqe zyrtare në rrjete sociale.

Në përgjithësi, prania e gjykatave në rrjetet sociale është e dukshme dhe përfshirëse, por niveli i aktivitetit dhe i unifikimit mbetet i ndryshëm nga një gjykatë në tjetrën, për shkak të mënyrës së pavarur të administrimit të faqeve dhe mungesës së një modeli të përbashkët për përditësimin dhe moderimin e tyre.

E

Marrëdhëniet me median dhe gazetarët

Njoftime dhe Deklarata për Median

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin online të njoftimeve zyrtare për median nga gjykata, përfshirë njoftime mbi vendime gjyqësore me interes publik, çështje me vlerë orientuese, deklarata për ngjarje institucionale apo reagime ndaj keqinformimit.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A publikohen rregullisht njoftime për median në faqen zyrtare të gjykatës dhe a përfshijnë ato vitin më të fundit?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është thelbësor për të vlerësuar nivelin e transparencës proaktive të gjykatës dhe marrëdhënien e saj me publikun dhe median. Ai forcon besimin publik, ndihmon në informimin korrekt të opinionit dhe mbron institucionin nga keqinterpretimet.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, i vlerësuar mbi bazën e rregullshmërisë së publikimit: • 0 pikë – nuk ka asnjë njoftim për median të publikuar • 1 pikë – ekzistojnë disa njoftime, por publikimi është i rrallë, jo i përditësuar ose jo i lehtësisht i aksesueshëm • 2 pikë – njoftimet për median publikohen rregullisht, janë të qarta, të aksesueshme, duke përfshirë informacion edhe për vitin më të fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Njoftime dhe Deklaratapër Median

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit: Njoftime për Median

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave është e pranishme një rubrikë e dedikuar për njoftimet dhe deklaratat për median, e cila përbën seksionin kryesor ku publikohen informacionet që lidhen me komunikimin e gjykatës me publikun dhe median. Kjo rubrikë është pjesë standarde e strukturës së faqeve zyrtare dhe është e pranishme në të gjitha nivelet e gjyqësorit.

Në përmbajtje, informacioni që publikohet në këtë rubrikë lidhet kryesisht me çështje gjyqësore, njoftime për zhvillimin e seancave, veprimtari institucionale apo aktivitete të gjykatës. Në disa raste, aty publikohen edhe deklarata për median, por shumica e tyre janë deklarata të përgatitura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe të përcjella për publikim nga vetë gjykatat.

Në një numër rastesh, njoftimet e dedikuara për median janë të shpërndara edhe në rubrika të tjera të faqes, si "Njoftime për publikun", "Publikime" ose "Pasqyra e shtypit". Kjo ndodh për shkak se përmbajtja nuk është gjithmonë e kategorizuar në mënyrë të unifikuar. Po ashtu, në disa rubrika "Njoftime për median" janë përfshirë edhe materiale që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me median, si njoftime të brendshme ose administrative.

Në përgjithësi, rubrika "Njoftime për median" është funksionale dhe e përditësuar në mënyrë të rregullt, por struktura dhe përmbajtja e saj ndryshon nga një faqe në tjetrën, për shkak të përfshirjes së përzier të llojeve të ndryshme të informacionit dhe mungesës së një unifikimi të plotë për përmbajtjen që duhet të publikohet në këtë seksion.

Në tërësi, komunikimet për median janë të pranishme dhe të aksesueshme, por informacioni shpesh rezulton i shpërndarë ose i përsëritur në disa rubrika, duke e bërë të nevojshme një organizim më të qartë dhe të qëndrueshëm të këtij komponenti të transparencës gjyqësore.

Rregullore për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e rregullores zyrtare të miratuar nga KLGJ për mënyrën e komunikimit të sistemit gjyqësor me median. Dokumenti përcakton rregullat për dhënien e informacionit, personat përgjegjës për kontaktet me median dhe kufijtë e transparencës në raport me të dhënat gjyqësore.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar në faqen zyrtare të gjykatës Rregullorja për Komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median dhe a është ajo e aksesueshme për publikun?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të garantuar transparencë të unifikuar dhe profesionale në marrëdhëniet me median. Publikimi i rregullores ndihmon gjykatat dhe qytetarët të kuptojnë qartë procedurat, kompetencat dhe kufijtë e komunikimit publik në sistemin gjyqësor, duke parandaluar keqinformimin ose cenimin e procesit gjyqësor.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-normativ, i vlerësuar vetëm mbi ekzistencën dhe aksesin publik të dokumentit: • 0 pikë – rregullorja mungon • 1 pikë – ekziston referencë e pjesshme ose dokument jo i plotë / jo i lehtësisht i aksesueshëm • 2 pikë – rregullorja është e publikuar plotësisht, e qartë, e shkarkueshme (PDF/Word) dhe e vendosur në rubrikën përkatëse të faqes zyrtare të gjykatës.

Indikatori i Vlerësimit: Rregullore për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë	✓			0 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Rregullore për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Rregullorja për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) me median është e publikuar në pjesën më të madhe të faqeve zyrtare të gjykatave. Dokumenti përmban parimet dhe rregullat që udhëheqin marrëdhënien e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median, si dhe mënyrën e komunikimit publik për çështje që kanë interes shoqëror.

Megjithatë, rregullorja nuk është e vendosur në një rubrikë të vetme dhe të dedikuar, por gjendet e shpërndarë në disa rubrika të ndryshme të faqes, në varësi të mënyrës së organizimit të saj. Në disa raste, ajo është përfshirë në rubrikën "Publikime", në të tjera në "Rregullore të gjykatës", "Njoftime për publikun", ose në seksione të tjera informuese brenda faqes.

Ky shpërndarje bën që dokumenti të jetë i aksesueshëm për publikun, por jo gjithmonë i lehtë për t'u gjetur në një vend të unifikuar. Në disa faqe, rregullorja paraqitet si pjesë e materialeve mbështetëse për komunikimin me median, ndërsa në të tjera është përfshirë në listën e akteve të përgjithshme të gjykatës.

Në përgjithësi, rregullorja është e publikuar në mënyrë të qëndrueshme dhe e njëtrajtshme në përmbajtje, por mospërqendrimi në një rubrikë të vetme dhe shpërndarja e saj në seksione të ndryshme të faqes ndikojnë në uniformitetin e paraqitjes dhe qartësinë e aksesit për publikun.

Udhëzues i Gjykatës për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median

Përshkrim i indikatorit	Udhëzuesi i gjykatës për marrëdhëniet me publikun dhe median përmban parimet dhe rregullat që udhëheqin komunikimin institucional me qytetarët dhe gazetarët. Ky dokument përcakton mënyrat e ofrimit të informacionit, kufijtë e transparencës dhe procedurat për menaxhimin e kërkesave të mediave.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A ka gjykata një udhëzues të publikuar për marrëdhëniet me publikun dhe median dhe a është ai i aksesueshëm për palët e interesuara?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky udhëzues është një element kyç për të garantuar transparencë dhe komunikim të strukturuar. Ai ndihmon në parandalimin e keqkuptimeve, në rritjen e besimit publik dhe në krijimin e një praktike të unifikuar të raportimit dhe informimit publik.
Matja e indikatorit	Vlerësimi bazohet në ekzistencë, qartësi dhe azhornim: • 0 pikë – udhëzuesi mungon • 1 pikë – udhëzuesi ekziston, por është i pjesshëm, i vjetëruar ose jo i aksesueshëm lehtësisht • 2 pikë – udhëzuesi ekziston, është i plotë, i qartë, i aksesueshëm dhe i azhurnuar.

Indikatori i Vlerësimit: Udhëzues i Gjykatës për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Udhëzues i Gjykatës për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Udhëzuesi i Gjykatës për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median është i publikuar në pjesën më të madhe të faqeve zyrtare të gjykatave, si dokument orientues që përcakton mënyrën e komunikimit të institucioneve gjyqësore me publikun dhe median, rolin e koordinatorëve për informacion dhe rregullat bazë të transparencës institucionale.

Megjithatë, udhëzuesi nuk është i vendosur në një rubrikë të vetme dhe të dedikuar, por gjendet i shpërndarë në disa rubrika të ndryshme të faqeve, në varësi të strukturës së secilës gjykatë. Në disa raste, ai është përfshirë në "Publikime", në të tjera në "Rregullore të gjykatës", "Njoftime për publikun", ose në rubrika të tjera që lidhen me transparencën dhe komunikimin institucional.

Ky shpërndarje bën që dokumenti të jetë i aksesueshëm për publikun, por jo gjithmonë i përqendruar në një vend të vetëm. Në disa faqe, udhëzuesi shfaqet krahas rregullores për komunikimin me median, si pjesë e një grupi materialesh informuese që rregullojnë raportet e gjykatave me publikun dhe median.

Në përmbajtje, dokumenti është i unifikuar dhe ndjek modelin zyrtar të miratuar në nivel sistemi, por shpërndarja në disa rubrika të ndryshme dhe mungesa e një seksioni të dedikuar ndikojnë në qartësinë dhe uniformitetin e aksesit.

Në përgjithësi, udhëzuesi është i publikuar në mënyrë të qëndrueshme dhe i njëtrajtshëm në përmbajtje, por jo gjithmonë i vendosur në një rubrikë të vetme, duke u paraqitur në forma të ndryshme të organizimit ndërmjet faqeve të gjykatave.

Deklaratë e konfidencialitetit për aksesin në dosjet gjyqësore nga media dhe publiku

Përshkrim i indikatorit	Deklarata e konfidencialitetit është një dokument standard që kërkohet të firmoset nga përfaqësuesit e medias ose qytetarët kur u jepet akses në dosjet gjyqësore. Dokumenti garanton që informacioni i marrë nuk do të përdoret në mënyrë që cenon palët, të dhënat personale apo integritetin e procesit gjyqësor.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar online deklarata e konfidencialitetit për aksesin në dosjet gjyqësore dhe a është ajo e aksesueshme për median dhe publikun?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të balancuar transparencën me mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë së palëve. Ai siguron që aksesimi i dosjeve të bëhet në mënyrë të rregulluar, pa rrezikuar cenimin e procesit apo të drejtave të subjekteve të përfshira.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-binar, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe qartësinë: • 0 pikë – deklarata mungon • 1 pikë – deklarata ekziston, por është e pjesshme, jo e qartë ose jo lehtësisht e aksesueshme • 2 pikë – deklarata ekziston, është e plotë, e qartë, e aksesueshme dhe e azhornuar sipas standardeve ligjore për mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetit.

Indikatori i Vlerësimit: Deklaratë e konfidencialitetit për aksesin në dosjet gjyqësore nga media dhe publiku

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Deklaratë e konfidencialitetit për aksesin në dosjet gjyqësore nga media dhe publiku

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Deklarata e konfidencialitetit për aksesin në dosjet gjyqësore nga media dhe publiku është e pranishme në faqet zyrtare të shumicës së gjykatave, si dokument që përcakton rregullat për respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave gjatë informimit publik apo mediak mbi çështjet gjyqësore.

Në përmbajtje, ky dokument bën pjesë në Udhëzuesin e Gjykatës për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median, duke u përfshirë zakonisht si pjesë shtesë brenda tij. Megjithatë, në shumë faqe gjyqësore deklarata është publikuar edhe veçmas, si dokument i pavarur dhe i identifikueshëm me titullin e plotë "Deklaratë e konfidencialitetit për aksesin në dosjet gjyqësore nga media dhe publiku".

Në disa raste, gjykatat kanë publikuar si Udhëzuesin, ashtu edhe Deklaratën në mënyrë të ndarë, duke i ofruar të dy dokumentet paralelisht në rubrika të ndryshme të faqes. Kjo bën që informacioni të jetë i plotë, por i paraqitur në mënyrë të shpërndarë.

Deklarata është publikuar në rubrika të ndryshme, si "Publikime", "Rregullore të gjykatës", "Njoftime për publikun" ose "Transparenca", dhe në disa raste është e aksesueshme edhe nga faqja hyrëse (homepage). Kjo shpërndarje reflekton praktika të ndryshme organizimi të faqeve gjyqësore, por bën që dokumenti të mos jetë gjithmonë i vendosur në një seksion unik.

Në tërësi, Deklarata e konfidencialitetit është publikuar në mënyrë të qëndrueshme në shumicën e faqeve të gjykatave, si pjesë e Udhëzuesit për komunikimin me publikun ose si dokument i veçantë, ndërkohë që shfaqet e shpërndarë në disa rubrika, dhe në disa raste, të dy format – udhëzuesi dhe deklarata – janë publikuar së bashku në faqen zyrtare.

Deklaratë e pëlqimit për publikimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore

Përshkrim i indikatorit	Deklarata e pëlqimit është një dokument standard përmes të cilit palët japin leje të shprehur për publikimin e të dhënave të tyre personale në vendimet gjyqësore të bëra publike. Kjo praktikë përdoret në raste kur transparenca kërkon të kapërcejë kufizimet e anonimizimit të plotë.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar online deklarata e pëlqimit për publikimin e të dhënave personale dhe a është e aksesueshme për palët?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të respektuar standardet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtën e informimit publik. Ai forcon legjitimitetin e gjykatës duke i ofruar palëve një mjet të qartë për të ushtruar të drejtën e tyre për privatësi dhe pëlqim të informuar.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-binar, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe qartësinë: • 0 pikë – deklarata mungon • 1 pikë – deklarata ekziston, por është e pjesshme, jo e qartë ose jo lehtësisht e aksesueshme • 2 pikë – deklarata ekziston, është e plotë, e qartë, e aksesueshme dhe e azhornuar sipas standardeve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Indikatori i Vlerësimit: Deklaratë e pëlqimit për publikimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Deklaratë e pëlqimit për publikimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Deklarata e pëlqimit për publikimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore është e pranishme në faqet zyrtare të shumicës së gjykatave, si dokument që lidhet me mbrojtjen e të dhënave personale dhe transparencën në publikimin e akteve gjyqësore. Dokumenti parashikon rastet dhe mënyrën në të cilën palët japin pëlqimin për publikimin e të dhënave të tyre personale në vendimet e gjykatës.

Në përmbajtje, kjo deklaratë bën pjesë në Udhëzuesin e Gjykatës për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median, por në shumë raste është publikuar edhe veçmas, si dokument i pavarur me titullin e plotë "Deklaratë e pëlqimit për publikimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore".

Në disa faqe, gjykatat kanë publikuar si Udhëzuesin, ashtu edhe Deklaratën veçmas, duke i vendosur të dy dokumentet në rubrika të ndryshme të faqes. Kjo krijon situata ku i njëjti material është i qasshëm në më shumë se një seksion, por pa një vendndodhje të unifikuar.

Deklarata është publikuar në rubrika të ndryshme, si "Publikime", "Rregullore të gjykatës", "Njoftime për publikun", "Transparenca" ose në disa raste drejtpërdrejt në faqen hyrëse (homepage). Ky variacion pasqyron mënyra të ndryshme të organizimit të faqeve, duke bërë që dokumenti të jetë i shpërndarë, por në përgjithësi lehtësisht i aksesueshëm.

Në përmbledhje, Deklarata e pëlqimit është publikuar në mënyrë të qëndrueshme në shumicën e faqeve të gjykatave, si pjesë e Udhëzuesit për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median ose si dokument i veçantë. Në disa raste të kufizuara, të dy dokumentet janë publikuar njëkohësisht, ndërsa në të tjera vetëm deklarata, por në të gjitha rastet materiali është i shpërndarë në disa rubrika të faqes zyrtare.

Formular për përfaqësuesit e medias: Kërkesë për regjistrimin/transmetimin e imazheve filmike të seancës gjyqësore

Përshkrim i indikatorit	Ky formular standard u jep përfaqësuesve të medias mundësinë të aplikojnë për leje për regjistrimin ose transmetimin e imazheve filmike nga seancat gjyqësore. Ai është pjesë e transparencës gjyqësore dhe rregullimit të marrëdhënieve me median.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar në faqen zyrtare formulari për regjistrimin/transmetimin e imazheve filmike nga seancat gjyqësore dhe a është ai i aksesueshëm për median?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të garantuar transparencën gjyqësore dhe njëkohësisht respektimin e rregullave procedurale për mbrojtjen e palëve dhe të dhënave personale. Ai lejon që media të ketë akses të rregulluar dhe ligjor në proceset gjyqësore.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-binar, vlerësuar mbi ekzistencën dhe përditësimin: • 0 pikë – formulari mungon • 1 pikë – formulari ekziston, por është i pjesshëm, jo i qartë ose i vjetëruar • 2 pikë – formulari ekziston, është i plotë, i qartë, i aksesueshëm dhe i azhornuar.

Indikatori i Vlerësimit: Formular për përfaqësuesit e medias: Kërkesë për regjistrimin/transmetimin e imazheve filmike të seancës gjyqësore	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Formular për përfaqësuesit e medias: Kërkesë për regjistrimin/transmetimin e imazheve filmike të seancës gjyqësore

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Formulari për përfaqësuesit e medias, me titull "Kërkesë për regjistrimin/transmetimin e imazheve filmike të seancës gjyqësore", është i publikuar në pjesën më të madhe të faqeve zyrtare të gjykatave. Dokumenti përdoret nga përfaqësuesit e mediave që kërkojnë leje për të filmuar, regjistruar ose transmetuar pamje nga seancat gjyqësore, në përputhje me rregullat për transparencën dhe respektimin e procesit gjyqësor.

Në përmbajtje, ky formular bën pjesë në Udhëzuesin e Gjykatës për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median, ku është përfshirë si shtojcë standarde. Megjithatë, në shumë faqe gjyqësore dokumenti është publikuar edhe veçmas, si formular i pavarur, në formatin zyrtar të miratuar për institucionet gjyqësore.

Në disa raste, gjykatat kanë publikuar njëkohësisht si Udhëzuesin, ashtu edhe Formularin veçmas, duke i vendosur në rubrika të ndryshme të faqes. Kjo bën që materiali të jetë i plotë dhe i aksesueshëm, por i shpërndarë në disa seksione të ndryshme.

Formulari është publikuar në rubrika të ndryshme, përfshirë "Publikime", "Rregullore të gjykatës", "Njoftime për publikun" ose "Transparenca", dhe në disa raste është vendosur edhe në faqen hyrëse (homepage). Struktura e faqes ndryshon nga një gjykatë në tjetrën, duke bërë që dokumenti të mos jetë gjithmonë i pozicionuar në një vend të unifikuar.

Në përgjithësi, formulari është i publikuar në mënyrë të qëndrueshme dhe i aksesueshëm në shumicën e faqeve gjyqësore, si pjesë e Udhëzuesit për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median ose si dokument i veçantë. Në disa raste, të dy format – udhëzuesi dhe formulari – janë publikuar së bashku, ndërsa në të tjera vetëm formulari, por në të gjitha rastet dokumenti është i shpërndarë në rubrika të ndryshme të faqes.

Kontaktet e Gjyqtarit për Median

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator i referohet publikimit të kontaktit zyrtar të gjyqtarit përgjegjës për median (zëdhënësit të gjykatës), i cili është personi që komunikon me median për çështje të interesit publik dhe garanton respektimin e rregullave të komunikimit institucional.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A është publikuar në faqen zyrtare kontakti i gjyqtarit për median dhe a përfshin të dhëna të azhurnuara për komunikim?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të siguruar transparencë dhe komunikim të strukturuar me median, në mënyrë që informacionet të jepen në mënyrë zyrtare, të verifikuar dhe pa rrezikuar cenimin e procesit gjyqësor. Ai ndihmon në ndërtimin e një marrëdhënieje profesionale dhe të qëndrueshme me publikun.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-periodik, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe përditësimin e kontaktit: • 0 pikë – mungon çdo informacion mbi gjyqtarin për median • 1 pikë – ekziston informacion, por është i pjesshëm (pa kontakt direkt, jo i azhurnuar ose i fshehur nën rubrika të tjera) • 2 pikë – ekziston informacion i plotë, i qartë dhe i azhurnuar mbi gjyqtarin për median, me emër, pozicion dhe kontakt zyrtar të aksesueshëm publikisht.

Indikatori i Vlerësimit: Kontakti i Gjyqtarit për Median

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Kontakti i Gjyqtarit për Median

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave është parashikuar që të publikohet kontakti i gjyqtarit përgjegjës për median, si personi që ndihmon në komunikimin ndërmjet institucionit gjyqësor dhe përfaqësuesve të mediave. Ky informacion duhet të jetë pjesë e komponentëve të transparencës dhe të komunikimit publik të gjykatave.

Megjithatë, vetëm një numër shumë i kufizuar gjykatash e kanë publikuar këtë informacion në faqet e tyre zyrtare. Në pjesën më të madhe të rasteve, të dhënat për gjyqtarët për median gjenden vetëm në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), në seksionin që trajton strukturat e komunikimit dhe listën e përfaqësuesve institucionalë.

Në faqet e gjykatave ku ky informacion është i publikuar, ai zakonisht gjendet në rubrika si "Publikime", "Njoftime për publikun", ose në seksione që lidhen me komunikimin me median, por pa ndonjë vend të unifikuar për të gjitha gjykatat. Në disa raste të izoluara, kontakti i gjyqtarit për median është përfshirë në të njëjtin seksion me të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit.

Në përgjithësi, publikimi i kontaktit të gjyqtarit për median është shumë i kufizuar në faqet e gjykatave, pavarësisht se informacioni ekziston dhe është i aksesueshëm në faqen e KLGJ. Ky element rezulton i pranishëm vetëm në mënyrë të pjesshme në nivel gjykate dhe nuk paraqitet si pjesë standarde e informacionit institucional që duhet të publikohet nga vetë gjykatat.

Kontakte të Nëpunësit për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator i referohet publikimit të të dhënave të kontaktit të nëpunësit përgjegjës për marrëdhëniet me median dhe publikun në gjykatë. Ai përfshin emrin, pozicionin, adresën elektronike dhe/ose numrin e telefonit për komunikim institucional me publikun dhe median.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A janë publikuar në faqen zyrtare të gjykatës kontaktet e nëpunësit për marrëdhëniet me median dhe publikun dhe a janë ato të azhurnuara?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të siguruar kanale të qarta dhe të besueshme komunikimi ndërmjet gjykatës, qytetarëve dhe mediave. Ai garanton që informacionet dhe kërkesat publike adresohen në mënyrë profesionale, transparente dhe të unifikuar.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator statik-periodik, i vlerësuar mbi ekzistencën dhe qartësinë e kontaktit: • 0 pikë – mungojnë kontaktet për median dhe publikun • 1 pikë – ekziston informacion, por është i pjesshëm, jo i qartë ose jo i azhurnuar • 2 pikë – kontaktet ekzistojnë, janë të plota (emër, email, telefon), të qarta, të aksesueshme dhe të azhurnuara në faqen zyrtare të gjykatës.

Indikatori i Vlerësimit: Kontakte të Nëpunësit për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë			✓	2 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë			✓	2 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Kontakte të Nëpunësit për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave është i pranishëm kontakti i nëpunësit përgjegjës për marrëdhëniet me median dhe publikun, i cili shërben si pika kryesore e komunikimit institucional me qytetarët dhe përfaqësuesit e mediave. Ky informacion është pjesë e detyrimeve të transparencës institucionale të gjykatave dhe është i aksesueshëm në pjesën më të madhe të faqeve.

Në shumicën e rasteve, pozicioni i nëpunësit për median dhe publikun përkon me atë të koordinatorit për të drejtën e informimit, ndaj kontaktet janë të bashkuara në një seksion të vetëm, ku përfshihen emri, funksioni, numri i telefonit dhe adresa elektronike. Kjo e bën informacionin lehtësisht të gjendshëm dhe të unifikuar në nivel sistemi.

Rubrika ku gjendet ky informacion varion nga një faqe në tjetrën, por më shpesh ndodhet në seksionet "Transparenca", "Kontakte" ose "Koordinatori për të drejtën e informimit". Në disa raste, të dhënat janë të shoqëruara edhe me formularë elektronikë për kërkesa apo ankesa nga publiku.

Në përmbajtje, informacioni është i plotë, i përditësuar dhe i aksesueshëm, duke përmbushur kërkesat për publikimin e kontaktit të nëpunësit për median dhe publikun. Edhe pse në disa raste ky rol nuk shënohet me titullin e plotë, funksioni është i mbuluar dhe i identifikueshëm në mënyrë të qëndrueshme në faqet e gjykatave.

Njoftime mbi veprimtari institucionale të gjykatës (evente, vizita, trajnime, takime)

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e njoftimeve, artikujve apo materialeve vizuale që pasqyrojnë veprimtarinë institucionale të gjykatës, si pjesëmarrje në trajnime, vizita studimore, aktivitete ndërinstitucionale apo evente publike.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A publikohen në faqen zyrtare të gjykatës njoftime ose materiale mbi veprimtari institucionale (evente, vizita, trajnime, takime) dhe a përfshijnë ato vitin më të fundit?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator është i rëndësishëm për të vlerësuar transparencën dinamike të institucionit, duke treguar se gjykata nuk kufizohet vetëm në funksionin gjyqësor, por angazhohet edhe në përmirësimin profesional, bashkëpunimin institucional dhe komunikimin me publikun. Publikimi i këtyre njoftimeve ndihmon në rritjen e imazhit dhe besimit publik ndaj sistemit gjyqësor.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, i vlerësuar mbi rregullshmërinë e publikimit: • 0 pikë – nuk ka asnjë publikim mbi veprimtari institucionale • 1 pikë – ekzistojnë disa publikime, por jo të rregullta, jo të përditësuara ose të kufizuara në një periudhë të vetme • 2 pikë – njoftimet ose publikimet pasqyrojnë vazhdimisht veprimtari institucionale për të paktën 3 vite radhazi, përfshirë vitin më të fundit, me përmbajtje të qartë dhe të aksesueshme.

Indikatori i Vlerësimit: Njoftime mbi veprimtari institucionale të gjykatës

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			✓	2 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë			✓	2 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	✓			0 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër			✓	2 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	✓			0 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	✓			0 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Njoftime mbi veprimtari institucionale të gjykatës

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Në faqet zyrtare të gjykatave është e pranishme një rubrikë e dedikuar për njoftimet mbi veprimtarinë institucionale, e cila në shumicën e rasteve mban titullin "Multimedia". Kjo rubrikë është parashikuar për të pasqyruar aktivitetet, takimet, vizitat institucionale dhe veprimtaritë publike të gjykatës, me qëllim rritjen e transparencës dhe komunikimit me publikun.

Megjithatë, niveli i aktivizimit dhe përditësimit të kësaj rubrike ndryshon ndjeshëm nga një gjykatë në tjetrën. Disa gjykata e përdorin rubrikën në mënyrë të rregullt dhe publikojnë njoftime për veprimtari të ndryshme institucionale, ndërsa të tjera e mbajnë rubrikën formalisht, pa përmbajtje të re ose me publikime shumë të rralla.

Përveç rubrikës "Multimedia" ose "Aktivitete", informacione mbi veprimtarinë institucionale gjenden shpesh edhe në faqen hyrëse (homepage) të gjykatës, ku publikohen lajme, njoftime ose materiale që pasqyrojnë aktivitetet e fundit. Edhe pse kjo rrit dukshmërinë, publikimet nuk janë gjithmonë të pasqyruara në mënyrë të sistematizuar në rubrikën përkatëse.

Në përmbajtje, njoftimet për veprimtarinë institucionale variojnë nga njoftime për takime dhe trajnime, deri te publikime për pjesëmarrje në ngjarje publike apo bashkëpunime ndërinstitucionale. Në disa raste, ato shoqërohen me foto ose video, ndërsa në të tjera paraqiten vetëm në formë teksti.

Megjithatë, rubrika "Multimedia" shpesh nuk përfshin materiale të tjera që mund të përgatiten nga gjykatat, si video prezantuese, statistika vizuale, raporte periodike ose publikime të tjera me karakter informues. Këto materiale, edhe kur ekzistojnë, nuk janë të përfshira në mënyrë të rregullt në këtë seksion, çka kufizon potencialin e tij si hapësirë e plotë për komunikimin vizual dhe informues të gjykatës.

Në përgjithësi, rubrika e njoftimeve mbi veprimtarinë institucionale është funksionale, por jo e përdorur në mënyrë të qëndrueshme. Ka gjykata që e mbajnë aktive dhe e përditësojnë rregullisht, por shumica nuk e përdorin sistematikisht për të pasqyruar veprimtarinë dhe produktet e tyre institucionale, duke bërë që informacioni të mbetet i fragmentuar dhe i shpërndarë në disa pjesë të faqes.

Publikime mediatike që pasqyrojnë veprimtarinë e gjykatës

Përshkrim i indikatorit	Ky indikator mat publikimin e artikujve ose materialeve mediatike (kronika, intervista, njoftime, reportazhe) që pasqyrojnë aktivitetet, nismat, vizitat apo komunikimet e gjykatës me publikun dhe median, si pjesë e transparencës institucionale.
Pyetja për të vlerësuar indikatorin	A publikohen në faqen zyrtare të gjykatës materiale mediatike që pasqyrojnë veprimtarinë e saj institucionale dhe komunikimin me publikun?
Qëllimi dhe rëndësia	Ky indikator vlerëson aftësinë e gjykatës për të komunikuar publikisht përmes mediave dhe për të ndërtuar një imazh të qartë, të përgjegjshëm dhe profesional. Publikimi i materialeve mediatike rrit besimin publik dhe promovon transparencën proaktive të sistemit gjyqësor.
Matja e indikatorit	Ky është një indikator periodik, i vlerësuar mbi vazhdimësinë e publikimeve: • 0 pikë – mungojnë publikime mediatike që pasqyrojnë veprimtarinë e gjykatës • 1 pikë – ekzistojnë publikime të rralla ose të pjesshme (p.sh. një material i izoluar ose i vjetër) • 2 pikë – ekzistojnë publikime të rregullta dhe të përditësuara deri vitin më të fundit.

Indikatori i Vlerësimit: Publikime mediatike që pasqyrojnë veprimtarinë e gjykatës

	Nuk Përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet Plotësisht	Totali i Pikëve
Gjykata e Lartë			✓	2 pikë
Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm		✓		1 pikë
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar		✓		1 pikë
Gjykata e Apelit Administrativ		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë		✓		1 pikë
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar		✓		1 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë		✓		1 pikë
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës		✓		1 pikë
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë		✓		1 pikë

Indikatori i Vlerësimit:
Publikime mediatike që pasqyrojnë veprimtarinë e gjykatës

Gjetje dhe Vlerësime kryesore:

Ky indikator mat nivelin e ndërveprimit të sistemit gjyqësor me median dhe publikun, duke u fokusuar jo tek përmbajtja e komunikimit të brendshëm të gjykatës, por tek prania e saj në hapësirën mediatike përmes publikimeve, njoftimeve dhe pasqyrimeve të veprimtarive institucionale. Ai synon të vlerësojë se sa në mënyrë sistematike gjykatat sigurojnë që aktivitetet, vendimet, apo nismat e tyre të jenë të reflektuara dhe të aksesueshme në media.

Në aspektin praktik, pothuajse të gjitha faqet gjyqësore përmbajnë një seksion të dedikuar, të titulluar "Pasqyra e shtypit", "Publikime mediatike", ose "Njoftime për median dhe publikun". Këto rubrika përfaqësojnë kanalet formale për komunikim publik dhe mediatik, duke pasqyruar qëllimisht deklaratat, njoftimet apo aktivitetet që gjykatat kanë dashur të bëjnë publike.

Megjithatë, shtrirja dhe përmbajtja e këtyre publikimeve mbeten të pjesshme. Në shumë raste, rubrikat përmbajnë vetëm njoftime rutinë, deklarata zyrtare apo përditësime të brendshme, pa përfshirë artikuj, publikime apo kronika mediatike që reflektojnë realisht veprimtarinë e gjykatës në media. Kjo tregon se ndërveprimi me median është ende më shumë reaktiv sesa proaktiv, duke munguar një strategji të qëndrueshme të raportimit publik në kuadër të transparencës.

Në anën tjetër, disa gjykata të kategorisë së lartë (si Gjykata e Lartë dhe ato të posaçme) kanë treguar përmirësim në këtë drejtim, duke publikuar njoftime të strukturuara, komunikata për shtyp apo pasqyra të mediave që mbulojnë çështje të rëndësishme, trajnime, takime apo aktivitete ndërinstitucionale.

Në përgjithësi, mund të thuhet se ky indikator përmbushet pjesërisht: ekziston baza teknike për publikimin e materialeve mediatike dhe rubrika përkatëse është funksionale në pjesën më të madhe të faqeve, por intensiteti, koherenca dhe përmbajtja e komunikimit mbeten të kufizuara. Përmirësimi kërkon një përdorim më të qëllimshëm të hapësirave mediatike, duke përfshirë materiale të rregullta që dokumentojnë punën gjyqësore, raportet me publikun dhe rezultatet institucionale.

Në përfundim, niveli aktual i reflektimit mediatik të gjykatave është formal dhe jo i plotë, pasi përqendrohet më shumë në njoftime administrative sesa në pasqyrimin e veprimtarisë së tyre përmes mediave. Zbatimi i standardeve të parashikuara në Planin e Komunikimit për sistemin gjyqësor do të ndihmonte në rritjen e transparencës aktive dhe forcimin e besimit publik në institucionet e drejtësisë.

Rekomandime Kryesore

1. Standardizimi i strukturës dhe përmbajtjes së faqeve zyrtare

- Të hartohet dhe miratohet një udhëzues për strukturën dhe përmbajtjen e faqeve zyrtare të gjykatave, që përcakton rubrikat bazë, nënrubrikat dhe standardet e organizimit të informacionit.
- Të garantohet një strukturë e unifikuar e faqes kryesore (homepage) për të gjitha gjykatat, me përmbajtje të balancuar ndërmjet informacionit statik institucional dhe njoftimeve aktuale.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) të koordinojë ndërtimin e një modeli unik për dizajnin dhe navigimin e faqeve, duke përfshirë kritere për qartësinë vizuale, funksionalitetin dhe aksesin publik.

2. Kategorizimi dhe organizimi logjik i informacionit

- Të përgatitet një taksonomi standarde për publikimin e informacionit, që përcakton saktësisht se cilat lloje dokumentesh vendosen në secilën rubrikë (p.sh. rregullore, njoftime, publikime, dokumente financiare etj.).
- Të eliminohet mbivendosja dhe përsëritja e rubrikave me funksione të ngjashme, duke siguruar që çdo kategori të ketë rol të qartë dhe unik në strukturën e faqes.
- Gjykatat të rishikojnë periodikisht përmbajtjen ekzistuese dhe të transferojnë informacionet e vendosura në rubrika të pasakta në vendin e duhur sipas standardeve të reja.

3. Përmirësimi i koherencës dhe cilësisë së publikimeve

- Të krijohen udhëzime të brendshme për administrimin e përmbajtjes online, duke përfshirë kalendarin e publikimeve, përgjegjësit për përditësim dhe formatet standarde të dokumenteve.
- Të garantohet që të gjitha gjykatat të publikojnë materiale për të njëjtën periudhë kohore, në mënyrë të sinkronizuar (p.sh. raportet vjetore të pesë viteve të fundit), për të mundësuar krahasueshmëri dhe transparencë të qëndrueshme.
- Të forcohet kontrolli cilësor për përputhjen ndërmjet përmbajtjes dhe rubrikës ku publikohet materiali, duke shmangur vendosjen e dokumenteve të papërshtatshme apo pa lidhje.

Rekomandime Kryesore

4. Mirëmbajtja dhe përditësimi i vazhdueshëm i informacionit

- Të krijohet një mekanizëm periodik verifikimi (p.sh. çdo 6 muaj) për përditësimin e informacionit bazë, si rregulloret, listat e gjykatave, dhe dokumentet institucionale.
- Të caktohet në çdo gjykatë një koordinator për mirëmbajtjen e faqes, përgjegjës për ruajtjen e përditësimit dhe përputhjes me ndryshimet ligjore apo strukturore të sistemit gjyqësor.
- Të zhvillohet një sistem njoftimi automatik ose raportimi dixhital për dokumentet që kanë kaluar periudhën e vlefshmërisë, për të parandaluar qëndrimin e informacionit të vjetëruar në faqe.

5. Arkivimi dhe ruajtja afatgjatë e përmbajtjes

- Të krijohet një arkiv elektronik i njoftimeve dhe dokumenteve të mëparshme, i aksesueshëm për publikun, për të shmangur humbjen e informacionit pas tejkalimit të kufijve teknikë të faqes.
- Të vendosen udhëzime për ruajtjen afatgjatë të materialeve në rubrikat me ngarkesë të lartë informacioni (p.sh. "Njoftime", "Vende vakante"), me ndarje sipas viteve ose kategorive.
- Të integrohet funksioni "shfleto arkivën" në çdo faqe, për të garantuar transparencë historike dhe gjurmueshmëri të informacionit publik.

6. Menaxhimi i faqeve pas riorganizimit gjyqësor

- Pas reformës së hartës gjyqësore, KLGJ të ndërmarrë një proces të centralizuar për mbylljen, arkivimin dhe ridrejtimin automatik të faqeve të vjetra drejt faqeve të reja funksionale.
- Të krijohet një faqe unike portale me listë përditësuese të të gjitha gjykatave ekzistuese dhe linkun zyrtar të secilës, për të shmangur konfuzionin gjatë kërkimeve online.
- Të zhvillohet një protokoll për heqjen e faqeve të vjetra nga motorët e kërkimit (p.sh. Google), përmes kërkesave zyrtare të optimizimit (SEO cleanup dhe redirect).

Rekomandime Kryesore

7. Publikimi i dokumenteve strategjike dhe standardizimi i aksesit

- KLGJ të garantojë që dokumente të përbashkëta për sistemin, si Plani Strategjik i Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, të publikohen në rubrikë të dedikuar dhe të njëjtë për të gjitha gjykatat, p.sh. "Dokumente strategjike" ose "Publikime kombëtare".
- Të vendoset një datë unike publikimi dhe format standard i dokumenteve strategjike, për të siguruar koherencë dhe njohje të njëtrajtshme nga publiku.

8. Rritja e kapaciteteve për administrimin e faqeve zyrtare

- Të organizohen trajnimet periodike për stafin përgjegjës për komunikimin dhe teknologjinë e informacionit, me fokus në standardet e transparencës, mirëmbajtjen e përmbajtjes dhe përdorimin e mjeteve moderne të menaxhimit të faqeve zyrtare.
- Të hartohen udhëzime të përbashkëta për komunikimin publik dhe publikimin e informacionit online, të cilat përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e çdo aktori në nivel gjykate.
- Të unifikohet koordinimi ndërmjet personave përgjegjës për transparencën dhe komunikimin në çdo gjykatë. Kjo do të garantojë zbatimin e një qasjeje të përbashkët, koherente dhe të standardizuar në administrimin e faqeve zyrtare dhe në komunikimin publik të sistemit gjyqësor.

CSDG

Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes

@csdgalbania
www.csdgalbania.org
office@csdgalbania.org